



# PROCEDURA PËR VEPRIM ME FËMIJËN VIKTIMË

декември, 2014





**Издавач:** СППМД - Кавадарци

**За издавачот:** Петре Мркев

**Автори:**

проф.д-р Лазар Нанев

доц.д-р Јован Илиевски

Лилјана Јаковчевска

**Соработник:** доц.д-р Олга Ѓуркова Кошевалиска

**Печати:** Европа 92 Кочани

**Тираж:** 800 примероци

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

341.23.14-053.2(497.7)

342.7-053.2(497.7)

364.63-053.2(497.7)

ПРОЦЕДУРИ за постапување со дете - жртва. - Кавадарци : Совет за превентива против малолетничка деликвенција СППМД, 2014. - 119 стр. ; 24 см

ISBN 978-9989-9968-8-7

а) Деца, жртви на насилство - Процедури за постапување - Македонија б) Права на детето - Македонија

COBISS.MK-ID 97750538



# PROCEDURA PËR VEPRIM ME FËMIJËN VIKTIMË

Изработено со техничка и финансиска поддршка на Детскиот фонд на Обединети Нации (УНИЦЕФ).

Гледиштата изнесени во овој извештај им припаѓаат на авторите и не мора да се совпаѓаат со политиките и гледиштата на УНИЦЕФ. Текстот не е лектуриран според уредувачките стандарди на УНИЦЕФ.



# СОДРЖИНА

## PËRMBAJTJA

1	HYRJE	7
2	QËLLIMET THEMELORE TË PROCEDURAVE	9
3	DEFINIMI I KONCEPTIT VIKTIMË DHE KONCEPTIT FËMIJË-VIKTIMË TË DHUNËS OSE VEPRËS PENALE	12
4	DOMETHËNIA E NOCIONEVE	16
5	PARIMET THEMELORE DHE TË DREJTAT RELEVANTE PËR MBROJTJE TË FËMIJËVE-VIKTIMA TË VEPRAVE PENALE	18
6	PROCEDURA PARA POLICISË	25
7	PROCEDURA PARA PROKURORIT PUBLIK	39
8	PROCEDURA PARA GJYQIT	61
9	SHTOJCA 1 – STANDARDET RELEVANTE NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE PËR MBROJTJE TË FËMIJËVE-VIKTIMË	93

## PJESA E DYTË

10	LISTA E HAPAVE OPERATIVE PËR VEPRIM TË POLICISË DHE PROKURORIT PUBLIK ME FËMIJËN-VIKTIMË	99
----	--	----



# PËRMBAJTJA







## HYRJE

Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar Konventën për të drejtat e fëmijës, me çka e ka marrë përsipër detyrimin e përkujdesjes për realizimin e saj, gjegjësit detyrimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe avancimin e gjendjes së tyre. Mirëpo, ky nuk është vetëm detyrim i shtetit, por edhe detyrim i individëve, të cilët përmes veprimeve të përditshme mund të dëshmojnë se i pranojnë dhe respektojnë të drejtat e fëmijëve.

Konventa për të drejtat e fëmijës në nenin 39 përcakton detyrime se shteti i ndërmerr të gjitha masat përkatëse për rimëkëmbje më të mirë fizike dhe psikike për reintegrim social të fëmijës viktimë të ndonjë forme të shpërfilljes; eksploatimit; keqpërdorimit; torturës ose ndonjë forme të veprimit mizor, johuman ose degraduese; dënimit dhe përleshjes së armatosura. Rimëkëmbja dhe reintegrimi zhvillohet në mjedise, të cilat e stimulojnë shëndetin, vetërespektin dhe dinjitetin e fëmijës.

Të gjitha format e dhunës, abuzimit ose shpërfilljes me të cilat kanoset ose cenohet integriteti fizik dhe psikik i fëmijës paraqesin shkelje të njërës ndër të drejtave themelore të njeriut, të cilat Konventa i ka ngritur në nivel të principeve gjegjësisht parimeve, siç janë e drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit.

Këta procedura janë hartuar edhe për shkak se sot një numër i madh i fëmijëve vuajnë si rezultat i krimit ose keqpërdorimit të pushtetit (fuqisë), për shkak se të drejtat e këtyre fëmijëve nuk janë të pranuar si duhet, për shkak se fëmijët mund të ekspozohen në vështirësi plotë-

suese, kur janë në cilësinë e ndihmuesit të procesit juridik, aq më shumë pasi janë vulnerabil dhe kanë nevojë për mbrojtje të posaçme në përputhje me moshën e tyre, nivelin e pjekurisë dhe nevojat e posaçme individuale, me çka edhe do të pengohet viktimizimi i fëmijëve.

Është e pakontestueshme se pjesëmarrja e fëmijëve-viktima nga dhuna ose nga veprat penale në procedurat e gjyqësisë është me rëndësi qenësore për procesimin efikas të akuzave për vepra penale, duke përfshirë edhe rastet e eksploatimit seksual të fëmijëve, tregtisë me fëmijë dhe forma tjera të krimit të organizuar transnacional, ku fëmijët janë shpeshherë dëshmitarët e vetëm.

Është fakt që fëmijët-viktima të dhunës ose të veprave penale kanë nevojë për mbrojtje të posaçme, për asistencë dhe mbështetje e cila përputhet me moshën e tyre, pjekurinë dhe nevojat e posaçme individuale, me qëllim që të pengohet viktimizimi i mëtejshëm si rezultat i pjesëmarrjes në procesin e gjyqësisë penale.

Meqenëse është imperativ detyrimi për specializim të procedurave, të cilat praktikohen për vepra penale, në të cilat fëmijët janë viktima të dhunës ose të veprave penale, organet kompetente mund të veprojnë vetëm nëse posedojnë arsim adekuat, dituri të posaçme dhe përvoja në sferën e së drejtë së fëmijës dhe mbrojtjes juridiko-penale të fëmijëve-viktima.

Standardet ndërkombëtare përcaktojnë kufi të caktuara minimale, të cilat duhet të hasen në çdo legjislacion nacional, me qëllim që të garantohet mbrojtja e fëmijëve viktima të dhunës ose të veprave penale.

Në këtë kontekst standardet parashohin që:

- Marrjen në pyetje dhe format tjera të hulumtimit duhet t'i zbatojnë profesionistë të trajnuar, të cilët sillen me respekt ndaj fëmijës .
- Të gjitha kontaktet me fëmijën duhet të bëhen në mjedis adekuat, që do t'i përmbush nevojat e posaçme të fëmijës dhe në gjuhën që e kupton dhe e flet fëmija, me qëllim që të ketë mundësi më të volitshme për pjesëmarrje (bashkëpunim) nga vetë fëmija .,
- Fëmijët viktima dhe dëshmitarë, prindërit ose tutorët e tyre, nga kontakti i parë me sistemin juridik duhet të informohen me kohë dhe në mënyrë adekuate për të drejtat e tyre ,
- Duhet të përcaktohen masa për të kufizuar kontaktet e panevojshme ndërmjet fëmijës dhe sistemit juridik, siç është kufizimi i numrit të intervistave të fëmijës (marrjes në pyetje) dhe përdorimi i video xhirimit si dëshmi .,
- Fëmijët viktima të kenë të drejtë për ilaç juridik, siç është përcaktuar në legjislacionin nacional për reintegrim të plotë dhe rimëkëmbje .
- Fëmijët viktima duhet të kenë qasje në shërbime për ndihmë dhe mbështetje, siç janë shërbimet financiare, juridike, këshillëdhënëse, shëndetësore, sociale dhe arsimore, shërbimet për rimëkëmbje fizike dhe fiziologjike dhe të gjitha shërbimet tjera të nevojshme për reintegrim të fëmijëve përmes organizatave qeveritare, vullnetare dhe organizatave tjera )
- Duhet të nxitet formimi, fuqizimi dhe zgjerimi i fondeve nacionale për kompensim të viktimave.







## QËLLIMET THEMELORE TË PROCEDURAVE

Procedurat janë hartuar me qëllim që të respektohen parimet themelore nga të cilat burojnë të gjithë nenet e Konventës për të drejtat e fëmijës:

- mosdiskriminim;
- interesat më të mira të fëmijës;
- e drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit;
- e drejta e pjesëmarrjes (participimi në marrjen e të gjitha vendimeve, të cilat kanë rëndësi për të).

Procedurat kanë të bëjnë me të gjithë fëmijët-viktima pa diskriminim, gjegjësisht pavarësisht nga statusi familjar, prejardhja etnike, statusi juridiko-penale dhe cilado formë e karakteristike sociale ose individuale (raca, ngjyra e lëkurës, gjinia, gjuha, besimi, nacionaliteti, specifikat mendore ose fizike të fëmijës së mitur dhe familjes së tij ose anëtarëve të familjes).

Miratimi i procedurave duhet të kontribuojë në sigurimin e mbrojtjes së integritetit dhe interesave më të mira të fëmijës.

Procedurat duhet të kontribuojnë në afirmimin e të drejtave të fëmijëve, (dhënien e të gjitha informacioneve të nevojshme), shprehjen e opinionit personal në të gjitha procedurat, të cilat kanë të bëjnë me të, t'i përputhen moshës së tij dhe ta kuptojnë gjendje, në të cilën janë ata.

**Procedurat promovojnë krijim të mjedisit të posaçëm për bisedë me fëmijët-viktima, gjegjësisht hapësirat e posaçme për zhvillim të intervistës –bisedës me fëmijën-viktimë përmes përdorimit të mjeteve moderne audio-vizuele, gjegjësisht mjeteve teknike për komunikim.** Pra synohet që procedurat të paraqesin një udhëzues gjithëpërfshirës me udhëzime për profesione të ndryshme ose institucione në sferën e “drejtësisë për fëmijë”, por edhe të përmirësohet kompetenca e profesionistëve, të cilët veprojnë me fëmijët viktima dhe të rritet ndjeshmëria e këtyre profesionistëve.

Këto procedura janë të para në serinë e udhëzimeve dhe dokumenteve për fëmijët viktima dhe kanë për qëllim të përcaktojnë standarde të praktikës, me çka në masë të konsiderueshme do të përmirësohet cilësia e shërbimeve për fëmijët viktima dhe njëkohësisht do të merren si shkallë (bençmark) për çdo organizatë ose person, të përfshirë në sistemin “drejtësi për fëmijë”.

#### **Këto procedura duhet të mundësojnë:**

- të kontribuohet në avancimin e mirëqenies së fëmijëve përmes luftimit të dhunës dhe të zvogëlohet efekti i viktimizimit sekondar në procedurën penale;
- të kontribuohet në sigurimin e të gjitha masave, veprimeve, aktiviteteve dhe veprimeve të ndërmarra gjatë procedurës penale, që të jenë në interes më të mirë të fëmijës;
- të mundësohet krijimi i procedurave efikase dhe të vetme, të cilat do të sigurojnë procedurë të vazhdueshme dhe të koordinuar, e cila do t'i mbrojë fëmijët-viktima nga viktimizimi i mëtejshëm dhe do të sigurojë ndihmë adekuate;
- të kontribuohet në realizimin e rrjedhës efikase të informacioneve ndërmjet njësive organizative të ministrive dhe organeve tjera shtetërore dhe shërbimeve të përfshira në procesin e mbrojtjes së fëmijëve-viktima.
- ta njihen dhe formohen njohuritë e profesionistëve për rregulloren e përgjithshme nacionale dhe ndërkombëtare për fëmijë, të cilët paraqiten si viktima të dhunës ose të veprave penale,
- të theksohen masat e ndihmës dhe mbrojtjes, të cilat mund të shfrytëzohen në çdo fazë të procedurës, me qëllim të zvogëlimit ose eliminimit të efekteve të dëmshme të dhunës ose të veprës penale ndaj fëmijës-viktimë dhe të merren informacione për masën më adekuate, të cilën duhet ta zbatoni, me çka do të arrini rezultate më të mirë me kufizim më të vogël ose suspendim të të drejtave të interesit të fëmijës.
- t'i ndihmohen dhe orientohen fëmijët, në lidhje me të drejtat e fëmijëve-viktima të dhunës ose veprës penale, e në veçanti për të drejtat e tyre në procedurën e dëmshpërblimit,
- të zbatohen metoda dhe teknika të bisedës me fëmijën-viktimë të cilat janë më adekuate në procedurën e zhvillimit të intervistës-bisedës me fëmijën-viktimë të dhunës ose veprës penale, me qëllim që të shmanget viktimizimi i mëtejshëm ose shtrembërimi i ngjarjes, që do të shpinte në përjetimit më të rëndë të vetë ngjarjes,



- të njoftohen (profesionistët) me teknikat më të mira për ngjarjen juridiko penale, të cilën e ka përjetuar fëmija, ashtu që qysh gjatë zhvillimit të intervistës së parë të arrijnë ta fusin (rastin) në “karantinë” si dhe të marrin sa më shumë informacione,
- të promovohet krijimi i një mjedisi të posaçëm për bisedë me fëmijë-viktima, gjegjësisht hapësira të posaçme për intervistë-bisedë me fëmijën-viktimë përmes përdorimit të mjeteve moderne audio-vizuale, gjegjësisht mjeteve teknike për komunikim.



# 3

## DEFINIMI I KONCEPTIT VIKTIMË DHE KONCEPTIT FËMIJË-VIKTIMË TË DHUNËS OSE VEPRËS PENALE

### DEFINICIONI PËR VIKTIMËN në të drejtën ndërkombëtare

Viktima paraqet çdo person fizik, i cili ka pësuar ndonjë ligësi, përfshirë edhe çrregullim psikik dhe mendor, vuajtje emocionale ose humbje parash, të shkaktuara nga kryerja ose moskryerja (lëshimi), me çka shkelet ligji juridiko-penal i shtetit anëtar. Aty ku është e mundshme, termi viktimë i përfshin, edhe anëtarët më të ngushtë të familjes së viktimës, të cilët janë në varësi nga viktima në fjalë.

### Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec (2006) 8 Komiteti i ministrave të vendeve anëtare për ndihmë të viktimave të krimit

Nocioni “viktimë” në legjislacionin penal të shtetit është definuar disa herë edhe atë në këta mënyra:

#### A. LIGJI PËR DREJTËSI PËR FËMIJËT

Fëmijë-viktimë është çdo fëmijë deri në moshën 18 vjeçare, i cili ka pësuar dëm, duke përfshirë dëmtim fizik dhe mendor, vuajtje motive, humbje materiale, gjegjësisht dëmtim ose kanosje tjetër të të drejtave dhe interesave si pasojë e veprimit të kryer, i cili me ligj trajtohet si vepër penale.

## B. KODI PENAL

**Me nocionin viktimë të veprës penale** nënkuptohet çdo person, i cili ka pësuar dëm, përfshirë dëmtim fizik dhe mendor, vuajtje emocionale, humbje materiale ose dëmtim dhe kanosje tjetër të të drejtave dhe lirive themelore të tij si pasojë e kryerjes së veprës penale. **Me nocionin fëmijë viktimë** të veprës penale nënkuptohet personi i mitur deri në 18 vjeç.

## C. LIGJI PËR PROCEDURË PENALE

**Viktima e veprës penale** është çdo person, i cili ka përjetuar dëm, përfshirë dëmtim fizik dhe mendor, vuajtje emocionale, humbje materiale, dëmtim ose kanosje tjetër të të drejtave dhe interesave të tij si pasojë e kryerjes së veprës penale.

### Të drejtat e viktimës / neni 53 i Ligjit për Procedurë Penale (LPP)/

Viktima e veprës penale i ka të drejtat në vijim: 1) të marrë pjesë në procedurë penale si i dëmtuar me përfshirje në ndjekje penale ose për mënjanimin e kërkesës për dëmin juridiko-pronësor; 2) në kujdes dhe vëmendje të veçantë nga ana e organeve dhe subjekteve të cilët marrin pjesë në procedurën penale dhe 3) ndihmë efikase psikologjike dhe ndihmë tjetër profesionale dhe mbështetje nga ana e organeve, institucioneve dhe organizatave për ndihmë viktimave për vepra penale.

Policia, prokurori publik dhe gjykata veprojnë me kujdes të veçantë ndaj viktimave të veprave penale, duke u dhënë këshilla nga paragrafi (1) të këtij neni dhe nenet 54 dhe 55 të këtij ligji dhe kujdeset për interesat e tyre gjatë miratimit të vendimeve për ndjekje penale kundër të akuzuarit, përkatësisht gjatë marrjes së veprimeve në procedurën penale në të cilën viktima doemos duhet personalisht të marrë pjesë, për çfarë hartohet një shënim zyrtar ose proces-verbal.

Në pajtim me rregullat e veçanta, viktima e veprës penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg prej së paku katër vitesh ka të drejtë për:

- 1) këshilltar në llogari të mjeteve buxhetore para dhënies së dëshmisë, përkatësisht deklaratës ose parashtrimit të kërkesës për të drejtën juridikopronësore, nëse ka lëndime të rënda psikofizike ose pasoja më të rënda nga vepra penale dhe
- 2) kompensim të dëmit material dhe jomaterial nga fondi shtetëror në kushte dhe mënyrë të përcaktuar me ligj të veçantë, nëse kompensimi i dëmit nuk mund të sigurohet nga i dënuari.

### Të drejtat e veçanta për kategoritë e cenuara të viktimave:/neni 54 i LPP-së/

(1) Viktimat e kanë të drejtën e masave të veçanta në mbrojtjen procesore gjatë dhënies së dëshmisë dhe hetimit në të gjitha fazat e procedurës:

- 1) nëse në kohën e dhënies së dëshmisë janë në moshë nën 18 vjet;
- 2) nëse me dhënien e dëshmisë ose përgjigjes në pyetje të caktuar, do ta ekspozojë vetveten ose personin e afërt në rrezik për jetën, shëndetin ose integritetin fizik (viktima të rrezikuara);



- 3) nëse për shkak të moshës, natyrës dhe pasojave të veprës penale, invaliditetit fizik ose psikik ose gjendjes tjetër shëndetësore me rëndësi, të kaluarës shoqërore dhe kulturore, rrethanave familjare, bindjeve fetare dhe përkatësisë etnike të viktimës, sjellja e të akuzuarit, anëtarëve të familjes ose miqve të të akuzuarit ndaj viktimës, do të ketë pasoja të dëmshme për shëndetin e tyre psikik ose fizik ose negativisht do të ndikojë mbi cilësinë e dëshmisë së dhënë (viktima veçanërisht të ndjeshme).

Masat e posaçme të mbrojtjes së procesit i përcakton gjykata me propozim të prokurorit publik ose viktimës ose me vlerësimin e vet kur është e nevojshme të mbrohen viktimat e reziukuara dhe viktimat veçanërisht të ndjeshme.

Gjatë vendosjes për përcaktimin e masave të posaçme për mbrojtje të procesit nga paragrafi (2) të këtij neni, gjykata duhet ta marrë parasysh vullnetin e viktimës.

Gjykata doemos duhet të përcaktojë masë të posaçme për mbrojtje të procesit në rastet nga paragrafi (1) pika 1) të këtij neni, si vijonë:

- 1) kur fëmija viktimë ka nevojë për përkujdesje dhe mbrojtje të veçantë ose
- 2) kur fëmija është viktimë e tregtisë me njerëz, dhunës ose abuzimit seksual.

Në rastet nga paragrafi (4) të këtij neni, gjykata doemos duhet të përcaktojë, veç e veç ose së bashku me masë tjetër të posaçme, video incizim ose incizim të zërit për dëshminë dhe hetimin e fëmijës që të përdoret si provë në procedurë. Në raste ekskluzive, për shkak të rrethanave të reja të rastit, gjykata mund të urdhërojë që hetimi të përsëritet me fëmijën viktimë, por më së shumti edhe një herë edhe atë përmes shfrytëzimit të mjeteve teknike për komunikim.

Zbatimi i masave të posaçme për mbrojtjen e procesit të fëmijëve viktimë, është rregulluar me ligj të posaçëm.

### **Të drejtat e veçanta të viktimave të veprës penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, njerëzisë dhe të drejtës ndërkombëtare /neni .55 i LPP-së/**

Viktima e veprës penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, njerëzisë dhe të drejtës ndërkombëtare, përpos të drejtave nga neni 53 të këtij ligji, i ka edhe këto të drejta:

- 1) para hetimit të bisedojë me këshilltar pa pagesë ose me person të autorizuar, nëse në procedurë merr pjesë si i dëmtuar;
- 2) të merret në pyetje nga personi i të njëjtës gjini në polici dhe në prokurorinë publike;
- 3) të mos përgjigjet në pyetjet të cilat kanë të bëjnë me jetën personale të viktimës, ndërsa nuk janë të lidhura me veprën penale
- 4) të kërkojë marrjen në pyetje me ndihmën e mjeteve vizuale - të zërit në mënyrën të përcaktuar me ligj dhe
- 5) të kërkojë mënjanimin e publikut nga seanca kryesore.

Gjykata, prokuroria publike dhe policia janë të obliguara që ta këshillojnë viktimën për të drejtat e saj nga paragrafi (1) të këtij neni, më së voni para marrjes në pyetje për herë të parë për çfarë hartojnë shënim zyrtar ose procesverbal.

**Viktima e cila nuk është njoftuar për të drejtën e saj që në procedurë të marrë pjesë si e dëmtuar /neni 56 i LPP-së**

- (1) Viktima e cila nuk është e njoftuar për të drejtën e saj që të marrë pjesë në procedurën si e dëmtuar, ka të drejtë të paraqitet në polici ose prokurori publike si e dëmtuar deri në parashtrimin e aktakuzës, ndërsa para gjykatës deri në përfundim të seancës kryesore.
- (2) Fletëparaqitja e viktimës si i dëmtuar do të refuzohet nëse është evidente se nuk është e arsyeshme ose se është parashtruar me vonesë.







# DOMETHËNIA E NOCIONEVE

## A. FËMIJA

Standardet ndërkombëtare bëjnë me dije se fëmijë është çdo person i moshës në 18 vjeç.

“Fëmijë është qenia njerëzore, e cila nuk i ka mbush tetëmbëdhjetë vjeç, nëse në bazë të ligjit për fëmijë nuk arrihet më herët moshë e pjekurisë.” *(Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës, 1989; Udhëzime të Këshillit të Evropës për drejtësi miqësore për fëmijë, 2010)*

## B. FËMIJË VIKTIMA DHE DËSHMITARË

Nënkupton fëmijë dhe adoleshentë në moshën 18 vjeçare, të cilët janë viktimë ose dëshmitarë të krimit, pavarësisht nga roli i tyre në kundërvajtje ose në përndjekjen e shkelësit të pretenduar ose grupit të shkelësve (autorëve të veprës).

## C. PROFESIONISTË

Ka të bëjë me personat, të cilat në kontekst të punës së tyre, janë në kontakt me fëmijët viktimë dhe dëshmitarë të veprës penale ose janë përgjegjës për përballim me nevojat e fëmijëve në sistemin juridik, për të cilët zbatohen këto Udhëzime.

Këtu mund të përfshihen, por nuk duhet kufizuar vetëm në këta persona: avokatë dhe persona për mbështetje të fëmijës viktimë, praktikues të shërbimeve për mbrojtje të fëmijëve; kuadri i agjencive për kujdes social, prokurorë dhe, aty ku është e adekuate, avokatë të mbrojtjes; personel diplomatik dhe konsular; personel i programit për dhunë familjare; gjykatës; personel i gjykatës; persona zyrtarë, të cilët e zbatojnë ligjin; profesionistë mjekësorë dhe profesionistë për shëndet mendor; dhe punëtorë socialë;

#### Ç. PROCESI JURIDIK

Përfshin zbulimin e veprës penale, përgatitjen e ankesës, hetimit, përndjekjes dhe gjykimin dhe procedurat pas gjykimin, pavarësisht nëse rasti është drejtuar në sistemin juridik nacional, ndërkombëtar ose rajonal për persona të rritur ose të mitur, ose në sistem të thjeshtë joformal juridik;

#### D. KUJDESI NDAJ FËMIJËVE

Përcakton qasjen, e cila e balancon të drejtën e fëmijës për mbrojtje dhe i merr parasysh nevojat individuale dhe qëndrimet e fëmijës.

#### E. VIKTIMIZIMI SEKONDAR

Rëndësi të veçantë për udhëzimet ka edhe definicioni “Viktimizimi sekondar”. Për qëllimet e këtij doracakut e zbatojmë definicionin e OKB-së:

Viktimizimi sekondar ka të bëjë me viktimizimin e mëtejshëm, që nuk është paraqitur si rezultat i drejtpërdrejtë i veprës penale, por si rezultat i trajtimit të viktimës nga institucionet dhe/ose individët. Për shembull, mund të paraqitet, kur viktimja do të kujtohet në ngjarjet gjatë dëshmisë në gjykatë ose kur është në prezencë të autorit të krimit.

#### F. DREJTËSI PËR FËMIJË

Koncepti “Drejtësi për fëmijë” i përfshin fëmijët, të cilët kanë ra ndesh me ligjin (gjegjësisht fëmijë, të cilat kanë qenë të regjistruar, akuzuar ose njohur si shkelës të kodit penal), fëmijë të cilët janë gjetur në rolin e viktimës ose dëshmitarëve të krimit, si dhe fëmijë në rrezik nga përfshirja në sistemin juridiko-penal (qoftë për shkak të gjendjes sociale ose për shkak se kanë bërë ndonjë vepër, e cila do të konsiderohej vepër penale, nëse fëmija do të ishte i moshës me përgjegjësi penale).

Mund të thuhet se ky është koncept gjithëpërfshirës, i orientuar në favor të interesave më të mira të të gjithë fëmijëve, të cilët kanë rënë në kontakt me sistemin juridik dhe sistemet tjera relevante. Ai përfshin aspekte të ndryshme, siç është preventiva, diversioni, rehabilitimi, shërbimet për ofrim të ndihmës dhe mbështetja e masave të mbrojtjes.

Koncepti drejtësi për fëmijë dallon nga termi “drejtësi për të mitur”, për shkak se nuk i përfshin vetëm fëmijët, të cilët kanë rënë ndesh me ligjin, por të gjithë fëmijët, që janë në kontakt me ligjin, për shembull fëmijët viktimja dhe fëmijët dëshmitarë. Procedurat e procesit gjyqësor nëpër të cilat kalon fëmija, që ka rënë ndesh me ligjin janë dhënë më poshtë.





# 5

## PARIMET THEMELORE DHE TË DREJTAT RELEVANTE PËR MBROJTJE TË FËMIJËVE-VIKTIMA TË VEPRAVE PENALE

### 1. PARIMI I INTERESIT MË TË MIRË TË FËMIJËS

**“INTERESI MË I MIRË I FËMIJËS” GJITHNJË DUHET TË JETË PARIMI QË DO T’U DREJTOJË GJATË MARRJES SË VENDIMEVE PËR FËMIJËT**

Çdo fëmijë ka të drejtë që **interesat më të mirë** të tij të jenë me rëndësi primare në të gjitha vendimet, të cilat kanë të bëjnë me të , përfshirë edhe të drejtën e mbrojtje nga çdo formë të përhatisë, abuzimit ose braktisjes.

Konventa për të drejtat e fëmijës në nenin 3 e proklamon këtë parim të **interesave më të mira të fëmijës** duke i dhënë rëndësi parimit qenësor, i cili duhet të implementohet në të gjitha dokumentet dhe instrumentet, të cilët kanë të bëjnë me fëmijët.

Në këtë drejtim, të gjitha aktivitetet të cilët kanë të bëjnë me fëmijët, me rëndësi primare i kanë interesat e fëmijës, pavarësisht nëse ato i zbatojnë institucionet publike ose private për mbrojtje sociale, gjykatat, organet administrative ose organet.

## 2. E DREJTA E Pjesëmarrjes së plotë të fëmijës në procedurë

Mosha nuk duhet të jetë pengesë për **të drejtën e pjesëmarrjes së plotë** të fëmijës në procedurë. Çdo fëmijë duhet të trajtohet si dëshmitar i aftë, ndërsa dëshmia e tij nuk duhet të vlerësohet si e pavlefshme vetëm për shkak se mosha e fëmijës, derisa mosha e tij/saj dhe pjekuria të mundësojë dhënie të dëshmisë së kuptueshme dhe të besueshme, me ose pa mjete ndihmëse të komunikimi dhe/ose ndihmë tjetër.

## 3. SHPREHJA E LIRË E PIKËPAMJEVE TË TIJ

Çdo fëmijë ka të drejtë t'i **shpreh pikëpamjet**, mendimet dhe shqetësimet e tij, me fjalë të veta, që të njëjtat të merren parasysh në mënyrë adekuate.

Nëse është e pamundshme të përmbushen këndvështrimet dhe shqetësimet e fëmijëve, fëmijës duhet t'i shpjegohen shkaqet pse një gjë e tillë është ashtu .

### Ç. MBROJTJA E PRIVATËSISË

Fëmijëve dhe dëshmitarëve duhet mbrojtur **privatësia** si çështje e rëndësisë primare. Duhet të ndërmerren masa për mbrojtje të identitetit të fëmijës nga publiku .

## 4. PARIMI I NDALIMIT TË DISKRIMINIMIT

Në pajtim me këtë parim gjykata dhe institucionet tjera në zbatimin e këtij ligji i respektojnë dhe sigurojnë të drejtat e fëmijës viktimë pa kurrfarë diskriminimi, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, përkatësia në grup të marginalizuara, përkatësia etnike, gjuha, shtetësia, prejardhja sociale, religjioni ose besimi, lloje tjera të besimeve, arsimit, përkatësia politike, statusi personal ose shoqëror, pengesa mendore dhe fizike, mosha, gjendja familjare ose civile, statusi i pronës, gjendja shëndetësore ose cilado qoftë bazë, e paraparë me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara, prindi/prindërit, tutori/tutorët ose anëtarët e familjes së fëmijës.

Po ashtu gjykata dhe institucionet tjera gjatë zbatimit të Ligjit për drejtësi të fëmijëve i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për sigurim të mbrojtje së fëmijës nga të gjitha llojet e diskriminimit.

Çdo fëmijë duhet trajtuar **drejt dhe në mënyrë të barabartë**. Në raste të caktuara do të duhet të përcaktohen shërbime të posaçme për mbrojtje dhe përmbushje të të drejtave të fëmijës.

## 5. PARIMI I SPECIALIZIMIT TË ORGANEVE KOMPETENTE TË PËRFSHIRË NË PROCEDURË

Arsimi profesional, trajnimi në kuadër të shërbimit, kurset për freskim të njohurive dhe mënyra tjera adekuate të instruksionit duhet të shfrytëzohen maksimalisht me qëllim që të krijohet dhe ruhet niveli profesional i kompetencës së të gjitha organeve dhe institucioneve, të cilët kanë rol në procedurën me fëmijë.



Në pajtim me Ligjin për drejtësi për fëmijë, janë të specializuara gjykatat kompetente në procedurën kundër fëmijëve. Njësitë e specializuara gjyqësore për kriminalitet të fëmijëve janë formular në gjykata themelore me kompetencë të zgjeruar, këshillat për fëmijë dhe këshilltarët për fëmijë.

Gjykatësi për fëmijë, prokurori publik, avokati dhe zyrtarët e autorizuar të Ministrisë së punëve të brendshme, së paku pesë ditë gjatë vitit ndjekin trajnim të specializuar për drejtësi për fëmijë qoftë në vend ose jashtë vendit. Këshilli për fëmijë në gjykatën themelore përbëhet nga gjykatësi për fëmijë dhe dy gjykatës – anëtarë të trupit gjyqësor. Përveç organeve të lartpërmendura si të specializuara paraqiten edhe gjykatës - anëtarë të trupit gjyqësor, të cilët zgjedhen nga radhët e punëtorëve arsimorë, psikologëve, pedagogëve, punëtorëve socialë dhe persona tjerë, të cilët kanë përvojë në edukimin dhe arsimin e të rinjve.

Në veçanti specializimi vjen në shprehje në kompetenca e organeve tjera, të cilat nuk paraqiten si subjekt të procedurës penale kundër personave të rritur. Këtu do ta theksojmë edhe Qendrën për punë sociale, e cila është organ i specializuar në procedurë, e cila ka kompetenca të rëndësishme në këtë proces.

Specializimi i këtillë nuk kërkohet në procedurë kundër personave të rritur, por në rastet kur si viktimë do të paraqitet fëmijë, Ligji për drejtësi për fëmijë përcakton specializim të detyrueshëm të gjykatave, gjë që është plotësisht e arsyeshme pasi që fëmija viktimë është kategoria më vulnerable!

## 6. PARIMI I NDALESËS SË TORTURËS, SJELLJES MIZORE DHE JOHUMANE

Ky parim po ashtu paraqet parim qenësor, i garantuar me dokumente të shumta ndërkombëtare, prej të cilave si më i rëndësishëm paraqitet Konventa evropiane për të drejtat e njeriut. Kjo e drejtë është po ashtu e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Në pajtim me këtë parim asnjë fëmijë nuk guxon të ekspozohet në mizori ose veprime tjera mizore, johumane ose sanksione. Fëmija po ashtu ka të drejtë për mbrojtje të fuqizuar nga tortura ose procedura tjera johumane, nënçmuese ose nga sanksione.

Profesionistët duhet të ndërmarrin masa për **parandalim të parahative gjatë procesit të zbulimit, hetimit dhe përndjekjes**, duke përfshirë edhe frikësimin potencial, hakmarrjen ose viktimizimin sekondar.

## 7. SPECIALIZIMI PËR ZHVILLIMI TË BISEDËS

Intervistat, marrjet në pyetje dhe format tjera të hulumtimit duhet t'i realizojnë **profesionistë të trajnuar**, të cilët sillen me respekt ndaj fëmijës.

## 8. E DREJTA PËR MJEDIS ADEKUAT DHE HAPËSIRA PËR BISEDË

Të gjitha kontaktet duhet të realizohen **në ambient adekuat**, që i përmbush nevojat e posaçme të fëmijës, edhe atë në gjuhën, të cilën fëmija e përdorë dhe kupton, me qëllim që ta përmirësojë mundësinë për pjesëmarrje të fëmijës .

## 9. E DREJTA PËR TË QENË I/E INFORMUAR

Fëmijët viktimë dhe dëshmitarë, prindërit ose tutorët e tyre dhe përfaqësuesit ligjorë, qysh nga kontakti i tyre i parë me sistemin gjyqësor, duhet të **informohen** me kohë dhe në mënyrë adekuatë në lidhje me të drejtat e tyre e deri te shkalla e mundshme dhe adekuate, mes tjerash edhe për:

- Qasjen në shërbimet shëndetësore, psikologjike, sociale dhe shërbime tjera relevante, si dhe mjete për qasje në shërbime të tilla, së bashku me mbështetje juridike dhe forma tjerë të mbështetjes këshillëdhënëse ose përfaqësimit, kompensim dhe mbështetje urgjente financiare, aty ku është e zbatueshme,
- Procedura për procesin juridiko-penal për të rritur dhe persona të mitur, duke përfshirë edhe rolin e fëmijëve viktimë ose dëshmitarë, rëndësinë, kohën dhe llojin e dëshmisë, si dhe për mënyrat e “marrjes në pyetje” do të realizohet gjatë hetimit dhe gjyqimit,
- Mekanizmat ekzistuese për mbështetje të fëmijës, kur dorëzon ankesa dhe merr pjesë në hetim dhe procedurë gjyqësore;
- Vendet dhe koha specifike e marrjes në pyetje dhe ngjarjet tjera relevante;
- Qasje në masa të mbrojtjes;
- Mekanizmat ekzistuese për rishikim (revidim) të vendimeve, të cilat ndikojnë te fëmijët viktimë dhe te dëshmitarët;
- Të drejtat relevante të fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë në pajtim me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe Deklaratën për parimet themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimit të pushtetit.

Përveç kësaj, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë, prindërit e tyre ose tutorët dhe përfaqësuesit ligjorë patjetër duhet të informohen me kohë dhe në mënyrë adekuate deri në shkallën e mundshme adekuate për:

- Përparimi dhe natyra rastit specifik, duke përfshirë edhe kapjen, arrestimin dhe statusin e të paraburgosurit, të të akuzuarit dhe cila do qoftë ndryshime të pritura të këtij statusi, vendimi i aktpadisë dhe ndodhitë relevante pas gjyqimit dhe rezultati përfundimtar i ngjarjes;
- Mundësitë ekzistuese për të marrë kompensim të dëmit nga autori i krimit (veprës) ose nga shteti përmes procesit juridik, përmes procedurave alternative civile ose përmes procedurave tjera.

## 10. KUFIZIMI I KONTAKTIT TË PANEVOJSHËM NDËRMJET FËMIJËS DHE SISTEMIT JURIDIK

Duhet të përcaktohen masa për **kufizim të kontakt të panevojshëm ndërmjet fëmijës dhe sistemit juridik**, siç është kufizimi i numrit të intervistave me fëmijën dhe përdorimi i video xhirimeve si dëshmi.



## 11. E DREJTA PËR ILAÇ JURIDIK

Fëmijët viktimë kanë të drejtë për **ilaç juridik**, siç është përcaktuar në legjislacionin nacional, për reintegrim të plotë dhe rimëkëmbje.

## 12. E DREJTA PËR NDIHMË EFIKASE

Fëmijët viktimë duhet të kenë **qasje në shërbime për ndihmë dhe mbështetje**, siç janë shërbime financiare, juridike shëndetësore, sociale dhe arsimore, më tej shërbime për rimëkëmbje fizike dhe fiziologjike dhe të gjitha shërbimet tjera të nevojshme për reintegrim të fëmijëve përmes organizatave qeveritare, vullnetare dhe organizatave tjera

Gjatë ndihmës së fëmijëve viktimë dhe dëshmitarëve, profesionistët duhet të bëjnë çmos për ta koordinuar mbështetjen me qëllim që fëmija të mos ekspozohet në intervenime të skajshme.

Fëmijët viktimë dhe dëshmitarë duhet të marrin ndihmë nga persona për mbështetje, siç janë ekspertët për fëmijë viktimë/dëshmitarë, duke filluar nga raporti fillestar dhe duke vazhduar deri sa ato shërbime të bëhen të nevojshme.

Profesionistët duhet të krijojnë dhe implementojnë masa për t'ua lehtësuar fëmijëve dhënien e dëshmisë ose dhënies së argumenteve, me qëllim që të përmirësohet komunikimi dhe kuptimi në periudhën para gjyqimit dhe gjatë gjyqimit. Këta masa mund të përfshijnë:

- (a) Ekspertët për fëmijë viktimë dhe dëshmitarë duhet të fokusohen në nevojat e posaçme të fëmijës;
- (b) Personat për mbështetje, përfshirë edhe ekspertët dhe anëtarët përkatës të familjes duhet ta mbështesin fëmijën gjatë dhënies së dëshmisë;
- (c) Aty ku është adekuate, të emërtohen tutorë, të cilët do t'i mbrojnë interesat juridike të fëmijës.

## 13. E DREJTA E MBROJTJES NGA VËSHTIRËSITË GJATË PROCESIT JURIDIK

Profesionistët patjetër duhet të ndërmarrin masa për parandalim të vështirësive gjatë procesit të zbulimit, hetimit dhe përndjekjes, me qëllim që të mundësohet respektim të interesave më të mira dhe dinjitetit të fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë. Profesionistët duhet me kujdes t'iu qene fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë, që të mund: të sigurojnë mbështetje për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë, përfshirë edhe shoqërimin e fëmijës gjatë përfshirjes së tij/saj në procesin juridik, kur është në interes më të mirë të tij/saj; të sigurojnë siguri gjatë procesit, duke përfshirë edhe potencimin e pritjeve të qarta nga fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në raport me atë se çka duhet të presin nga procesi, me çka përforcohet besimi dhe siguria.

Pjesëmarrja e fëmijës në dëgjim dhe gjykim duhet të planifikohet paraprakisht dhe duhet siguar, se gjykimet do të zhvillohen pasi të praktikë, përveç nëse prolongimi nuk është në interes të fëmijës.

Përdorimi i procedurave adekuate për punë me fëmijë, përfshirë edhe hapësira për intervista, të cilat janë të dedikuara për punë me fëmijë, shërbime interdisiplinare për fëmijë, viktimë të integruara në lokacionin e njëjtë, ambienti i ndryshuar në gjykatë, i cili e ka parasysh fëmijë

dëshmitar, pauza gjatë dhënies së dëshmisë nga fëmija, dëgjime të caktuara në periudha të ditës, të cilat i përshtaten moshës së fëmijës, sistemi adekuat raportim, me qëllim që të sigurohet se fëmija shkon në gjykatë vetëm kur është e nevojshme dhe masa tjera përkatëse për lehtësim të dëshmisë së fëmijës.

Profesionistët po ashtu duhet të iniciojnë masa:

**Për kufizim të numrit të intervistave:** duhet të iniciohen procedura të posaçme për grumbullim të dëshmimeve nga fëmijët viktimë dhe dëshmitarë, me qëllim që të zvogëlohet numri i intervistave, deklaratave, dëgjimeve e në veçanti, kontakti i panevojshëm me procesin juridik, siç është përdorimi i video xhirimeve;

Për të qenë të siguar se **fëmijët viktimë dhe dëshmitarë janë të mbrojtur**, nëse është në pajtim me sistemin juridik dhe me respekt ndaj të drejtës së palës mbrojtëse, për marrje në pyetje nga vetë autori i supozuar i krimit: në raste kur është e nevojshme, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë duhet të intervistohen dhe pyeten në gjykatë, por të mos shihen nga autori i supozuar i krimit dhe duhet të sigurohen hapësira të ndara të pritjes në gjykatë dhe në hapësira private për intervistë;

Të sigurohet që fëmijët viktimë dhe dëshmitarë **të merren në pyetje, mbi parimin e kujdesit ndaj fëmijëve dhe mundësitë të mbikëqyrjes nga gjykatësit**, me çka do të lehtësohet dhënia e dëshmisë dhe do të zvogëlohet frikësimi i mundshëm, për shembull përmes përdorimit të mjeteve ndihmëse në dëshminë ose emërimin e ekspertëve psikologjik.

## 14. PARIMI I EMERGJENCËS

Në pajtim me parimin e emergjencës çdo veprim i gjyqit dhe i institucioneve tjera me fëmijën në zbatimin e dispozitave të këtij ligji duhet të zgjasë dhe të përfundojë në afat të arsyeshëm, që nuk do t'i dëmtojë interesat e tij.

Ligji për drejtësi të fëmijëve parashihet detyrim të gjykatave dhe organeve tjera, të cilat marrin pjesë në procedurën në raport me fëmijët, si dhe për organet dhe institucionet prej të cilave kërkohen raportime dhe mendime për veprim emergjent, ashtu që procedura penale ndaj fëmijëve të përfundojë në afat sa më të shkurtër kohor.

Parimin e emergjencës përdoren në procedurën penale, në të cilën fëmija paraqitet si viktimë e veprës penale. Sa më shumë që zgjat më shumë procedura, aq më shumë viktimizohet fëmija. Stërzgjatja e pritjes së “drejtësisë” mund edhe më ta dëshpërojë fëmijën dhe ta bëjë vulnerabil, të dëshpëruar dhe ta humb besimin në gjykatë. Kjo frikë mund të shkaktojë shtrembërim të imazhit të ngjarjes juridiko-penale nga e cila fëmija është viktimizuar. Zënia dhe dënimi përfundimtar i autorit të krimit është lehtësim i madh, i cili kontribuon që fëmija të ndjehet i strehuar dhe i mbrojtur nga sistemi.

Procedura duhet të jetë emergjente dhe e shkurtër, por edhe efektive dhe me respekt ndaj parimeve dhe të drejtave tjera, në të cilat bazohet ajo.

## 15. PARIMI I SEKRETIT OSE PARIMI I PROCESIT TË DIKSREACIONIT MADH

Gjykata dhe organet tjera, të cilat marrin pjesë në procedurë e kanë për detyrë të sigurojnë mbrojtje të privatësisë së fëmijës dhe familjes së tij. Kur i gjykohet fëmijës, gjithnjë përjash-



tohet publiku. Rregulli i njëjtë vlen edhe kur jep deklaratë fëmija viktimë e veprës penale, kur përjashtohet publiku. Publiciteti i plotë i procedurës penale, në të cilën paraqitet fëmija si viktimë e veprës penale, do të ishte kundërproduktiv ndaj interesave të fëmijës.

Përveç kësaj që u theksua më lartë, bëjani me dije gazetarëve, të raportojnë në pajtim me etikën gazetareske, gjegjësisht të mos paraqesin detaje nga procedura, pasi do të ishte në kundërshtim me interesat e fëmijës viktimë të veprës penale. Sa do që të jetë lënda në interes të publikut, megjithatë interesi i fëmijës viktimë është në rend të parë andaj assesi nuk guxon të viktimizohet më tej, të etiketohet dhe ekspozohet në paragjykime të mëtejme.

## 16. E DREJTA E DËMSHPËRBLIMIT

Gjithnjë kur është e mundur fëmijët viktima duhet të marrin dëmshpërblim, që të mund të fitojnë kompensim të plotë, reintegrim dhe rehabilitim. Procedurat për realizim dhe kryerje të dëmshpërblimit duhet të jenë të kapshme dhe të kenë ndjeshmëri për moshën e fëmijëve.

Dëmshpërblimi mund të përfshijë kompensim nga autori i krimit i shqiptuar nga gjykata penale, ndihmë nga programi për kompensim të viktimave të kryer nga Shteti dhe dëmshpërblim, i cili duhet të kompensohet, që është shqiptuar në procedurë civile. Aty ku është e mundur, nevojitet qasje ndaj shpenzimeve për reintegrim social dhe arsimor, trajtim mjekësor, kujdes për shëndetin mendor dhe shërbimet juridike. Duhet të iniciohen procedurat për të realizim të mandateve (urdhrave) për dëmshpërblim dhe pagesë të dëmshpërblimit para shqiptimit të dënimeve.

## 17. E DREJTA PËR MASA TË POSAÇME PREVENTIVE

Përveç masave preventive, të cilat duhet të krijohen për të gjithë fëmijët, nevojiten strategji të posaçme për fëmijë viktima dhe dëshmitarë, të cilët janë në veçanti vulnerabil ndaj viktimizimit ose recidivizimit.

Profesionistët duhet të krijojnë dhe implementojnë strategji të posaçme dhe gjithëpërfshirëse dhe intervenime në raste, kur ekzistojnë rreziqe, që fëmijët viktima edhe më tej mund të keqtrajtohen. Këta strategji dhe intervenime duhet ta marrin parasysh natyrën e viktimizimit, përfshirë edhe viktimizimin që ka të bëjë me maltretimin në shtëpi, eksploatimin seksual, abuzimin në institucione dhe tregtia e paligjshme. Strategjitë mund t'i përfshijnë qasjet e mbështetura në iniciativa qeveritare, qytetare dhe iniciativa të lagjeve.





# POLICIA

## PËRMBAJTJA

1.	Paraqitja dhe udhëzimi	26
2.	Evidentimi dhe dokumentimi	27
3.	Ndarja e lëndës	28
4.	Rregullat e procesit	28
	– Intervenimi në vendin e ngjarjes	28
	– Në stacionin e policisë	30
5.	Rregullat e zhvillimit të bisedës me fëmijën viktimë	32
6.	Rregulla për zhvillimin e bisedës me prindër	35
7.	Orientime për përgatitjen e kallëzimit penal	35
8.	Pasqyra e informimit pas paraqitjes në stacionin policor	36

Në pajtim me nenin 5 të Ligjit për policinë, zyrtarët policorë janë të detyruar të veprojnë për mbrojtjen e jetës, sigurisë personale dhe pronës së qytetarëve, për pengimin e kryerjes së veprave penale dhe kundërvajtjeve, zbulimin dhe kapjen e autorëve të veprës, si dhe për ndërmarrjen e masave të tjera për përndjekjen e autorëve të atyre veprave, të përcaktuara me ligj, si edhe për veprat e tjera.

**Zyrtarët policorë janë të detyruar të zbatojnë hetim në kohë, hetim rrënjësor dhe gjithëpërfshirës për të gjitha veprat penale në të cilat si viktimë paraqitet fëmija, të cilat janë kryer në kuadër të fushës së tyre të kompetencës e në pajtim me legjislacionin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.**

## 1. PARAQITJA DHE UDHËZIMI

Paraqitja bëhet te zyrtari kujdestar policor dhe mund të bëhet:

- me paraqitje nga familja,
- me paraqitje nga prindi,
- me paraqitje nga tutori,
- me paraqitje nga fëmija viktimë,
- me paraqitje nga fqinji,
- me paraqitje nga dëshmitari okular,
- me paraqitje telefonike,
- me vënie re personalisht nga zyrtari policor,
- me paraqitje nga institucioni,
- me paraqitje nga personat e tjerë juridikë etj.

Gjatë paraqitjes së rastit, zyrtari kujdestar policor është i detyruar të sigurojë sa më shumë informacione dhe të dhëna për rastin, për shkallën e rrezikut, për urgjencën dhe seriozitetin e tij.

Zyrtari kujdestar policor duhet:

- ta përcaktojë vendin e thirrjes,
- të sigurojë të dhëna për paraqitësin/autorin e veprës/viktimën,
- për atë se çka, ku dhe kur ka ndodhur ngjarja dhe a ekziston rrezik momental për shëndetin dhe jetën e dikujt,
- ta përcaktojë se a është lënduar dikush dhe a ka nevojë për ndihmë mjekësore,
- ta përcaktojë se a ka armë dhe a ekziston kërcënim për përdorimin e saj,
- ta përcaktojë se a ka fëmijëve të pranishëm dhe a ka nevojë për strehimin e tyre,
- të bëjë përshkrimin e autorit (pamja dhe veshja), ndërsa në rast të ikjes nga vendi i ngjarjes, duhet të përcaktohet orientimi në të cilin ai ka ikur dhe me çka ka ikur (veturë, motor, në këmbë etj.)



Zyrtari policor i cili e pranon thirrjen (veçmas kur paraqitja bëhet me telefon) duhet të insistojë që komunikimi të zgjasë sa më shumë, me qëllim që të sigurojë sa më shumë informata për ngjarjen që ka ndodhur, për nevojën e ndërhyrjes së shpejtë dhe të patjetërsueshme, me çka do të kishte mundësi që në mënyrën më të mirë të reagojë ndaj thirrjes, përkatësisht t'i ndërmarra masat përkatëse – udhëzimin e grupit për intervenim në vendin e ngjarjes për t'u ofruar mbrojtje viktimave dhe për ta penguar dhunën.

## 2. EVIDENTIMI DHE DOKUMENTIMI

Të gjitha paraqitjet dhe njoftimet e pranuar për fëmijët viktimë regjistrohen në evidencat zyrtare të MPB-së, si:

- Në librin e ngjarjeve ditore
- Hartohet proces-verbal për pranimin e kallëzimit penal ose
- Proces-verbal për paraqitjen e rastit;
- Evidentimi i intervenimeve;
- Dorëzimi i padive për kundërvajtje;
- Ankesa;
- Evidentimi i paraqitësit, viktimës, autorit të veprës;
- Regjistrimi i kallëzimit penal dhe veprave penale në regjistrin e analitikës.

Në librin e ngjarjeve ditore detyrimisht duhet të evidentohet ngjarja e paraqitur, përkatësisht thirrja telefonike, kush e ka pranuar thirrjen, kush ka dalë për intervenim, natyra e thirrjes (kualifikimi), të dhënat e përgjithshme të paraqitësit, numri i telefonit, informacione për autorin e veprës, përshkrimi i ngjarjes – çfarë ka ndodhur, vendi i ngjarjes, a është lënduar dikush dhe cili është karakteri i lëndimit, a është arrestuar dhe ndaluar autori i veprës dhe pjesa e shënimeve – masat e ndërmarra.

Nëse nuk bëhet fjalë për rast urgjent, përkatësisht kur ngjarja ka ndodhur ditën paraprake ose disa ditë më parë, zyrtari policor duhet ta informojë palën se në bazë të paraqitjes pala duhet të vijë vetë personalisht në njësinë rajonale policore dhe të paraqitet për ngjarjen që ka ndodhur.

Në raport me paraqitjen, zyrtarët policorë janë të detyruar t'i ndërmarrin të gjitha aktivitetet dhe masat e nevojshme, me qëllim që kështu ta pastrojnë rastin.

Në rastet kur paraqitësi i dhunës është fëmijë, ndërsa dhuna është kryer nga prindërit, zyrtari policor menjëherë duhet ta njoftojë inspektorin e dhunës familjare dhe të delikuencës së të miturve dhe Qendrën e Punëve Sociale, të cilët janë të detyruar që menjëherë t'i marrin masat dhe aktivitetet e nevojshme për konfirmimin e dhunës, strehimin e fëmijës viktimë dhe pastrimin e rastit.

## 3. NDARJA E LËNDËS

Pas paraqitjes së rastit dhe pranimin të paraqitjes, përkatësisht njoftimin për fëmijën viktimë, zyrtari kujdestar policor e njofton menjëherë inspektorin e delikuencës së të miturve,

mbajtësin e ndërrimit ose personin për pranim, të cilët janë të detyruar që, për shkak të mënjanimin të rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për jetën dhe integritetin fizik të fëmijës viktime, të dalin menjëherë në vendin e ngjarjes.

#### 4. RREGULLAT E PROCESIT

Gjatë veprimit të zyrtarëve policorë me fëmijët viktime, duhet të mbahet llogari për vetë marrëdhënien ndaj fëmijës që mos të shkaktohen pasoja më të mëdha se ato që janë shkaktuar nga vetë vepra penale.

Pasojat e marrëdhënies joadekuate nuk janë të tilla vetëm për integritetin moral, psikik, madje edhe fizik të fëmijës viktime, por edhe në raport me “mospërdorimin” e deklaratës si dëshmi gjatë procedurës, me çka dëshmimi i veprës penale është pamundësuar ose, së paku, është vështirësuar.

**Procedura që zhvillohet për vepra penale në të cilat fëmijët paraqiten si viktime në të gjitha fazat, përfshirë edhe procedurën policore, është urgjente.**

##### Intervenimi në vendin e ngjarjes

Policia është e detyruar që, pas pranimit të kallëzimit penal ose njoftimit për ekzistimin e dyshimeve së është kryer vepër penale për të cilën ndiqet procedurë gjyqësore zyrtarisht, pa vonesë duhet ta njoftojë me shkrim prokurorin publik.

Pas pranimit të paraqitjes ose njoftimit se fëmija viktime është viktimizuar ose se është në gjendje të rrezikut të pashmangshëm që të viktimizohet (p.sh. të keqpërdoret ose të eksploatohet), zyrtarët policorë menjëherë duhet të ndërmarrin masa, por në asnjë rast kjo nuk duhet të jetë pas kalimit të dyzet e tetë (48) orëve në këtë mënyrë:

**E para**, pas marrjes së njoftimit se ka ndodhur dhunë ndaj fëmijës, policia pa vonesë organizon dalje në vendin e ngjarjes, ndërsa përfaqësuesi i stacionit policor (kujdestari, mbajtësi i ndërrimit ose personi për pranim) e njoftojnë QPS-në dhe bashkërisht dalin në terren.

**E dyta**, para daljes në vendin e ngjarjes, zyrtarët policorë duhet të kërkojnë dhe të sigurojnë nga polici kujdestar informacione dhe të dhëna themelore për ngjarjen që ka ndodhur, për atë se çka ka ndodhur, ku ka ndodhur, a është dhunuesi agresiv ose a ka ndonjë send me të cilin mund ta rrezikojë jo vetëm jetën e viktimës, por edhe jetën e tyre. Kjo është e patjetërsueshme për shkak të veprimit me kohë dhe profesional ndaj masave dhe aktiviteteve që duhet të ndërmerren.

**E treta**, zyrtarët policorë patjetër duhet t'i sigurojnë informatat e mëposhtme: lokacioni, çka ka ndodhur, kush është i pranishëm në vendin e ngjarjes, informata për autorin e veprës, se a ka qenë i dyshuar dhe për çfarë veprash penale ka qenë i dyshuar, sa është besueshmëria që i dyshuari të rezistojë dhe të ketë armë zjarri ose ndonjë armë tjetër, të kërkojnë forca shtesë nëse ka nevojë, të kërkojnë informata për atë se a i është shqiptuar më parë masë e përkohshme për dhunë familjare, t'i kushtojnë kujdes asaj se a ka fëmijë në shtëpi dhe të marrin masa për mbrojtjen e tyre, ta largojnë autorin e veprës larg sendeve me të cilat ai mund të sulmojë/të vetëlëndohet, të komunikojnë vizualisht me kolegun/kolegët, të presin reagim të mundshëm nga ana e viktimës gjatë arrestimit të autorit të veprës.



**E katërta**, pas arritjes në vendin e ngjarjes (nëse dhuna vazhdon ende), gjëja e parë që duhet ta bëjnë zyrtarët policorë është që të ndërmarrin masa për mbrojtjen e viktimave të dhunës dhe pengimin e dhunuesit që ta vazhdojë edhe më tej dhunën. Nëse në vendin e ngjarjes ka njerëz të lënduar ose që kanë nevojë për ndihmë mjekësore, zyrtarët policorë janë të detyruar që t'ua sigurojnë ndihmën e nevojshme, e pastaj të kalojnë në sigurimin e vetë vendit të ngjarjes dhe sigurimin e materialit për dëshmi, deri në ardhjen e ekipit hetues që e ndërmerr dhe udhëheq hetimin, e mbledh materialin dëshmues, me qëllim që ta përpunojë më tej gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore.

Nëse nuk ka nevojë për këtë që e thamë më sipër, kalohet në sigurimin e mbrojtjes së viktimave dhe realizimin e bisedës fillestare me autorin e veprës dhe dëshmitarët (nëse ka të tillë), me qëllim të përcaktimit të rrjedhës së ngjarjes dhe elementeve të ekzistimit të veprës penale.

Nëse dëshmitar i dhunës ndaj fëmijës është një fëmijë tjetër, edhe ai i ka të drejtat e njëjta si edhe fëmija viktimë – alinea 1 e nenit 145 të Ligjit për të drejtat e fëmijëve.

**E pesta**, në rastet e dhunës në familje, ku përveç të rriturit viktimë janë edhe fëmijët, numri i zyrtarëve policorë që shkojnë në atë vend varet nga shkalla e rrezikut si për zyrtarët policorë, ashtu edhe për të tjerë që janë të përfshirë në pastrimin e rastit të dhunës, duke mbajtur llogari për profilin dhe prirjet e autorit të veprës. **(së paku dy zyrtarë policorë, nga të cilët njëri duhet të jetë i trajnuar për punë me fëmijë).**

Në përbërjen e ekipit që shkon në vendin e ngjarjes preferohet të ketë edhe zyrtar policor të gjinisë femërore **(përvojat flasin se zyrtarët policorë të gjinisë femërore arrijnë rezultate më të mira në raport me komunikimin me fëmijët viktimë të dhunës).**

**E gjashta**, nëse fëmija është viktimë e dhunës, zyrtari policor menjëherë e njofton Qendrën e Punëve Sociale (QPS) dhe koordinohet me të që të mund të sigurojë mbrojtje të nevojshme për fëmijën. Në rast të nevojës për strehim dhe vendosje të viktimës, zyrtarët policorë vendosin kontakt me QPS-në përkatëse. Përfaqësuesi i QPS-së duhet të jetë i pranishëm para se të bëhet çfarëdo marrje në pyetje e fëmijës dhe bashkë me inspektorin e delikuencës së të miturve vendosin se kush duhet të jetë i pranishëm në marrjen në pyetje të fëmijës (mbrojtës, prind/tutor i fëmijës ose cilido person tjetër i pavarur, të cilit fëmija i beson).

**E shtata**, zyrtari policor bën vlerësimin e rrezikut dhe planin e shpëtimit para çfarëdo intervenimi për shpëtimin e fëmijës viktimë. Plani duhet të përgatitet dhe të diskutohet paraprakisht bashkë me QPS-në. Vlerësimi i rrezikut duhet të bëhet po ashtu pasi të shpëtohet fëmija viktimë ose pasi të merret lënda për fëmijën viktimë. Vlerësimi duhet të bëhet bashkë me QPS-në. Me këtë rast patjetër duhet të merret parasysh se, përveç viktimës, në rrezik mund të ekspozohen edhe personat e tjerë, siç janë anëtarët e familjes, miqtë, dëshmitarë, si dhe të gjithë të tjerët që punojnë në atë lëndë. Po ashtu duhet të merret parasysh edhe moshja, gjinia, gjendja sociale e viktimës dhe faktorët e tjerë të lëndueshmërisë së viktimës.

**E teta**, kur merren informacione se është kryer dhunë ndaj fëmijës në institucion ose në ent, policia është e detyruar të ngrejë procedurë për vërtetimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, të mbledhë dëshmi dhe të ngrejë procedurë para institucioneve përkatëse jashtë institucionit.

Prioritet i policisë është që ta pengojë/pamundësojë autorin e veprës në vazhdimin e sjelljes së dhunshme dhe ta mbrojë viktimën nga dhuna, t'i sigurojë mbrojtje adekuate shëndetësore, varësisht nga lëndimet ose të kërkojë ndihmë të shpejtë.

Pas ofrimit të ndihmës mjekësore, nevojitet korrespondencë me shkrim me institucionin shëndetësor, me qëllim që të sigurohet dokumentacioni mjekësor me kualifikim të lëndimeve të shkaktuara ndaj fëmijës viktimë, e cila dërgohet në Prokurorinë Publike, ku do të shërbejë si material dëshmues në procedurën e mëtejme.

**E nënta**, policia në rastet e dhunës ndaj fëmijëve ka të drejtë që përkohësisht t'i marrë sendet që kanë të bëjnë me vetë aktin ndaj fëmijës dhe ato mund të shërbejnë si dëshmi në procedurën penale. Për procedurën e mbledhjes së materialit dëshmues **gjithnjë kryhen konsultime me Prokurorin Publik**.

**Kur hetohet rast i dhunës ndaj fëmijëve dhe mbrojtja e tyre, policia e ka për detyrë PRIMARE që ta vërtetojë se cili është autori i veprës e cili viktimë (një ose më shumë) në rastin konkret. Detyra SEKONDARE e policisë është procedura e mbledhjes së materialit dëshmues dhe dokumentimi i rastit.**

### Në stacionin e policisë

Policia është e detyruar të veprojë me kujdes të veçantë ndaj fëmijës viktimë të veprës penale, duke e udhëzuar në pajtim me parimet e LDF-së (Ligjit për të drejtat e fëmijëve) dhe është e detyruar të kujdeset për interesat e tij gjatë marrjes së vendimeve për ndjekjen penale kundër të akuzuarit, për çka hartohet shënim zyrtar ose proces-verbal.

Në procedurën policore fëmija viktimë i veprës penale ka të drejtë:

- Për ndihmë juridike nga avokati gjatë dhënies së deklaratës, përkatësisht për deklaratë ose dorëzim të kërkesës pronësore-juridike,
- Për kompensim të dëmit material dhe jomaterial në pajtim me programin e nenit 151 të LDF-së, nën kushte dhe në mënyrën e përshkruar me nenin 152 të LDF-së – nëse kompensimi i dëmit nuk mund të sigurohet nga i gjykuari dhe
- Për të autorizuar nga marrja e deklaratës së parë, si dhe gjatë gjithë procedurës.

Zyrtari policor është i detyruar ta mësojë fëmijën viktimë për të drejtat e tij, më së voni para marrjes së tij në pyetje dhe për këtë duhet të mbajë shënim zyrtar ose proces-verbal.

Zyrtari policor është i detyruar që në afat prej 12-orësh të dorëzojë në gjykatën përkatëse propozim për shqiptimin e masës së përkohshme të mbrojtjes – mënjanimin e autorit të veprës nga shtëpia dhe ndalimin e afrimit të tij në shtëpi.

Zyrtari policor është i detyruar që në afat prej 12-orësh që nga intervenimi për ngjarjen, ta njoftojë qendrën përkatëse për punë sociale që të mund të marrë masa për mbrojtjen e fëmijës viktimë.



Zyrtari policor përgatit raport, jo më vonë se 12 orë nga intervenimi në ngjarje.

Zyrtari policor i siguron rezultatet mjekësore nga kontrolli i kryer, ato materiale duhet të futen në dosje dhe të gjitha dokumentet e ngjashme që kanë lidhje me rastin duhet të dërgohen te prokurori publik.

Zyrtari policor patjetër gjithnjë duhet të bëjë vlerësimin e rrezikut dhe integritetit trupor të fëmijës viktimë. Vlerësimi duhet të bëhet bashkë me QPS-në.

Fëmija viktimë ka të drejtë për masa të veçanta të mbrojtjes gjatë procesit, gjatë dhënies së deklaratës dhe gjatë hetimit në të gjitha fazat e procedurës:

- Rekomandohet të sigurohet transport i veçantë, hapësira të veçanta për pritje dhe hapësira në të cilat bëhet marrja në pyetje.
- Viktima gjithnjë duhet të ndahet nga autori i veprës, madje edhe nëse tutori i veprës penale është po ashtu fëmijë.
- Nëse ka nevojë, zyrtarët policorë duhet të sigurojnë vendosje të viktimës në një strehimore të sigurt. Stacioni policor ose cilido repart tjetër i paraburgimit mund të konsiderohen të sigurt, por ato nuk janë adekuate për një viktimë që ka përjetuar traumë.
- Marrjen në pyetje të viktimës duhet ta bëjnë personat e trajnuar për punën me fëmijë.

Përveç prindit dhe/ose mbrojtësit, edhe përfaqësuesi i **QPS-së patjetër duhet të jetë i pranishëm para se të bëhen çfarëdo marrje në pyetje e fëmijës.**

---

**Me fëmijën viktimë të dhunës mund të realizohet vetëm një bisedë, pas konsultimit paraprak me prokurorin publik, i cili do të japë orientime për marrjen në pyetje. Marrjen në pyetje patjetër duhet ta bëjë zyrtari policor për punë me fëmijë ose përfaqësuesi i QPS-së.**

---

Gjatë veprimit me fëmijën viktimë patjetër duhet të respektohet këto rregulla:

1. Zyrtarët policorë në çdo kohë duhet ta respektojnë të drejtën e fëmijës për privatësi dhe ta respektojnë besueshmërinë e informatave dhe evidentimin që ka të bëjë me rastet me fëmijë, për të cilat ata kanë zhvilluar ose zhvillojnë hetime, që nga fillimi i hetimit, si për fëmijën viktimë dhe për fëmijën autor të veprës, ashtu edhe në vazhdimësi pas përfundimit të hetimit;
2. Gjatë marrjes në pyetje, duhet të respektohen të gjitha rregullat e përmendura më sipër. Këtu duhet të theksohet se mbrojtja e viktimave fillon në momentin e identifikimit të tyre si viktimë dhe zgjat derisa zgjat edhe procedura gjyqësore. Prandaj më rëndësi të jashtëzakonshme është që viktima të identifikohet sa më herët, që kështu të mund të fitohet mundësi për qasje në rast dhe të përdoren masat mbrojtëse.

3. Me qëllim që ta mbrojnë fëmijën viktimë, zyrtarët policorë duhet të sigurojnë:
- Mbrojtjen e jetës dhe integritetit fizik të viktimës (siguria e viktimës);
  - Mbrojtjen e shëndetit psikologjik dhe mendor;
  - Mbrojtjen e privatësisë së viktimës dhe të identitetit të tij/saj;
  - Mbrojtjen nga përsëritja e viktimizimit të viktimës;
  - Mbrojtjen e viktimës nga ngritja e kallëzimit penal kundër tij/saj për vepra penale të cilat janë kryer derisa ai/ajo ka qenë nën ndikim të autorëve të veprës.

Nevoja e mbrojtjes së viktimave mund të luhetet varësisht nga faktorët, si: situata e tij personale, mosha dhe gjinia, vendi i prejardhjes, tipi dhe shkalla e vuajtjes nga dhuna, izolimi eventual nga familja dhe mjedisi, njohja e gjuhës që flitet në vend ose resurset financiare që janë në disponim të viktimës.

## 5. RREGULLAT E ZHVILLIMIT TË BISEDËS ME FËMIJËN VIKTIMË

Bisedën me fëmijët viktimë duhet ta kryejë zyrtari policor, i cili është i trajnuar të punojë me fëmijë.

Deklaratat e fëmijës viktimë duhet të evidentohen dhe/ose të bëhet një video-incizim me informim paraprak dhe pajtueshmëri nga viktimë. Me këtë do të mundësohet që fëmija viktimë të mos jetë i ekspozuar në biseda të shumëfishta gjatë procedurës dhe përsëritjes së viktimizimit.

Trauma mund të ndikojë në kujtimet e viktimës, andaj çfarëdo mospërputhje në përgjigjet që i jep viktimë nuk duhet të konsiderohen gënjeshtër.

---

**Fëmijët viktimë merren në pyetje nga zyrtarët policorë në hapësira të veçantë. Biseda zhvillohet vetëm një herë.**

---

### Pse?

- Për shkak të mbrojtjes së viktimës nga pasojat negative të viktimizimit zyrtar dhe
- Për shkak të krijimit të kushteve të këndshme, sa më “natyrore”, për dhënien dhe marrjen e deklaratës sa më cilësore, e cila do të jetë valide dhe do të mund të shërbejë si dëshmi në procedurën gjyqësore.

Rregullat që kanë të bëjnë me marrjen në pyetje të fëmijës autor të veprës penale duhet të përcillen edhe në rastin e fëmijës viktimë.

### A. KU ZHVILLOHET BISEDA?

- Në hapësirë speciale të përshtatur për punë me fëmijë
- Biseda nuk duhet të zhvillohet në banesën ku jeton fëmija
- Biseda nuk duhet të zhvillohet në vendin e ngjarjes.



## B. KUR ZHVILLOHET BISEDA?

- Biseda zhvillohet sa më shpejt pas ngjarjes

## C. KUSH E ZHVILLON BISEDËN?

- Zyrtari policor që është i trajnuar të punojë me fëmijë
- Personi profesionist i QPS-së në prani të zyrtarit policor
- Nëse ka dhomë me xham screen, bisedën e zhvillon personi profesionist i QPS-së, ndërsa zyrtari policor e përcjell bisedën nga hapësira tjetër.

## Ç. SI ZHVILLOHET BISEDA?

- Biseda duhet të zhvillohet vetëm një herë;
- Duhet të sigurohen informacione të hollësishme për gjendjen psiko-fizike të fëmijës, përparimin në shkollë, pjekurinë emocionale, pjekurinë kognitive, marrëdhënien me prindërit, moshatarët, sëmundjet eventuale kronike etj.;
- Vendosja e kontaktit fillestar me fëmijën, me qëllim që ai të çlirohet dhe të arrijë besim te zyrtari policor;
- Duhet të njihen dallimet e fëmijës dhe të krijohet situatë që i përgjigjet më shumë fëmijës;
- Marrëdhënia ndaj fëmijës duhet të jetë aktive, miqësore, mbështetëse;
- Qëllimi i takimit duhet të thuhet qartë dhe qysh më parë duhet t'i tregohet fëmijës se çka do të vijojë;
- Fëmija duhet ta dijë se nuk do të ndëshkohet;
- T'i lejohet që me fjalët veta ta tregojë atë që e di; nëse kalon në temë tjetër, duhet të kthehet me kujdes në temë
- Ndalohet frikësimi dhe përdorimi i forcës fizike.

**Rregulla e përgjithshme** gjatë zhvillimit të bisedës me fëmijë është që pyetjet të mos sugjerojnë përgjigje dhe të jenë të përshtatura ndaj nivelit zhvillimor të fëmijës.

Nuk rekomandohen pyetje **sugjestive dhe të mbyllura**, ndaj të cilave fëmija do të përgjigjet me “po” dhe “jo”.

Reziku i pyetjeve sugjestive pakësohet me mënyrën e formulimit dhe parashtrimin të pyetjeve që janë **të thjeshta dhe të hapura** (për shembull: Më thuaj çfarë ka ndodhur? Më thuaj diçka më shumë për këtë? Çka ka ndodhur pastaj?)

Do t'ia përsërisim fëmijës se nëse nuk e di përgjigjen, atë duhet ta tregojë:

Gjatë zhvillimit të bisedës me fëmijë zyrtari policor patjetër duhet:

- T'i mundësojë fëmijës të flasë në gjuhën e tij amtare përmes sigurimit të përkthyesit ose interpretuesit

- Të përdor gjuhë të kuptueshme për fëmijën dhe e cila është e përshtatshme ndaj moshës së tij;
- Ta ndjekë komunikimin joverbal të fëmijës;
- T'u shmanget reagimeve që te fëmija shfaqin mosbesim, dyshim dhe kundërshtim.

#### **D. PËRDORIMI I GJUHËS SENSIBILIZUESE GJATË ZHVILLIMIT TË BISEDËS ME FËMIJËN VIKTIMË**

Fëmijët viktimë janë shumë të ndjeshëm ndaj asaj se si e shprehin të rriturit shokun, hezitimin, neveritjen dhe hidhërimin. Nëse e shohin se hetuesi reagon me emocione të dallueshme, siç është neveria, keqardhja ose shoku, mund të bëhen agresivë, të turpërohen ose të mos dëshirojnë të flasin më shumë për atë.

Fëmijët viktimë kanë prirje që ta përshkruajnë ngjarjen deri në detaje, që mund të ndikojë për të menduar se bëhet fjalë për fantazi të bujshme. Këta fëmijë janë shumë të frikësuar dhe mund të presin që pas intervistës t'u ndodhë diçka e keqe, ashtu që duhet t'i bindim në të kundërtën.

Për shkak të ndjenjës së lojalitetit, fëmijët janë nën presion që të mohojnë, përkatësisht të mos dëshirojnë të deklarohen se kush i ka lënduar, sepse nuk duan që ai të shkojë në burg, nuk dëshirojnë që të dëmtohet familja, ndërsa gjithë kjo shkakton konfuzion dhe kundërtënie. Me shpresë se atë do ta mbrojë ai që e ka lënduar (i rrituri të cilit i kanë besuar më parë), fëmijët i kërcejnë detajet e ngjarjes.

#### **Gjatë bisedës me fëmijën viktimë, nevojitet që hetuesi t'u përmbahet këtyre principeve:**

- Hetuesi duhet të prezantohet, të shpjegojë se cili është roli i tij;
- Hetuesi duhet të jetë i përmbajtur, të qëndrojë i qetë dhe i interesuar për fëmijën;
- Hetuesi duhet të jetë i këndshëm ndaj fëmijës. Takimet e para gjatë kohës së krizës janë veçmas të vështira.
- Pyetjet nuk duhet të parashtrohen shumë herët.
- Përdoren fjalët që janë të kuptueshme për fëmijën;
- Fëmijës duhet t'i shpjegohet paraqitja, si dhe vendosja në institucion – nëse fëmija është vendosur;
- Hetuesi duhet të përgjigjet në pyetjet e viktimës dhe t'i tregojë të dhënat që i di;
- Duhet t'i dëshmohet fëmijës se i besojmë;
- Hetuesi duhet të lërë përshtypje se është i kënaqur me atë që ia ka treguar fëmija;
- Është me rëndësi që fëmijës t'i përsëritet: “Nuk është faji yt që ka ndodhur kjo”;



- Fëmija duhet të bindet se nuk është i vetmi që ka përjetuar këso situatë, por me qëllim që të pakësohet kuptimi i ngjarjes;
- T'i thuhet fëmijës se të rriturit ndonjëherë bëjnë gjëra të këqija dhe se ekziston ligji i cili nuk lejon që ndonjë i rritur t'i shkaktojë lëndime psikike, fizike ose seksuale;
- Hetuesi duhet të bëjë gjithçka që fëmija të qetësohet dhe të ndjehet i sigurt;
- Në një moment të dhënë hetuesi merret vesh për kontaktet e mëtejme, me çka dëshmon se është i brengosur për të.

## 6. RREGULLA PËR ZHVILLIMIN E BISEDËS ME PRINDËR

Kur bëhet fjalë për fëmijë viktimë, rëndom flitet me së paku një prind (tutor) që të sigurohet pasqyrë e plotë për fëmijën, për zhvillimin e tij dhe për reagimet në situata të vdekjes, dhunës familjare, fatkeqësive etj. Prindi dhe fëmija intervistohen **bashkë** dhe **ndaras**.

Nëse prindi dhe fëmija intervistohen bashkë, zyrtari policor është i detyruar që t'ia tërheq vërejtjen prindit që mos ta ndërpresë ose që ai të ndërhyjë në bisedën me fëmijën. Ai duhet t'ia shpjegojë se roli i prindit është t'i japë mbështetje fëmijës që të flasë me zyrtarin policor. **Biseda e përbashkët** me fëmijën dhe prindin shërben për vlerësimin e cilësisë së interaksionit ndërmjet fëmijës dhe prindit, ndërsa ka edhe funksion të "përcjelljes" së besimit të prindit ndaj intervistuesit, përkatësisht për përgatitjen e fëmijës për bisedë të pavarur me intervistuesin. **Biseda e ndarë** me prindin mundëson që të shqyrtohen detajet për të cilat fëmija nuk është mjaft i vetëdijshëm.

## 7. ORIENTIME PËR PËRGATITJEN E KALLËZIMIT PENAL

Koha e përgatitjes së kallëzimit penal duhet të vendoset në afat sa më të shkurtër kohor që nga paraqitja e tij në Prokurorinë Themelore Publike.

Duhet të kihet kujdes në veprën penale Lëndimi trupor, neni 130, i cili ndiqet me propozim të viktimës, sepse afati i parashtrimit të saj është tri muaj.

Përgatitja e kallëzimit penal bëhet nga inspektori i inkuadruar në pastrimin e veprës penale të kryer gjatë dhunës familjare, kjo në bazë të sigurimit të dëshmive materiale:

- Konsultimi me prokurorin publik (sipas nevojës, varësisht nga rasti);
- Përcjellja e kallëzimit penal në evidentim dhe përpunim të Repartit të Analizës Kriminallistike Kundërzbuluese;
- Përcjellja e kallëzimit penal deri te Prokuroria Publike.

# PASQYRA E INFORMIMIT PAS PARAQITJES NË STACIONIN POLICOR



## RAPORTUESI

(familja, prindi, tutori, fëmija-viktimë, dëshmitari, institucioni etj.)



HAPËSIRA PËR BISEDË  
ME FËMIJËN



## STACIONI POLICOR

Zyrtari policor kujdestar



INSPEKTORIN PËR  
DELIKUENCË TË TË  
MITURVE

UDHËHEQËSIN E  
NDËRRIMIT OSE ZYRTARIN  
POLICOR PËR PRANIM



ENTIN  
SHËNDETËSOR


PRINDIN

MBROJTËSIN

PROKURORIN  
PUBLIK

QENDRËN  
PËR PUNË  
SOCIALE

# VEPRIMI I POLICISË ME FËMIJËN VIKTIMË







# PROKURORI PUBLIK

## PËRMBAJTJA

1.	Puna profesionale në Prokurorinë Themelore Publike (PTHP) – për veprimi me fëmijët-viktima	41
2.	Inicimi i procedurës penale	41
3.	Evidentimi dhe dokumentimi	43
4.	Shpërndarja	43
5.	Standardet dhe rregulla për drejtim të procedurës në PTHP	43
6.	Koordinimi dhe bashkëpunimi	45
7.	Veprimi me fëmijë autor të veprave penale (të cilat njëkohësisht mund të jenë edhe viktima të veprës penale)	48
	– A. Mosinicimi i procedurës	48
	– B. Procedura për ndërmjetësim	50

– C. Rrjedha e procedurës para prokurorit publik	51
– Ç. Procedura për arritje të marrëveshjes	52
8. Veprimi me fëmijë viktimë të veprës penale	53
9. Ndihma juridike në procedurën para Prokurorit Publik (PP)	55
10. Biseda me fëmijën- viktimë	55
11. Marrja në pyetje e viktimave dhe dëshmitarëve në veçanti vulnerabil	56
12. Masat e posaçme të procesit të mbrojtjes	57
13. Fëmijët si dëshmitarë në procedurë	58
14. Dokumentimi dhe mënyra e veprimit pas dorëzimit të kallëzimit	58



Procedura për veprim me fëmijë-viktimë ka të bëjë me punën e prokurorëve publik të Republikës së Maqedonisë. Zbatimi i këtyre procedurave është i detyrueshëm dhe siguron veprim standard të unifikuar në realizimin e procedurave, të drejtuara nga prokuroria publike për dhënie të shërbimeve për lloje të ndryshme të përdoruesve. Këta procedura mbështeten në standarde për drejtim të lëndëve si metodë për sigurim të shërbimeve për fëmijë dhe të rritur, me çka fuqizohen mbrojtja dhe avancimi i të drejtave personale.

Prokurorët publik gjatë implementimit të procedurave për veprim me fëmijë-viktima, veprojnë në pajtim me dispozitat e legjisllacionit vendor dhe ndërkombëtar dhe drejtohen nga këta parime të pranuar gjithandej:

- mosdiskriminimi,
- interesi më i mirë i fëmijës,
- e drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit,
- e drejta e pjesëmarrjes (participimit në marrjen e të gjitha vendimeve me rëndësi për të)
- prezumimi i pafajësisë,
- ligjshmëria dhe proporcionaliteti,
- ligjshmëria dhe dëshmitë,
- veprimi emergjent.

## 1. PUNA PROFESIONALE NË PROKURORINË THEMELORE PUBLIKE (PTHP) – VEPRIMI ME FËMIJËT-VIKTIMA

Prokuroria publike është organi i vetëm dhe i pavarur shtetëror, i cili përndjek autorët e veprave penale. Kjo e drejtë themelore dhe ky detyrim i prokurorit publik janë përcaktuar me Ligjin për prokurori publike, por edhe me Ligjin për procedurë penale. Procedura penale inicohet me kërkesë të paditësit të autorizuar.

## 2. INICIMI I PROCEDURËS PENALE

Prokurori publik informohet për kryerjen e veprës penale :

- përmes vërejtjes së drejtpërdrejtë,
- nga ajo që dëgjon ose
- nga zbatimi i kallëzimit penal.

Kallëzimit penal i dorëzohet prokurorit publik të rastit :

- me shkrim ose me gojë,
- me telefon,
- në formë elektronike ose
- me përdorim të mjeteve dhe mënyrave tjera teknike.

Kur kallëzimi dorëzohet përmes **pajisjes elektronike**, duhet të sigurohet regjistrim elektronik, ndërsa prokurori publik harton shënim të posaçëm zyrtar.

Kjo do të thotë se shënimet zyrtare do të evidentohen si pranim i kallëzimit penal në regjistrin përkatës, ndërsa në shënimet e lëndës do të gjendet regjistrimi elektronik për pranim të kallëzimit penal.

Mënyrë tjetër për dorëzim të kallëzimit penale është edhe **dorëzimi me shkrim**. Ai mund të jetë i drejtpërdrejtë, përmes vetë parashtruesit të prokurori publik ose përmes telefonit.

Te mënyra e këtillë e dorëzimit të kallëzimeve penale, prokurori publik e ka për detyrë t'ua tërheq vërejtjen parashtruesit për pasojat juridike të kallëzimit të rrejshëm (t'i informojë se një gjë e tillë paraqet vepër penale).

Për të gjitha raportimet me gojë, prokurori publik e ka për detyrë të hartojë proces verbal. Ky proces verbal do të evidentohet të regjistër si kallëzim penal.

Nëse kallëzimi penal dorëzohet përmes **telefonit**, prokurori publik e ka për detyrë të hartojë shënim zyrtar, i cili evidentohet në regjistër në kategorinë për kallëzime penale.

Nëse kallëzimi penal dorëzohet në polici, gjykatë ose te prokurori publik përkatës, ata do ta pranojnë kallëzimin dhe menjëherë do ta dorëzojnë te prokurori publik kompetent (neni 274 i LPP-së).

Në kallëzimet penale, në të cilat paraqitet dhunë, abuzim dhe braktisje (neglizhencë) të fëmijëve, veprojnë prokurorët publik të prokurorive publike, të cilët kanë përvetësuar njohuri të posaçme në sferën e të drejtave të fëmijëve dhe në sferën e mbrojtjes së tyre juridiko-penale.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurë Penale (LPP-së), për veprat, të cilat penalisht ndiqen me detyrë zyrtare (ex officio), e kanë për detyrë t'i dorëzojnë të gjitha organet shtetërore, ndërmarrjet dhe institucionet publike. Me dorëzimin e kallëzimit, parashtruesit do t'i theksojnë edhe dëshmitë, që i kanë të njohura dhe do të ndërmarrin masa për ruajtje të gjurmëve të veprës penale, gjësendet (objektet) që janë përdorë në kryerjen e veprave penale ose kanë dalë në shesh si rezultat kryerjes së veprës ose dëshmime tjera (neni 273 parag.1 dhe 2 i LPP-së).

Përveç këtyre normave juridiko-penale detyrimi parashihet edhe për të gjitha institucionet shëndetësore dhe arsimore, qendrat për punë sociale, organet gjyqësore dhe shtetërore, asociacionet e qytetarëve, andaj secili mund ta informojë prokurorin publik për nevojat e marrjes së masave për mbrojtje të të drejtave të fëmijëve.

Kallëzimet penale për të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe neglizhencës së fëmijës, në prokurorinë publike trajtohen në bazë të prioritetit, që nënkupton emergjencë në veprim dhe në marrje të vendimit.

Në fazën fillestare të procedurës për mbrojtje të fëmijëve, në veçanti duhet kushtuar vëmendje:

- dallimit të rasteve të dhunës, abuzimi dhe braktisjes si formë më e rëndë e neglizhencës,
- veprimit në pajtim me dispozitat e LPP-së, nga momenti i pranimit të kallëzimit penal e deri në momentin, kur prokurori publik është në dijeni për dyshi të bazuar për abuzim dhe braktisje të fëmijës,



- vlerësimi të rrezikut, gjendjes së nevojave të fëmijës dhe familjes së tij, në veçanti kur kallëzimi i është dorëzuar prokurorit publik përmes proces verbalit,
- koordinimit të të gjithë pjesëmarrësve në proces, me qëllim të marrjes së masave adekuata në drejtim të mbrojtjes.

Në lëndët e veprave penale, për të cilat parashihet përndjekje sipas detyrës zyrtare, prokurori publik (PP):

- i udhëzon veprimet e organeve kompetente në drejtim të zbulimit dhe kallëzimit të veprave penale dhe autorëve të këtyre tyre,
- propozon ose jep urdhër për të ndërmarrë masa të posaçme të hetimit, me kushte dhe mënyra të përcaktuara me LPP-në,
- jep urdhër dhe e realizon procedurën e hetimit,
- gjen, propozon dhe siguron dëshmi,
- dorëzon dhe përfaqëson padi para gjykatës përkatëse,
- ndërmerr edhe veprime tjera të parapara me ligj.

Prokurori publik e drejton procedurën parahetimore, gjatë së cilës e ka në dispozicion policinë gjyqësore, mirëpo edhe vetë mund t'i ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbulim të veprës penale, gjegjësisht zbulim dhe përndjekje të autorit të veprës, për çka është i autorizuar me ligj.

### **3. EVIDENTIMI DHE DOKUMENTIMI**

Të gjitha kallëzimet penale të pranuar për fëmijën viktimë shënohen në regjistër të posaçëm për raportime të pranuar për fëmijë dhe të mitur në rrezik, dhe evidentohen sipas radhitjes kronologjike.

### **4. SHPËRNDARJA**

Pas dorëzimit të kallëzimit ose pas pranimit të informacionit, prokurori publik i prokurorisë themelore publike, gjegjësisht nëpunësi i autorizuar i shpërndan informacionet e pranuar, gjegjësisht e dorëzon kallëzimin te prokurori publik përkatës, i cili realizon aktivitetet (inspektime policore, grumbullim të informacioneve të nevojshme, grumbullim paraparak të informacioneve, thirr persona) për të marrë vendim në lidhje me kallëzimin e bërë.

### **5. STANDARDET DHE RREGULLA PËR DREJTIM TË PROCEDURËS NË PROKURORINË THEMELORE PUBLIKE (PTHP)**

Në procedurën të cilën e drejton ose në të cilën merr pjesë prokurori publik, fëmijët mund të paraqiten në cilësi të ndryshme:

- si autorë të veprës penale,
- si viktimë të veprës penale dhe
- si dëshmitar të procedurës.

Në procedurën me fëmijë, e cila zhvillohet para prokurorit publik, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

Fëmija **ka të drejtë të informohet** nga të gjitha institucionet, të cilat vijën në kontakt me të, në lidhje me të drejtat e tij, të cilat përfshijnë detyrime dhe përgjegjësi, të përcaktuara me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe dokumentet tjera ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve.

Fëmija **ka të drejtë të merret në pyetje, të dëgjohet dhe të mësohet** për të drejtat e tij brenda procedurës dhe në lidhje me vetë procedurën.

Fëmija mbi moshën 14 vjeçare, edhe në kuadër të veprimit joformal të organeve dhe shërbimeve kompetente, edhe në procedurën gjyqësore, **i ka të garantuar të drejtat e njëjta**, të cilat i kanë personat e rritur, të paditur në procedurë penale ose të kundërvajtjes, gjegjësisht të drejtat e posaçme të pranuar me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe marrëveshjet tjera ndërkombëtare të ratifikuara, në të gjitha fazat e procedurës dhe në shqiptimin dhe kryerjen e cilitdo sanksion ose masë.

Edhe për fëmijët **vlen parimi i prezumimit të pafajësisë**, ashtu që nuk mund të llogaritet se fëmija ka rënë ndesh me ligjin, përderisa një gjë e tillë nuk verifikohet me vendim të plotfuqishëm gjyqësor.

Procedurat, në të cilat ka të përfshirë **fëmijë janë të karakterit emergjent (të shpejtë)**, ashtu që prokuroria publike dhe institucionet tjera e kanë për detyrë të veprojnë në afat të arsyeshëm, në mënyrë që t'i mbrojnë interesat e fëmijës.

Në punën e vetë prokurori publik vepron me kujdes të posaçëm ndaj viktimave të veprave penale, duke iu dhënë mësim për të drejtat e tyre, kujdeset për interesat e tyre gjatë marrjes së vendimeve për përndjekje penale kundër të pandehurit, gjegjësisht gjatë marrjes së veprimeve në procedurën penale, në të cilën viktimat duhet personalisht të merr pjesë, për çka hartohet shënim zyrtar ose proces verbal.

---

**Kategoritë vulnerabile kanë të drejtë për masa të posaçme të procesit të mbrojtjes gjatë dhënies së deklaratës dhe marrjes në pyetje në të gjitha fazat e procedurës, gjegjësisht nëse në kohën e dhënies së deklaratës janë nën moshën 18 vjeçare.**

---

Masat e posaçme të procesit të mbrojtjes i përcakton gjykata me propozim të prokurorit publik, viktimës ose vlerësimit personal kur është e nevojshme të mbrohen viktimat e rrezikuara dhe në veçanti të ndjeshme.

Gjatë vendosjes për përcaktim të masave të posaçme për procesin e mbrojtjes, gjykatësi duhet ta merr parasysh vullnetin e viktimës.

**Gjykata duhet të përcaktojë masa të posaçme të procesit të mbrojtjes në raste, në të cilat gjatë dhënies së deklaratës viktimat janë nën moshën 18 vjeçare, edhe atë:**

- kur fëmija-viktimë ka nevojë për kujdes të posaçëm dhe mbrojtje ose
- kur fëmija është viktimë e trafikimit me njerëz, dhunës ose abuzimit seksual.



## 6. KOORDINIMI DHE BASHKËPUNIMI

Koordinimi dhe marrëveshja për veprimet ndërmjet policisë dhe prokurorit publik zhvillohet drejtpërsëdrejti, me shkrim, me telefon ose me mjet tjetër për telekomunikim.

Në të gjitha rastet, në të cilat policia do të vlerësojë se për zbatim të procedurës nevojitet të përfshihen organet tjera shtetërore, për këtë do ta informojë prokurorinë publike.

---

**Prokurori publik mund me iniciativë të vetë ose me propozim të policisë të caktojë mbledhje këshillëdhënëse (koordinatave), për të caktuar mënyrën e përfshirjes së organeve tjera shtetërore në zbatimin e procedurës. Në këtë mbledhje përcaktohen mënyrat e bashkëpunimit, shkëmbimit të informacioneve dhe definohet veprimi i përbashkët i prokurorisë publike, policisë dhe organeve tjera shtetërore në zbatimin e hetimit.**

---

Në takimin e parë pas njoftimit me lëndën dhe marrëveshjen për veprim të mëtejshëm do të përcaktohen kontaktet personat për kontakte, koha dhe mënyra e informimit, kona dhe vendi takimit të ardhshëm, ndërsa sipas nevojës do të vendoset edhe për përfshirjen e organeve tjera në punën e lëndës.

Në takim përcaktohet se kush do të merr dhe përpilojë shënime për rrjedhën e mbledhjes dhe konkluzionet e arritura. Prokurori publik mund vetë ose me propozim të policisë ose të ndonjë organi tjetër shtetëror të vendos nëse policia ose ndonjë organ tjetër shtetëror mund të vazhdojë me punë të ndarë nga lënda, e pastaj për të të hartojë edhe raport.

Prokurori publik do t'i dorëzojë policisë një listë të prokurorëve publikë, gjegjësisht të zëvendësprokurorëve, të cilët policia mund t'i konsultojë jashtë orarit të punës.

### A. BASHKËPUNIMI NDËRMJET PROKURORIT PUBLIK DHE POLICISË

---

**Prokurori publik urdhëron, propozon masa, jep udhëzime për veprim, bën kontroll të masave dhe veprimeve, të cilat ndërmerren gjatë procedurave.**

---

Prokurori publik e drejton procedurën parahetimore. Policia e ka për detyrë, që pas pranimit të procedurës penale ose informacioneve për ekzistim të dyshimit të bazuar, se është kryer vepër penale, që ndiqet me detyrë zyrtare, pa prolongim ta informojë me shkrim prokurorin publik.

Zyrtari policor, i cili e ka informuar prokurorin publik për veprën penale të zbuluar, do të hartojë shënim zyrtar, nëse informacioni, të cilin ia ka dhënë prokurorit publik nuk ka qenë me shkrim.

Zyrtari policor, i cili e punon lëndën, e ka për detyrë, që me kërkesë të prokurorit publik, t'i kuptojë të gjitha detajet dhe të dhënat e procedurës parahetimore dhe ta informojë për zbatimin e masave dhe veprimeve të detyruara. Zyrtari policor dhe prokurori publik duhet për këtë veprim të hartojnë shënim zyrtar, nëse biseda është zhvilluar drejtpërsëdrejti ose përmes mjeteve të telekomunikimit.

Nëse ekziston dyshim i bazuar për veprë penale, për të cilën së paku parashihen 4 /katër/ vite burg ose ekzistojnë shkaqe për veprim emergjent, policia, gjegjësisht policia gjyqësore gojarisht do t'ia përcjell informacionin prokurorit publik. Pas informimit me gojë menjëherë duhet të vijojë informimi me shkrim.

Nëse policia pranon kallëzim penal nga personi i dëmtuar ose nga person tjetër fizik ose juridik, e ka për detyrë, që pa prolongim në orar të rregullt të punës ta dorëzojë deri te prokurori publik përkatës dhe ta informojë nëse ka ndërmarrë diçka vetë ose nëse ka filluar procedurë hetimore.

Nëse, së bashku me informacionin e dorëzuar ose kallëzimin penal, policia e informon prokurorin publik në lidhje me rrjedhën e procedurës parahetimore (inspektimet policore), prokurori publik mund ta informojë policinë se e merr përsipër mbikëqyrjen e procedurës hetimore dhe në atë rast do t'i jep policisë urdhër për zbatim të veprimeve dhe masave të caktuara hetimore, ose do të jep udhëzime në kuadër të procedurave standarde.

Prokurori publik e ka për detyrë të hartojë shënim zyrtar pas pranimit të informacionit, nëse informacioni nuk i është dhënë me shkrim. Në shënim duhet shkurtimisht të theksohet përmbajtja e informacionit, gjegjësisht nëse ka marrëveshje, që policia të vazhdojë me procedurë parahetimore ose procedurën (para)hetimore do ta merr përsipër prokurori publik.

Nëse "marrëveshja" për veprim në lidhje me lëndën është lidhur drejtpërsëdrejti, përmes telefonit ose përmes ndonjë mjeti tjetër telekomunikues, i cili nuk përmban shënime me shkrim, atëherë prokurori publik dhe zyrtari policor do të hartojnë shënim zyrtar.

Nëse prokurori publik vendos më tej, që vetë të vendos ta merr përsipër drejtimin e procedurës parahetimore ose ta mbikëqyrë zbatimin e procedurës hetimore, ai duhet ta informojë policinë për këtë vendim.

## B. KONSULTIME NË LIDHJE ME ÇËSHTJET JURIDIKE DHE FAKTIKE

Në lëndët e veprave penale të lehta, në të cilat nuk ka pranuar padi penale nga pala e dëmtuar, pas informimit të prokurorit publik, policia vazhdon me realizimin e inspektimeve dhe pas përfundimit të hetimit vendos në mënyrë të pavarur për përmbajtjen dhe kohën e dorëzimit të padisë penale.

Gjatë inspektimeve (procedura parahetimore), policia gjyqësore mund të kërkojë mendim nga prokurori publik, nëse një gjë e tillë është e nevojshme për shkak të disa çështjeve faktike ose juridike. Para dhënies së mendimit, prokurori publik mund të kërkojë nga policia raport për gjendjen e hetimit/inspektimit. Prokurori publik e ka për detyrë pa prolongim t'ia përcjellë policisë mendimin e tij.

Rëndësi më të madhe ka bashkëpunimi ndërmjet policisë dhe prokurorisë publike për hulumtim në rastet e rënda dhe të ndërlikuara. Nëse prokurori publik pas pranimit të informacionit nga policia për kryerjen e veprës së rëndë penale ose pas zbulimit të autorit të veprës së rëndë penale (ose nëse bëhet fjalë për lëndë të ndërlikuar), i dorëzon policisë informacion kthyes se ka vendosur ta mbikëqyrë procedurën parahetimore (inspektimet), atëherë policia pa urdhër (mandat nga prokurori) i merr përsipër të gjitha gjërat, për të cilat ekziston rreziku se mund të prolongohen. Për çështjet tjera do të vepohet sipas urdhrit të prokurorit publik



Nëse pas pranimi të informimit nga policia për kryerje të veprës penale, ose për zbulim të autorit të veprës penale, në veçanti nëse bëhet fjalë për lëndë të ndërlikuar, prokurori publik ka deklaruar se realizimin e procedurë parahetimore ia dorëzon policisë, policia mund të kërkojë takim për ta njoftuar prokurorin publik me lëndën dhe për t'u marrë vesh për veprimet e mëtejme.

Nëse prokurori publik e ka urdhëruar ose i ka propozuar policisë të zbatojë ndonjë ose veprim masë konkret, atëherë policia do ta informojë me kohë për vendin dhe kohën e zbatimit të asaj mase ose të atij veprimi. Në rast të rrezikut nga prolongimi i masës, veprimi ose pengimit të informimit të prokurorit publik, policia do ta informojë superiorin e tij ose prokurorin publik kujdestar. Me kërkesë të tij prokurori publik mund të prezantojë në realizimin e kësaj mase ose këtyre veprimeve.

### **C. MBLEDHJE KËSHILLËDHËNËSE**

Kur prokurori publik të vlerësojë se një gjë e tillë është e nevojshme, ai mund të caktojë mbledhje këshillëdhënëse në lidhje me zbatimin e procedurës parahetimore, të cilën ia ka dhënë policisë për detyrë.

Nëse policia gjatë procedurës parahetimore kërkon takim këshillëdhënës, atëherë prokurori publik pa prolongim e ka për detyrë të caktojë mbledhje të tillë në afat të arsyeshëm, në të cilin do t'i mundësohet policisë ta përgatitë lëndën.

### **Ç. VEPRIMI NË LËNDËT, NË TË CILAT NEVOJITET PJESËMARRJA E ORGANEVE TJERA SHETËRORE.**

Në të gjitha rastet, në të cilat policia do të vlerësojë se për zbatim të procedurës nevojitet të përfshihen organet tjera shtetërore, ajo do ta informojë prokurorinë publike.

Prokurori publik mund me iniciative të vetë ose me propozim të policisë të caktojë mbledhje këshillëdhënëse (koordinatave), me qëllim që të rregullohet mënyra e përfshirjes së organeve tjera shtetërore në zbatimin e procedurës.

Në këtë mbledhje përcaktohen mënyrat e bashkëpunimit dhe e shkëmbimit të informacioneve si dhe do të definohet veprimi i përbashkët i prokurorisë publike, policisë dhe organeve tjera shtetërore në zbatimin e hetimit. Që në takimin e parë pas njoftimit me lëndën dhe marrëveshjen për veprim të mëtejme do të caktohen persona për kontakt, do të caktohet koha dhe mënyra e raportimit, koha dhe vendi i takimit të ardhshëm, ndërsa sipas nevojës do të vendoset edhe për përfshirjen e organeve tjera në përpunimin e lëndës.

Në mbledhje përcaktohet se kush do të hartojë shënim për rrjedhën e takimit dhe konkluzionet e arritura.

Prokurori publik mund vetë ose me propozim të policisë ose të ndonjë organi tjetër shtetëror, të vendos nëse policia ose ndonjë organ tjetër shtetëror mund të punojë ndaras në lëndën përkatëse e pastaj të përpilojë raport.

## 7. VEPRIMI ME FËMIJË AUTOR TË VEPRAVE PENALE (TË CILAT NJËKOHË-SISHT MUND TË JENË EDHE VIKTIMA TË VEPRËS PENALE)

Prokuroria publike gjatë veprimit të saj **e ka për detyrë** t'i respektojë dhe mbrojë të drejtat e fëmijës pa kurrfarë diskriminimi, pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, përkatësisë së grupeve të marginalizuara, përkatësisë etnike, gjuhës, nënshtetësisë, prejardhjes religjionit ose besimit fetar, llojeve tjera të besimit, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, paaftësisë mendore ose fizike, moshës, gjendjes familjare ose civile, statusit të pronës, gjendjes shëndetësore ose çfarëdo qoftë baze e paraparë me ligj ose me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare.

Fëmijët deri në moshën 14 vjeçare nuk mbajnë përgjegjësi juridiko-penale, në fakt vetë Kodi përcakton se nuk është zbatueshëm ndaj fëmijës, i cili gjatë kryerjes së aktit, që me ligj parashihet si vepër penale, ende nuk i ka mbushur 14 vjeç.

Për veprën e fëmijës deri në moshën 14 vjeçare, e cila me ligj parashihet si vepër penale, prokuroria publike në parim nuk do të iniciojë procedurë, për të evituar ndikimin e dëmshëm ndaj fëmijës.

Në parim procedura iniciohet vetëm në rastet e parapara si vepra penale, nëse fëmija mbi moshën 14 vjeçare kryen vepër të përcaktuar si vepër penale, për të cilën parashihet dënim me burg deri në tre vite ose dënim më të rëndë, ose në rast kur qëllimi i masave ose sanksioneve të përcaktuara me Ligjin për drejtësi për fëmijë nuk mund të përmbushet pa procedurë të tillë.

Në procedurën para prokurorisë publike, fëmijët **kanë të drejtë për avokat**.

Në rastet e veprimeve të fëmijës në rrezik deri në moshën 14 vjeçare, të cilat me ligj përcaktohen si vepra penale, për të cilat parashihet dënim me burg prej së paku pesë vite ose kur është i kanosur personaliteti, të drejtat dhe interesat e fëmijës, **detyrimisht gjatë zhvillimit të bisedës merr pjesë edhe një avokat**, i cili i mbron të drejtat dhe interesat e fëmijës.

**Prezenca e avokatit është e detyrueshme** edhe në rastet kur prokurori publik propozon masa për fëmijë në rrezik mbi moshën 14 vjeçare, për veprime të cilat me ligj përcaktohen si vepra penale, gjegjësisht për të cilat përcaktohet dënim me burg prej tre vjet, nëse sipas vlerësimit të qendrës është i rrezikuar personaliteti, të drejtat dhe interesat e fëmijës dhe nëse në kuadër të ekipit profesionist nuk ka jurist.

Në rastet e këtilla prindërit, gjegjësisht tutorët e zgjedhin avokatin, ndërsa nëse ata nuk e bëjnë një gjë të tillë, atëherë qendra e përcakton një avokat me detyrë zyrtare nga lista e Odës së avokatëve të Republikës së Maqedonisë.

Nëse fëmija është në dispozicion, atëherë ndërpritet procedura te prokurori publik, ndërsa e njëjta vazhdo, kur fëmija të jetë në dispozicion.

### A. MOSINICIMI I PROCEDURËS

Pas kallëzimit për ndonjë vepër, e cila me ligj parashihet si vepër penale e kryer nga fëmijë mbi moshën 14 vjeçare, për të cilën parashihet gjobë ose dënim me burg deri në tre vjet, prokurori publik përkatës mund:



- të mos iniciojë procedurë para gjykatës, edhe pse ekzistojnë dëshmi se është kryer veprë, e cila me ligj parashihet si veprë penale, nëse konsideron se nuk do të ishte e përshtatshme të iniciohet procedura, duke pasur parasysh natyrën e veprës, e cila me ligj parashihet si veprë penale, por edhe rrethanat në të cilat është kryer ajo, duke pasur parasysh jetën e mëparshme të fëmijës dhe karakteristikat e personalitetit të tij, po ashtu prokurori mund të mos iniciojë procedurë para gjykatës edhe në raste kur është në rrjedhë e sipër shqiptimi i dënimit ose masës edukative
- ta prolongojë me kusht iniciimin e procedurës para gjykatës në afat prej gjashtë muajsh, me kusht që fëmija në atë afat të mos kryejë ndonjë veprë tjetër penale, e cila me ligj parashihet si veprë penale dhe ta kompensojë dëmin ose në ndonjë mënyrë tjetër t'i përmirësojë pasojat e dëmshme të shkaktuara nga kryerja e veprës, dhe
- të mos iniciojë procedurë nëse në bazë të raportit të qendrës vërtetohet se marrëveshja e arritur ndërmjet fëmijës, familjes së tij dhe palës së dëmtuar për kthim të pronës, kompensim të dëmit ose përmirësim të pasojave të dëmshme të veprës, mirëpo kjo procedurë nuk merret në shqyrtim, nëse si rezultat i veprës penale ka humbur jetën ndonjë person.

Prokurori publik mund ta merr vendimin për mosiniciim të procedurës, pasi të vlerësojë se rasti është i qartë, pasi ta informojë fëmijën dhe përfaqësuesin e tij ligjor për pasojat e vendimit dhe kur për të pajtohen fëmija dhe përfaqësuesi i tij ligjor, mbrojtësi dhe i dëmtuari, pas raportit të hartuar nga qendra për punë sociale.

Informimin e fëmijës dhe përfaqësuesit të tij ligjor, mbrojtësit dhe palës së dëmtuar e bën prokurori publik, përmes dërgimit të ftesës që të vijnë në zyrën (hapësirat e punës) e tij, ndërsa nëse ata nuk vijnë edhe përkundër pranimit të ftesës, atëherë konsiderohet se ata nuk japin pëlqim për vendimin e prokurorit publik.

---

**Nga ana tjetër, qendra për punë sociale e ka për detyrë, që me kërkesë të prokurorit publik, më së voni në afat prej një muaj, t'i dorëzojë atij raport në të cilin, do të përfshijë mendim dhe propozim në lidhje me marrjen e vendimit, përpos rrethanave tjera, që kanë të bëjnë me personalitetin e fëmijës dhe sjelljen e tij.**

---

Para marrjes së vendimit, prokurori publik, **mund të kërkojë raport të posaçëm nga Ministria e punëve të brendshme** për rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Prokurori publik, me përjashtim, ka mundësi, **që në afat prej 30 ditësh, të vendos të mos iniciojë procedurë** edhe për veprime për të cilat me ligj janë paraparë si vepra penale për të cilat është përcaktuar dënim me burg deri në pesë vjet, edhe pse ekzistojnë dëshmi se fëmija e ka kryer veprën, e cila me ligj është e përcaktuar si veprë penale, nëse konsideron se nuk do të ishte e përshtatshme të iniciohet procedura, duke pasur parasysh natyrën e veprës, e cila me ligj parashihet si veprë penale, por edhe rrethanat në të cilat është kryer ajo, duke pasur parasysh jetën e mëparshme të fëmijës dhe karakteristikat e personalitetit të tij.

Për të vërtetuar rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, prokurori publik e ka për detyrë **të kërkojë informacione** për jetën e mëparshme të fëmijës nga prindërit, tutori ose nga perso-

na dhe institucione tjera, ndërsa kur një gjë e tillë është e nevojshme, mund këta persona dhe fëmijën t'i ftojë në prokurorinë publike, me qëllim që të njoftohet drejtpërsëdrejti.

**Në afat prej njëmuajsh** prokurori mund të kërkojë mendim nga qendra për përshtatshmërinë e inicimit të procedurës kundër fëmijës. Nëse për të marrë vendimin duhet të shqyrtohen karakteristikat personale të fëmijës, në marrëveshje me qendrën prokurori publik mund ta udhëzojë fëmijën në strehimore, ose në institucion për marrje në pyetje ose edukim, i cili mund të zgjasë më së shumti një muaj.

Po ashtu gjatë ekzekutimit të dënimit ose sanksionit tjetër, prokurori publik mund të vendosë të mos kërkojë inicim të procedurës për veprim tjetër, të përcaktuar me ligj si vepër penale e fëmijës, nëse në pajtim me peshën e asaj veprë, që me ligj parashihet si vepër penale, gjegjësisht dënimit dhe sanksionit të shqiptuar, nuk do të synohej inicimi i procedurës dhe shqiptimi i sanksionit për atë vepër.

Kur prokurori të vërtetojë se nuk është e përshtatshme të iniciohet procedurë ndaj fëmijës, do ta informojë të dëmtuarin, duke i theksuar shkaqet se pse nuk është iniciuar procedura. Pala e dëmtuar **mund në afat prej tetë ditësh** të kërkojë nga këshilli për fëmijë të vendos për inicim të procedurës.

Përcaktimin për të mos iniciuar procedurë e merr prokurori publik në formë të vendimit, ndërsa pjesëmarrësit, të cilët kanë dhënë pajtueshmëri për vendimin konsiderohet se kanë heq dorë nga ankimi i vendimit.

Vendimi për prolongim të kushtëzuar të procedurës të miratuar nga prokurori publik ose gjykata shënohet në evidencën e tyre dhe fshihet nga evidenca pas përfundimit të kohës së prolongimit.

Kjo do të thotë se për dallim nga veprimi ndaj personave të rritur, autorë të veprave penale, në të cilat prokurori publik është i detyruar të veprojë sipas parimit të legaliteti, përveç nëse janë të parapara përjashtime sipas dispozitave të Ligjit për procedurë penale, në procedurat ndaj të miturve pranohet veprimi sipas parimit të oportunitetit, gjegjësisht prokurorit publik i lihet në dispozicion të vlerësuesit se në cilat raste do të iniciojë, respektivisht në cilat raste nuk do të iniciojë procedurë penale kundër personave të mitur.

## B. PROCEDURA PËR NDËRMJETËSIM

Pas kallëzimit për veprim, që me ligj parashihet si vepër penale, për të cilin parashihet dënim me burg prej katër deri në pesë vjet, prokurori publik përkatës pas informimit paraprak me shkrim dhe pas pajtimit të fëmijës dhe përfaqësuesit të tij ligjor, mbrojtësit dhe të dëmtuarit mund t'i udhëzojë palët në procedurën e ndërmjetësimit.

Palët e kanë për detyrë ta dorëzojnë pajtimin me shkrim deri të prokurori publik ose të gjykata për fëmijë në afat prej tre ditësh, nga dita e inicimit të propozuar të procedurës së ndërmjetësimit. Nëse në afatin e përcaktuar palët nuk dorëzojnë pëlqim me shkrim, atëherë konsiderohet se është refuzuar propozimi për ndërmjetësim.

Në pajtim me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare udhëzimi për ndërmjetësim nuk lejohet për vepra penale kundër moralit dhe lirisë seksuale, si dhe për format e dhunës gjinore kundër femrave.



Në afat prej tri ditësh nga dorëzimi i pëlqimit me shkrim, përmes marrëveshjes palët përcaktojnë ndërmjetësues në gjykatën përkatëse për fëmijë dhe e informojnë prokurorin publik, gjegjësisht gjykatën për fëmijë, ndërsa nëse palët nuk mund të merren vesh, atëherë prokurori publik, gjegjësisht gjykata në afat prej tre ditësh e ka për detyrë të përcaktojë ndërmjetësues nga lista e emrave të ndërmjetësuesve dhe për këtë t'i informojë palët e lëndës.

Afati për përfundim të procedurës së ndërmjetësimit është më së shumti 45 ditë, nga dita e dorëzimit të pajtimit me shkrim deri të organi përkatës. Nëse brenda këtij afati nuk përfundon procedura e ndërmjetësimit, lënda kthehet të prokurori publik, ndërsa procedura gjyqësore vazhdon aty ku është ndërprerë.

Marrëveshjen e nënshkruar me shkrim prokurori publik e vërteton me vendim, me çka konstaton se është ndërprerë procedura, mirëpo nëse nuk e pranon marrëveshjen, pasi vlerëson se nuk janë përmbushur kushtet ligjore ose synimet e ndërmjetësimit, atëherë procedura vazhdon aty ku është ndërprerë.

## C. RRJEDHA E PROCEDURËS PARA PROKURORIT PUBLIK

Procedura ndaj fëmijës 14 vjeçar për veprime, të cilat me ligj përcaktohen si vepra penale **iniciohet vetëm me kërkesë të prokurorit publik.**

Për veprimet që me ligj parashihen si vepra penale, të cilat ndiqen penalisht me propozim ose me padi private, **mund të iniciohet procedura para prokurorit, nëse personi i dëmtuar në afat prej tre muajsh pasi të mësojë veprën penale ose për autorin e veprës penale**, dorëzon propozim për inicim të procedurës deri te prokurori publik përkatës.

Nëse prokurori publik nuk dorëzon kërkesë për të iniciuar procedurë kundër fëmijës, atëherë do ta informojë palën e dëmtuar. Pala e dëmtuar nuk mund ta iniciojë procedurën, gjegjësisht nuk mund të dorëzojë padi private deri te gjykata, por në afat prej tetë ditësh nga pranimi i informimit nga prokurori publik mund të kërkojë, që këshilli për fëmijë i gjykatës përkatëse të merr vendim në lidhje me iniciimin e procedurës.

Para se të vendos, nëse do të dorëzojë kërkesë për inicim të procedurës përgatitore, prokurori publik e dëgjon fëmijën në prezencë të prindërve të tij, tutorëve dhe mbrojtësve, përveç nëse gjendja e tij psikofizike nuk e lejon atë. Nëse fëmija ose prindi/prindërit e tij, tutori/tutorët e tij nuk angazhojnë mbrojtës, atëherë prokurori publik me detyrë zyrtare ua përcakton një mbrojtës nga lista e Odës së avokatëve të Republikës së Maqedonisë.

Prokurori publik e ka për detyrë të sigurojë mbrojtje të privatësisë së fëmijës dhe familjes së tij, ndërsa gjatë marrjes së veprimeve, në të cilat është prezent fëmija, në veçanti gjatë marrjes në pyetje duhet të veprojë me shumë kujdes, duke mbajtur llogari për zhvillimin mendor (psikik) ndjeshmërisë dhe karakteristikat personale të fëmijëve, që të mos ndikojë në drejtimin e dëmshëm të zhvillimit të fëmijës.

---

**Fëmija merret në pyetje në përputhje me moshën e tij, rrethanat e ngjarjes dhe gjendjes së tij psikofizike.**

---

**Fëmija ftohet përmes prindërve, gjegjësisht tutorëve**, përveç nëse një gjë e tillë nuk është e mundshme për shkak të nevojës së veprimit të shpejtë ose rrethanave tjera.

Prokurori publik dorëzon kërkesë për inicim të procedurës përgatitore deri te gjykatësi për fëmijë nga gjyqi përkatës për fëmijë.

Në veprimet e procedurës përgatitore mund të merr pjesë edhe prokurori publik.

Veprimet, të cilat ligji i përcakton si vepër penale, për të cilat parashihet dënim me burg deri në tre vjet, pas marrjes në pyetje të fëmijës nga gjykatësi për fëmijë, prokurori publik mund t'i dorëzojë propozim këshillit për fëmijë për shqiptim të sanksioneve pa zbatim të procedurës përgatitore, nëse ngjarja është shpjeguar sa duhet dhe nëse të dhënat e grumbulluara për personalitetin e fëmijës japin bazë të mjaftueshme për marrje të vendimit.

Masë të paraburgimit mund të përcaktojë gjykatësi për fëmijë kundër fëmijës vetëm me propozim të prokurorit publik, pas mendimit të marrë paraprakisht nga qendra. Paraburgimi mund të shqiptohet vetëm si masë përfundimtare, nëse nuk janë përmbushur kushtet për zbatim të masave tjera për sigurim të prezencës së fëmijës të parapara me Ligjin për procedurë penale.

Nëse gjykatësi për fëmijë gjatë procedurës përgatitore vërteton se ekzistojnë shkaqe për ndërprerje të procedurës, për shkak se vepra me të cilën ngarkohet i pandehuri nuk parashihet me ligj si vepër penale, nëse është bërë vepër e vjetër, ose është përfshirë me akt të amnistisë ose faljes (abolicion), gjegjësisht nëse ekzistojnë rrethana tjera, të cilat e përjashtojnë përndjekjen, ose nëse nuk ka dëshmi se fëmija ka kryer vepër, e cila me ligj parashihet si vepër penale, atëherë do ta informojë prokurorin publik. Prokurori publik në afat prej tetë ditësh mund ta informojë gjykatësin për fëmijë se heq dorë nga ndjekja, ndërsa nëse nuk e bën këtë, gjykatësi për fëmijë do të kërkojë që për ndërprerjen e procedurës të vendosë gjykatat themelore për lëndë, në të cilat ka të përfshirë fëmijë.

Vendimi i këshillit për fëmijë për ndërprerje të procedurës i dorëzohet prokurorit publik, palës së dëmtuar dhe fëmijës, i cili nëse është në paraburgim lirohet menjëherë. Kundër këtij vendimi prokurori publik dhe pala e dëmtuar kanë të drejtë për ankesë deri te këshilli për fëmijë i gjykatës së apelit.

Pas përfundimit të procedurës përgatitore, gjykatësi për fëmijë ia dorëzon shënimet prokurorit publik, i cili në afat prej tetë ditësh mund të kërkojë të plotësohet procedura përgatitore, të jep deklaratë se heq dorë nga ndjekja e mëtejme penale ose të dorëzojë propozim të elaboruar të këshilli për fëmijë për zbatim të sanksionit.

Propozimi i prokurorit publik për zbatim të sanksionit duhet ta përmbajë emrin dhe mbiemrin e fëmijës, moshën e tij, përshkrimin e veprës, faktet me të cilat dëshmon se fëmija e ka kryer veprën penale, elaborimin se çka duhet të përmbajë vlerësimi i zhvillimit psikik (shpirtëror) i fëmijës dhe propozim që ndaj fëmijës të zbatohet sanksioni. Megjithatë këshilli për fëmijë nuk është i detyruar t'i përmbahet propozimit të prokurorit publik, kur të vendos nëse ndaj fëmijës do të shqiptojë dënim ose do të zbatojë sanksion.

## Ç. PROCEDURA PËR ARRITJE TË MARRËVESHJES

Kur të plotësohen kushtet për dënim të fëmijës në rrezik mbi moshën 14 vjeçare, prokurori publik mund të dorëzojë kërkesë për inicim të procedurës përgatitore, t'i propozojë fëmijës, mbrojtësit të tij, prindërve, gjegjësisht tutorëve që të realizohet procedurë e posaçme për praninë të përgjegjesisë dhe për marrëveshje për përmasën e dënimit. Propozim të tillë



prokurori publik mund të dorëzojë në rastet, kur disponon me dëshmi, të cilat padyshim bëjnë me dije se fëmija është autor i veprës penale, se fëmija është përgjegjës për veprën e kryer dhe se janë të përmbushura kushtet për shqiptim të dënimit.

Në procedurën për marrëveshje, prokurori publik do t'i grumbullojë nga qendra (për punë sociale) të gjitha raportet e nevojshme dhe dokumentet tjera për personalitetin e fëmijës dhe do të sigurojë pëlqimin e palës së dëmtuar.

Nëse pala e dëmtuar pajtohet me këtë propozim, prokurori publik i fton për marrëveshje publike fëmijën, përfaqësuesin e tij ligjor, mbrojtësin, qendrën dhe palën e dëmtuar. Nëse arrihet pajtim për marrëveshje, atëherë përpilohet marrëveshja dhe nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit.

Prokurori publik e dorëzon marrëveshjen deri te këshilli për fëmijë, i cili mund ta pranojë marrëveshjen dhe të merr vendim, me të cilin do ta shqiptojë sanksionin e propozuar, kundër të cilit nuk lejohet ankesë. Nëse gjykata nuk e pranon marrëveshjen, ia kthen lëndën prokurorit publik, i cili e ka për detyrë të dorëzojë kërkesë për inicim të procedurës përgatitore.

## 8. VEPRIMI ME FËMIJË VIKTIMA TË VEPRËS PENALE

Fëmijët mund të paraqiten si viktimë në të gjitha veprat penale, mirëpo në Kodin penal përcaktohen inkriminacione, në të cilat viktimë mund të jetë vetëm personi i mitur.

Ato janë këto vepra penale:

- vrasja e fëmijës gjatë lindjes, neni 126 i Kodit penal,
- sulmi seksual ndaj personit të mitur, i cili nuk i ka mbushur 14 vjeç, neni 188 i Kodit penal,
- shfaqja e materialeve pornografike personit të mitur, neni 193 i Kodit penal,
- prodhimi dhe distribuimi i pornografisë së fëmijëve, neni,193-a i Kodit penal
- mashtrimi për dhunim ose veprim tjetër seksual ndaj të miturit, që nuk i ka mbushur 14 vjeç, neni,193-b i Kodit penal
- jeta jashtëmartesore me person të mitur, neni 197 i Kodit penal,
- marrja e personit të mitur, neni 198 i Kodit penal,
- ndryshimi i gjendjes familjare, neni 199 i Kodit penal,
- braktisja e fëmijës së pafuqishëm, neni 200 i Kodit penal,
- braktisja dhe maltretimi i personit të mitur, neni 201 i Kodit penal
- shërbimi i pijeve alkoolike personave të mitur, neni 204 i Kodit penal dhe
- trafikimi me persona të mitur, neni 418-ç i Kodit penal.

Në më shumë inkriminime tjera parashihet formë e posaçme e kualifikuar e veprës penale, nëse viktimë është fëmijë.

Në pajtim e dispozitat e Ligjit për procedurë penale, të gjitha viktimat, përfshirë edhe fëmijët-viktimë të veprës penale i gëzojnë këto të drejta:

- për të marrë pjesë në procedurën penale si palë e dëmtuar duke u përfshirë në ndjekje penale ose në realizimin e kërkesës pronësore juridike për dëmshpërblim;
- për kujdes dhe vëmendje të posaçme nga organet dhe subjektet, të cilat kanë marrë pjesë në procedurën gjyqësore dhe
- për ndihmë efektive psikologjike dhe ndihmë tjetër nga organet, institucionet dhe organizatat për ndihmën e viktimave të veprave penale.

Prokurori publik gjatë procedurës gjyqësore vepron me kujdes të posaçëm ndaj viktimave të veprave penale, duke ua dhënë (thënë) të gjitha mësimet dhe shqetësimet për interesat e tyre gjatë marrjes së vendimeve për ndjekje penale kundër të pandehurit, gjegjësisht gjatë marrjes së veprimeve në procedurën penale, në të cilën viktima patjetër duhet personalisht të prezantohet, për çka harton shënim zyrtar ose proces verbal.

Viktima i veprës penale në pajtim me dispozitat e posaçme, me të cilën është paraparë dënim me burg prej së paku katër vitesh ka të drejtë:

- për angazhim të këshilltarit gjatë dhënies së deklaratës, ose gjatë dorëzimit të kërkesës pronësore juridike, shpenzimet e të cilit mbulohen me mjete buxhetore, nëse ka dëmtime të rënda psikofizike ose pasoja më të rënda nga vepra penale dhe
- për kompensim të dëmit material nga fondi shtetëror me kushte dhe mënyra të përcaktuara me ligj të posaçëm, nëse kompensimi i dëmit nuk mund të sigurohet nga personi i gjykuar.

Viktima e veprave penale kundër lirisë seksuale dhe moralit, njerëzisë dhe të drejtës ndërkombëtare, përkundër të drejtave paraprakisht të theksuara, i gëzon edhe këta të drejta:

- para marrjes në pyetje të bisedojë me këshilltar ose person të autorizuar pa pagesë, nëse në procedurë merr pjesë si palë e dëmtuar;
- në polici dhe në prokurori të merret në pyetje nga person i të njëjtës gjini;
- të mos përgjigjet në pyetje, lidhur me jetën personale të viktimës, të cilat nuk kanë të bëjnë me veprën penale;
- të kërkojë të merret në pyetje me ndihmën e mjeteve audio vizuale në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj dhe
- të kërkojë përjashtim të publikut nga seanca kryesore.

Prokurori publik gjatë procedurës hetimore e ka për detyrë **që më së voni para marrjes në pyetje ta mësojë viktimën për të drejtat e tij**, për çka do të përpilojë shënim zyrtar ose proces verbal.

Sipas Ligjit për drejtësi për fëmijët, fëmija-viktimë i veprës penale i gëzon këto të drejta:

- të trajtohet me respekt ndaj dinjitetit të tij,
- të mbrohet nga çfarëdo qoftë diskriminimi,
- të informohet për të drejtat e veta në gjuhë të kuptueshme dhe përkatëse për moshën e tij, si dhe të respektohet e drejta e privatësisë,



- të informohen prindërit, tutorët për të gjitha çështjet në lidhje me veprën penale dhe në lidhje me personin e dyshuar, të pandehur dhe të gjykuar,
- fëmija, prindërit, gjegjësisht tutorët të marrin pjesë në procedurën penale si palë e dëmtuar me përfshirje në ndjekjen penale ose në realizimin e kërkesë pronësore juridike për dëmshpërblim,
- të drejtë për mbrojtje të posaçme të sigurisë së tij dhe sigurisë së familjes së tij, kujdes dhe vëmendje nga organet dhe subjektet, të cilat marrin pjesë në procedurën penale,
- të drejtë për mbrojtje të posaçme nga viktimizimi sekondar ose riviktimizimi dhe
- të drejtë për ndihmë psikologjike dhe ndihmë tjetër profesionale dhe mbështetje nga organet, institucionet dhe organizatat për ndihmë të fëmijëve-viktima të veprave penale.

Në procedurë penale, fëmija-viktimë e veprës penale ka të drejtë:

- për ndihmë juridike nga avokati para dhënies së dëshmisë, gjegjësisht deklaratës ose dorëzimit të kërkesës pronësore juridike,
- për kompensim të dëmit material dhe jomaterial, nëse kompensimi i dëmit nuk mund të sigurohet nga personi i dënuar dhe
- për person të autorizuar nga dhënia e deklaratës së parë dhe gjatë gjithë procedurës.

## 9. NDIHMA JURIDIKE NË PROCEDURËN PARA PROKURORIT PUBLIK (PP)

Ndihma juridike e fëmijës-viktimë në parim siguron avokat, i cili ka ndjekur trajnim të specializuar për trajnim për të drejtat e fëmijës. Trajnimi zgjat së paku pesë ditë gjatë vitit dhe zhvillohet në vend ose jashtë vendit.

Prokurori publik, gjykatësi për fëmijë, avokati dhe personat e autorizuar zyrtar të Ministrisë së punëve të brendshme së paku pesë ditë gjatë vitit ndjekin trajnim të specializuar për drejtësi për fëmijët, qoftë të organizuar në vend dhe jashtë vendit.

## 10. BISEDA ME FËMIJËN-VIKTIMË

Prokurori publik bisedon me fëmijën-viktimë në cilësinë e dëshmitarit, duke u përkujdesur, që të mos ndikojë dëmshëm në zhvillimin e tij psikofizik dhe të zbatojë masa të procesit të mbrojtjes.

Gjatë marrjes së deklaratës gjegjësisht gjatë marrjes në pyetje të fëmijës dëshmitar ose viktimë, prokurori publik e ka për detyrë të mbajë llogari për karakteristika dhe cilësitë personale të fëmijës, me qëllim që t'i mbrojë interesat e tij dhe të përkujdeset për zhvillimin e tij të drejtë.

Fëmija-viktimë dhe fëmija dëshmitar i trafikimit me njerëz, dhunës dhe abuzimit seksual, viktimë dhe dëshmitar i veprimeve tjera që me ligj janë të parapara si vepra penale dhe veprave penale ndaj njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare, si dhe veprime tjera që me ligj parashi-hen si vepra penale, për shkak të natyrës së tyre, pasojave ose rrethanave tjera që e bëjnë

fëmijën në veçanti të ndjeshëm dhe i shkaktojë gjendje të rëndë shpirtërore, nuk lejohet të ballafaqohet me të dyshuarin, respektivisht me të pandehurin.

Të gjitha bisedat me fëmijën-viktimë duhet të realizohen në **ambient (hapësirë adekuate) për fëmijë, e cila ofron rehati dhe është e pajisur me mobilie për fëmijë dhe lodra**, që t'i përbush nevojat e posaçme të fëmijës, edhe atë në gjuhë, të cilën e përdor dhe e kupton ai, me qëllim që të përmirësohet mundësia e fëmijës për pjesëmarrje.

**Prokurori publik duhet të kufizojë marrjen e sërishme në pyetje të fëmijës-viktimë, nëse paraprakisht është marrë në pyetje nga policia. Video dhe audio xhirimi i deklaratës dhe marrjes në pyetje të fëmijës në procedurën policore duhet patjetër të përdoret në procedurën e mëtejme, përveç nëse në raste të jashtëzakonshme, për shkak të shfaqjes së rrethanave të reja**

Planifikimi i bisedës është hap i rëndësishëm andaj vetë mënyra e marrjes në pyetje të fëmijës duhet t'ia mbrojtë të drejtat dhe të shmang shkaktimin e çfarëdo shkelje të së drejtave të tij. Planifikimi duhet të përfshijë diskutim për atë se ku dhe kur do të zhvillohet biseda, kush duhet ta planifikojë bisedën me fëmijën dhe pyetjet, që do të planifikohen (që të mund të mbulohen sa më shumë gjëra si dhe të **mos ketë nevojë për të bërë intervista të shumëfishta nga agjenci të ndryshme**).

Kur fëmijë të arrijë pjekuri të duhur, ai mund të përfshihet në procesin e planifikimit, siç është vendimi, se ku dhe kur do të bisedohet me të.

## 11. MARRJA NË PYETJE E VIKTIMAVE DHE DËSHMITARËVE NË VEÇANTI VULNERABIL

LPP-ja në dispozitat e përgjithshme e përfshiu kategorinë **viktima dhe dëshmitarë në veçanti vulnerabil**, për të cilët janë të parapara të drejta të posaçme. Në dispozitat për marrje në pyetje të dëshmitarëve definohen edhe kushtet në të cilat merren në pyetje këta persona.

Nëse për fëmijën-viktimë ose dëshmitar përcaktohet se në pajtim me moshën, gjendje shëndetësore, natyrën ose pasojat e veprës penale, marrja në pyetje do të kishte pasoja të dëmshme ndaj shëndetit të tyre psikik dhe fizik, atëherë parashihet edhe mënyrë e posaçme e marrjes në pyetje:

- nëse organi, i cili e drejton procedurën vlerëson se është e nevojshme, atëherë dëshmitarit të këtillë i përcaktohet person i autorizuar gjatë periudhës së marrjes në pyetje
- pyetjet e dëshmitarit të kësaj kategorie mund të parashtrihen vetëm përmes organit, i cili e drejton procedurën, i cili ndaj atij personi duhet të silltet me vëmendje të posaçme, me qëllim që të shmangen pasojat e dëmshme të procedurës penale ndaj personalitetit të tij dhe ndaj shëndetit të tij fizik dhe psikik
- marrja në pyetje mund të bëhet me ndihmën e psikologut, punëtorit social ose personit tjetër profesionist, ndërsa organi i cili e drejton procedurën mund të vendos nëse personi do të merret në pyetje me anë të përdorimit të



mjeteve teknike për përcjellje të fotografisë dhe zërit, pa prezencë të palëve dhe personave tjerë në hapësirën në të cilën gjendet personi i dëmtuar ose dëshmitari, ashtu që palët, mbrojtësi dhe personat, të cilët kanë të drejtë t'i parashtrijnë pyetje, atë e bëjnë me ndërmjetësim të organit, që drejton procedurën, psikologut, pedagogut, punëtorit social ose personave tjerë profesionist.

## 12. MASAT E POSAÇME TË PROCESIT TË MBROJTJES

Si masa të posaçme të procesit të mbrojtjes gjatë dhënies së deklaratës mund të përcaktohen:

- përdorimi i ekraneve për mbrojtje të viktimës dhe dëshmitarit nga shikimi i të akuzuarit,
- mbulimi i identitetit ose pamjes,
- dhënia e deklaratës përmes videokonferencës,
- heqja e togave dhe kapelave,
- përjashtimi i publikut,
- video dhe audio xhirimi i deklaratës, e cila përdoret si dëshmi
- video dhe audio xhirimi i marrjes në pyetje, e cila përdoret si dëshmi,
- marrja e deklaratës përmes ndërmjetësimit të personit profesional,
- përdorimi i teknikave të posaçme për komunikim dhe
- mbrojtja e privatësisë së fëmijës dhe familjes së tij.

Në lidhje me procedurën për vepra të parapara me ligj si vepra penale, në të cilat fëmija paraqitet si viktimë, prokurorët publik mund të veprojnë vetëm nëse posedojnë arsim adekuat dhe nëse kanë njohuri të posaçme dhe përvojë në sferën e të drejtave të fëmijës dhe për mbrojtjen juridiko-penale të tyre, me çka bëhen përgjegjës për të ndërmarrë masa për ndihmën dhe mbrojtjen e fëmijës dhe për të vepruar në mënyrë që t'iu shmangen pasojave potenciale të dëmshme për personalitetin dhe zhvillimin e tij.

Masë e posaçme e procesit të mbrojtjes së fëmijës viktimë përcaktohet kur fëmija-viktimë ka nevojë për kujdes dhe mbrojtje të posaçme ose kur fëmija është viktime e trafikimit me njerëz, dhunës ose abuzimit seksual, si dhe veprave penale kundër njerëzisë dhe të drejtës ndërkombëtare, ose vepra tjera të rënda, të kryera kundër fëmijëve, për të cilat me ligj parashihet dënim me burg në kohëzgjatje prej katër vjetësh.

Në këtë rast gjykata përcakton ndaras ose së bashku me ndonjë masë tjetër masë të posaçme të mbrojtjes të regjistrohesh deklaratat e fëmijës me video dhe audio xhirim, i cili do të përdoret si dëshmi në procedurën e mëtejme. Në raste të jashtëzakonshme, nëse paraqiten më shumë rrethana të reja, gjykata mund përsëri ta marrë në pyetje fëmijën viktimë, më së shumti edhe njëherë përmes përdorimit të mjeteve teknike për komunikim. Në këtë mënyrë do të veprojnë prokurori publik gjatë marrjes në pyetje të fëmijës-viktimë në kuadër të procedurës hetimore. Ai e ka për detyrë t'ia mësojë fëmijës viktimë të gjitha të drejtat e tij dhe atë më së voni para marrjes së parë në pyetje, për çka hartojnë shënim me shkrim ose proces verbal.

### 13. FËMIJËT SI DËSHMITARË NË PROCEDURË

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë penale si dëshmitarë ftohen personat, për të cilët besohet se mund të japin informacion për veprën penale, për kryerësin e saj dhe për rrethana tjera të rëndësishme. Sipas kësaj personat e mitur mund të jenë dëshmitarë të procedurës.

Çdo person i ftuar në cilësinë e dëshmitarit, e ka për detyrë t'i përgjigjet ftesës dhe nëse në ligj nuk përcaktohet më ndryshme, ai e ka për detyrë të dëshmojë. Megjithatë personi i mitur i cili duke pasur parasysh moshën dhe zhvillimin shpirtëror nuk është i aftë ta kuptojë domethënien e të drejtës së vetë, nuk e ka patjetër të dëshmojë përveç nëse vetë i pandehuri kërkon që ai të dëshmojë.

Dëshmitari, për të cilin prokurori publik gjatë procedurës hetimore do të vërtetojë se është në veçanti vulnerabil duke pasur parasysh moshën, nëse bëhet fjalë për person të mitur, ose shkaqet tjera të theksuara në Ligjin për procedurë penale, se është personi i mitur-viktimit i trafikimit me njerëz, viktimit e dhunës ose abuzimit seksual, gjegjësisht duke pasur parasysh faktin se dhënia e dëshmisë në hapësirat e prokurorisë publike do të kishte pasoja të dëmshme ndaj shëndetit të tij fizik dhe psikik, do të merret në pyetje në mënyrë dhe parime të veçantë.

Mbi të gjitha, në rastet kur prokurori publik të vlerësojë se një gjë e tillë është e nevojshme për ta ndihmuar dëshmitarin, atij i mundësohet të ketë person të autorizuar gjatë marrjes në pyetje.

Pyetjet dëshmitarit mund t'i parashtrihen vetëm përmes organit, i cili e drejton procedurën, që do të thotë se gjatë procedurës hetimore mund t'i parashtrihen përmes prokurorit publik, i cili ndaj personit të tillë duhet të sillet me kujdes të posaçëm, me qëllim që të shmangen pasojat e dëmshme të procedurës penale ndaj personalitetit dhe shëndetit të tij mendor.

Marrja në pyetje e dëshmitarit mund të bëhet me ndihmën e psikologut, punëtorit social ose personit tjetër përmes përdorimit të mjeteve teknike për transmetim të fotografisë dhe zërit. Marrjen në pyetje mund ta bëjë në hapësirën, në të cilën gjendet i dëmtuari dhe dëshmitari, pa prezencë të palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë, ashtu që palët, mbrojtësi dhe personat, të cilët kanë të drejtë t'i parashtrojnë pyetje, atë e bëjnë me ndërmjetësim të prokurorit publik, ose psikologut, pedagogut, punëtorit social ose personit tjetër profesionist.

Dëshmitari nuk guxon të përballet me të pandehurin, ndërsa me dëshmitarët tjerë mund të përballet, por vetëm me kërkesë të tij.

Sipas Ligjit për drejtësi për fëmijë, fëmija-dëshmitar i gëzon të drejtat e njëjta si fëmija-viktimitë, andaj marrjen e tij në pyetje prokurori publik e bën në të njëjtën mënyrë sesi e merr në pyetje fëmijën-viktimitë të veprës penale.

### 14. DOKUMENTIMI DHE MËNYRA E VEPRIMIT PAS DORËZIMIT TË KALLËZIMIT

Prokurori publik në afat prej tre muajsh nga dita e pranimit me shkrim të kallëzimit penal e ka për detyrë të merr vendim në lidhje me të. Për ndryshe, ai duhet menjëherë ta informojë më shkrim prokurorin publik në instancë më të lartë dhe parashtruesin e kallëzimit penal.



Në pajtim me nenin 298, paragrafi 1 të LPP-së, prokurori publik me vendim do ta hedh poshtë kallëzimin penal, nëse nga vetë kallëzimi vërtetohet se:

- vepra në fjalë nuk është vepër penale, e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare,
- nëse është bërë vepër e vjetër, ose është përfshirë me akt të amnistisë,
- nëse ekzistojnë rrethana tjera, të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale,
- nëse nuk ka dëshmi se fëmija ka kryer vepër, e cila me ligj parashihet si vepër penale.

Prokurori publik ia dorëzon palës së dëmtuar vendimin për refuzim të kallëzimit penal, duke e informuar zyrtarisht se në afat prej tetë ditësh mund të dorëzojë ankesë deri te prokurori më i lartë, ndërsa parashtruesi i kallëzimit penal informohet për shkaqet e refuzimi të tij.


Në pajtim me nenin 284 të LPP-së, prokurori publik vetë ose përmes policisë gjyqësore, gjegjësisht personave tjerë të punësuar në qendrat për hetim të prokurorisë publike do t'i grumbullojë informacionet e nevojshme për të marrë vendim në lidhje me kallëzimin penal, ndërsa sipas nevojës do ta bëjë edhe përmes policisë dhe organeve tjera kompetente për hetim.

Për masat e ndërmarra dhe kontrollimet e bëra me urdhër ose me udhëzim të prokurorit publik, policia dhe organet tjera shtetërore e kanë për detyrë të japin informacion më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit.

Në urdhër prokurori publik mund më për së afërmi t'i përcaktojë veprimet e nevojshme dhe t'i urdhërojë policisë pa prolongim ta informojë për masat e marra. Nëse prokurori publik kërkon të merr pjesë në këta veprime, policia do t'i merr përsipër të gjitha masat, që t'ia mundësojë atë.

Ligji për procedurë penale i jep prokurorit publik autorizime të ftojë persona në pajtim me nenin 285, ku me qëllim të grumbullimit të informacioneve, prokurori publik mund ta ftojë parashtruesin e kallëzimit penal dhe personat tjerë, për informacionet e të cilëve konsideron se mund të kontribuojnë për vlerësim të besueshmërisë së pretendimeve të kallëzimit, ose persona për të cilat konsideron se mund të jenë në cilësinë e dëshmitarit në kuadër të procedurës, mirëpo përkujdeset që të gjithë t'i informon për arsyen e ftesës.

# VEPRIMI I PROKURORIT PUBLIK ME FËMIJËN VIKTIMË









# GJYKATA

## PËRMBAJTJA

### PROCEDURA PËR VEPRIM NË GJYKATA ME FËMIJË-VIKTIMA TË DHUNËS OSE VEPRËS PENALE

1.	Hyrje	64
2.	Veprimi i gjykatës ndaj lëndëve penale, në të cilat ka të involvuar fëmijë-viktima	65
3.	Mbrojtja juridiko-penale e fëmijëve-viktima	65
4.	Mbrojtja e fëmijës si i dëmtuar ose dëshmitar në procedurën penale	66
5.	Pjesëmarrja e fëmijës-viktimë në procedurën penale	67
6.	Përgatitja dhe karakteristikat e seancës kryesore	69
7.	Udhëzimet për përgatitje të drejtimit të suksesshëm të seancës kryesore dhe përgatitjes së fëmijës-viktimë të merr pjesë në procedurën penale	70

8.	Procesi i gjykimit	71
9.	Seanca kryesore, mënyra dhe specifikimet për drejtim të seancës kryesore	71
10.	Të drejtat e posaçme të procesit të mbrojtjes	72
11.	Fjalimet hyrëse	73
12.	Përrjashtime në lidhje me nxjerrjen e drejtpërdrejtë të dëshmive	73
13.	Të drejtat e posaçme të kategorive vulnerabile të viktimave	74
14.	Përrjashtimi i publikut	74
15.	Përdorimi i deklaratave të incizuara dhe të shënuara si dëshmi	75
16.	Sigurimi i të drejtave të posaçme të kategorive vulnerabile të viktimave	75
17.	Dëshmia e fëmijës-viktimë para gjyqit	76
18.		77
19.		77
20.		77
21.	Ndalimi për t'u ballafaquar me të pandehurin	79
22.	Dëgjimi – biseda me fëmijën-viktimë	79
23.	Njoftimi dhe vendosja e raporteve përkatëse për zhvillimin e bisedës	79
24.	Sigurimi i informacioneve	80
25.	Përrfundimi i bisedës me fëmijën	80
26.	Veprimet e gjykatës	81
27.	Roli i gjykatës gjatë seancës kryesore	81
28.	Fjalët përrfundimtare	81
29.	Mbarimi i seancës kryesore	81
30.	Marrja, hartimi dhe shpallja e vendimeve	82
31.	Dëmshpërrblimi	82
32.	Procedura për dëmshpërrblim	82



## PROCEDURA GJYQËSORE CIVILE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE-VIKTIMË NGA DHUNA, ABUZIMI DHE BRAKTISJA

1.	Zbulimi i fëmijëve-viktimë nga dhuna, abuzimi dhe neglizhenca dhe inicimi i procedurës	83
2.	Standardet për zhvillimin e procedurës	84
3.	Parimet e procedurës	85
4.	Provat	86
5.	Pozita e fëmijës në procedurën gjyqësore civile	86
6.	Fëmija si palë	86
7.	Përfaqësimi i fëmijës si palë në procedurë	87
8.	Fëmija si dëshmitar	87
9.	Procedura në të cilën vendoset mbi të drejtat e fëmijës pa status të palës	88
10.	Shprehja e mendimit të fëmijës	89
11.	Kur fëmija nuk ka të drejtë të shpreh mendimin e vet	89
12.	Interesi më i mirë i fëmijës	90
13.	Procedura e ankimimit	90

## PROCEDURA PËR VEPRIM NË GJYKATA ME FËMIJË-VIKTIMA TË DHUNËS OSE VEPRËS PENALE

### 1. HYRJE

Më këta procedura rregullohen çështjet në lidhje me veprimin me lëndët në gjykatat e Republikës së Maqedonisë, në rast të përfshirjes së fëmijës-viktimë të dhunës ose veprës penale.

Procedurat për veprim me lëndët në gjykata në rast se kemi të involvuar fëmijë-viktimë, paraqesin marrje të veprimeve nga kryetari i gjykatës, gjegjësisht nga administratori i gjykatës, gjykatësit dhe nëpunësit gjyqësor nga dita e pranimit të dokumentit me shkrim në gjykatë e deri në ditën e arkivimit të lëndëve.

Procedurat për veprim me fëmijën-viktimë kanë të bëjnë me punën e gjykatave. Zbatimi i tyre siguron veprim standard të unifikuar në procedurat, të cilat zhvillohen në gjykata. Këta procedura bazohen në standardet për menaxhim me lëndët, si metodë për sigurim të drejtësisë për fëmijët dhe të rriturit, me çka fuqizohen mbrojtja dhe avancimi i të drejtave personale. Pra janë të orientuara drejt dallimit se fëmijët-viktima janë të ndjeshëm dhe se kanë nevojë për mbrojtje të posaçme gjyqësore në pajtim me moshën e tyre, pjekurinë dhe nevojat e posaçme individuale.

Gjykata gjatë implementimit të procedurave për veprim me fëmijët viktima, veprojnë në pajtim e dispozitat e legjislacionit vendo dhe ndërkombëtar dhe udhëhiqen nga këta parime të pranuar gjithandej:

- dinjiteti,
- mosdiskriminimi,
- interesi më i mirë i fëmijës,
- mbrojtja,
- zhvillimi proporcional
- pjesëmarrja e fëmijës në vendimet e rëndësishme për të.

Gjykatat sigurojnë mbështetje të plotë dhe kujdesen për fëmijët, sigurojnë mënyrë dhe qasje më të ndjeshme në punë me fëmijët-viktima dhe janë plotësisht të orientuar drejt sigurimit dhe implementimit të:

- e drejta e dinjitetit dhe trajtim i ndjeshëm,
- e drejta e mbrojtje nga diskriminimi,
- e drejta e informimit,
- e drejta e shprehjes së mendimit dhe e drejta e të qenit i dëgjuar,
- e drejta e mbështetjes efektive,
- e drejta e privatësisë,
- e drejta e mbrojtjes nga vështirësive gjatë procesit gjyqësor,



- e drejta e sigurisë,
- e drejta e kompensimit të dëmit,
- e drejta e masave të posaçme preventive,
- emergjenca e veprimit.

## 2. VEPRIMI I GJYKATËS NDAJ LËNDËVE PENALE, NË TË CILAT KA TË INVOLVUAR FËMIJË-VIKTIMA

### Veprimi i kryetarit të gjykatës ose administratorit të gjykatës në rast të lëndëve gjyqësore, në të cilat ka të involvuar fëmijë-viktima

Kryetari i gjykatës ose administratori i gjykatës e kanë për detyrë në rast të lëndës gjyqësore, në të cilën ka të involvuar fëmijë-viktima, t'i ofrojë ndihmë gjykatësit të lëndës edhe atë:

- në sigurimin e ambientit adekuat – salla e gjyqit, e përshtatur për nevojat e fëmijës-viktima, dhe është siguruar me pajisje adekuate informatike /IT/, gjegjësisht mikrofon që fëmija të mund të dëgjohet më lehtë,
- në sigurimin e hapësirës së posaçme/dhomës për pritje/ në gjykatë me qëllim që të ndahet fëmija-viktima nga autori i supozuar i krimit në rekuizita adekuate për fëmijë, që të mos shihet fëmija,
- në sigurimin e hapësirës adekuate me ambient të përshtatshëm për fëmijën brenda pauzave gjatë seancës kryesore,
- me sigurim të policisë gjyqësore sigurinë e fëmijës viktima nga rreziqet e sigurisë para, gjatë dhe pas procesit gjyqësor,
- me sigurim të pajisjeve teknike për incizim audio-vizuel dhe pajisje adekuate për dëshmitar të mbrojtur.

Pas caktimit të ditës për shqyrtim të lëndës, gjykatësi duhet ta informojë kryetarin e gjykatës, administratorin e gjykatës dhe policinë gjyqësore për nevojat e veprimit në lëndët gjyqësore, në të cilat ka të përfshirë fëmijë-viktima, me qëllim që të ofrohet ndihma e patjetërsueshme dhe të bëhet planifikim me kohë i aktiviteteve.

## 3. MBROJTJA JURIDIKO-PENALE E FËMIJËVE-VIKTIMA

Mbrojtja juridiko penale e fëmijëve-viktima në sistemin penal të Republikës së Maqedonisë është vënë mbi parimet e “drejtësisë për fëmijë”, e cila i përfshin të drejtat e fëmijëve për të marrë pjesë në procedurat gjyqësore, adekuate për moshën dhe në pajtim me interesat e tyre më të mira.

Njëri ndër qëllimet e sistemit të drejtësisë për fëmijë është mbrojtja nga dhuna e fëmijëve-viktima, dhe sanksionimi i autorëve të veprës penale.

Për të gjitha veprimet, që me ligj parashihen si vepra penale në bazë të Kodit penal, në të cilat sipas përcaktimeve ligjore të veprës fëmija paraqitet si viktima e veprës, gjykatësi dhe organet tjera, të cilat marrin pjesë në procedurë, e kanë për detyrë të ndërmarrin masa për ndihmë dhe mbrojtje dhe të veprojnë në mënyrë që të evitohen pasojat e dëmshme të mundshme për personalitetin dhe zhvillimin e tij.

Të gjitha rastet, të cilat përfshijnë masa dhe mbrojtje për fëmijët-viktima ose dëshmitarë zbatohen me qëllim që ata të mbrohen nga frikësimi, ose viktimizimi sekondar, që mund të ngjajë gjatë procedurës.

Viktimizimi sekondar ka të bëjë me viktimizimin e mëtejshëm, që nuk është rezultat i drejt-përdrejtë i veprës penale, por përmes punës së institucioneve dhe/ose individëve me viktimën. Për shembull, mund të paraqitet, kur viktima kujtohet në ngjarjet gjatë dëshmisë në gjykatë ose në prezencë të autorit të krimit (veprës).

#### 4. MBROJTJA E FËMIJËS SI I DËMTUAR OSE DËSHMITAR NË PROCEDURËN PENALE

Gjykatësi e ka për detyrë të veprojë me kujdes të posaçëm ndaj fëmijës – viktimë të veprës penale, duke i dhënë udhëzim në bazë të standardeve dhe rregullave ndërkombëtare dhe legjislacionit nacional, por edhe të kujdeset për interesat e tij gjatë marrjes së vendimit për përndjekje penale kundër të akuzuarit dhe për të hartohet proces verbal.

Gjykatësi e ka për detyrë që gjatë veprimit me fëmijën-viktimë të veprës penale t'i merr parasysh këta të drejta të garantuara:

- të veprime me respekt ndaj dinjitetit të tij,
- ta mbështetet nga çfarëdo lloji i diskriminimit,
- ta informojë për të drejtat e tij në gjuhë të kuptueshme dhe adekuate me moshën e tij, si dhe për respekt të së drejtës së privatësisë,
- të informohet prindi ose prindërit, gjegjësisht tutori ose tutorët për të gjitha çështjet në lidhje me veprën penale dhe në lidhje me të pandehurin, të akuzuarin ose të dënuarin,
- fëmija, gjegjësisht prindi ose prindërit, gjegjësisht tutori ose tutorët të marrin pjesë në procedurën penale si i dëmtuar në përfshirjen në përndjekjen penale ose për realizim të kërkesave pronësore juridike për dëm,
- të mbrojtjes së posaçme të tij dhe familjes së tij, kujdes dhe vëmendje nga organet dhe subjektet, të cilat marrin pjesë në procedurën penale,
- e drejta për mbrojtje të posaçme nga viktimizimi sekondar ose reviktimizimi dhe
- e drejta e ndihmës psikologjike dhe ndihmë tjetër profesionale dhe mbështetjes nga organet, institucionet dhe organizatat për ndihmë të fëmijëve viktima për vepra penale.

Gjykatësi në çdo lëndë gjyqësore, në të cilën ka të involvuar fëmijë-viktimë e ka për detyrë t'u jep prioritet **“interesave më të mira të fëmijës”** duke përfshirë edhe realizimin e rastit pa involvim të fëmijës-viktimë ose dëshmitar, nëse ajo konsiderohet e patjetërsueshme për zhvillimin dhe mbrojtjen e tij.

Gjykatësi e ka për detyrë që në pajtim me standardet ndërkombëtare t'i mundësojnë fëmijës-viktimë të shprehet për të gjitha çështjet, që kanë të bëjnë me të.



## 5. PJSËMARRJA E FËMIJËS-VIKTIMË NË PROCEDURËN PENALE

Gjykatësi e ka për detyrë, që për shkak të moshës së fëmijës dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit për të drejtat e fëmijës dhe parimet themelore, fëmijës-viktimë t'i sigurojnë të drejtë për pjesëmarrje aktive në të gjitha fazat e procedurës, si dhe të drejtën që lirshëm ta thotë opinionin e tij për të gjitha vendimet, të cilat janë të rëndësishme për të.

Kjo nënkupton se gjykatësi e ka për detyrë të sigurojë parakushte për pjesëmarrje adekuata në procedurën gjyqësore, qoftë nëse fëmija paraqitet si autor i veprës penale, viktimë ose dëshmitar. Këta parakusht përcaktojnë:

- veprim emergjent dhe miratim të vendimit, i cili mundëson siguri fizike, psikike dhe mendore të fëmijës,
- shumë është me rëndësi të sigurohet privatësia e të gjithë fëmijëve-viktima dhe fëmijëve-dëshmitarë. Kur një fëmijë është pjesëmarrës në procedurën gjyqësore, askush përveç personat, të cilëve iu beson fëmija nuk ka të drejtë të dijë se fëmija është pjesëmarrës në procedurën gjyqësore,
- gjykatësi duhet ta ndalojë prezencën e publikut dhe mediave në gjykim. Emri i fëmijës duhet të ngel sekret dhe nuk duhet të jepen kurrfarë informacione në publik, në media, ose të ndahen me persona që nuk janë të përfshirë në procesin gjyqësor.
- gjykatësi duhet me kohë ta informojë fëmijën për të gjitha faktet relevante, të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e shpjegimit të shkaqeve të marrjes në pyetje, për gjendjen dhe të drejtat e tij, si dhe për domethënien e pjesëmarrjes së tij në procedurën dhe mënyrën, ashtu që në secilën fazë të procedurës mund t'i drejtohet gjykatës personalisht ose përmes personit të autorizuar,
- gjykatësi duhet t'i tregojë fëmijës se çka ngjan në secilën fazë të procedurës dhe gjithçka pritet prej tij/saj kur të dëshmojë, pse është e rëndësishëm dëshmia e tyre si dhe kur dhe pse duhet të japin deklaratat,
- gjykatësin duhet të mundësojë që fëmijët-viktima dhe fëmijët-dëshmitarë t'i shprehin brengat ose frikën e tyre në lidhje me pjesëmarrjen në procedurën gjyqësore,
- gjykatësi duhet t'i informojë fëmijët-viktima dhe fëmijët-dëshmitarë për mënyrat e ndryshme, në të cilat mund të merren në pyetje gjatë gjykimit,
- gjykatësin duhet ta informoni, kur të zhvillohen seancat/dëgjimet. Kur nga fëmija pritet të merr pjesë në seancat/dëgjimet dhe për shkak të dëgjimeve, duhet të insistoni që ato të planifikohen paraprakisht, me qëllim që fëmija të ketë kohë të përgatitet,
- gjykatësi duhet të insistojë t'iu mundësojë fëmijëve-viktima dhe fëmijëve-dëshmitarë, që lirshëm të shprehen për atë që e mendojnë dhe ndjejnë, përmes krijimit të atmosferës së besimit, interesimit dhe sigurisë personale,
- veprimi i kujdesshëm i gjyqit me fëmijën-viktimë, me ndihmë e respektit të plotë të personalitetit të tij, moshës dhe specifikës së aspektit të zhvillimit të tij psikofizik dhe veçoritë e tij individuale,

- fëmija gjithnjë dëgjohe në prezencë të prindit, adoptuesit ose tutorit, nëse gjykata nuk vendos ndryshe,
- fëmijët-viktima dhe fëmijët-dëshmitarë duhet të shoqërohen nga avokati në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore dhe atyre duhet ofruar ndihmë dhe mbështetje,
- detyrë e personit të autorizuar të fëmijës-viktimë është t'i përfaqësojë interesat e tija më të mira (nëse gjykata e përcakton të kundërtën, atëherë patjetër duhet të merr masa në drejtim të mbrojtjes së interesave të fëmijës),
- patjetër duhet të përfshihen subjektet plotësuese (profesionistët/specialistët ose farefisi i afërt) gjatë marrjes në pyetje, kur fëmija paraqitet si dëshmitar ose viktimë tejet e ndjeshme. Ata duhet të jenë me fëmijën, kur ai të jep dëshmi, nëse një gjë e tillë është në interes më të mirë të fëmijës. Duhet përfshirë profesionistët e njëjtët, që paraprakisht kanë punuar me fëmijën, me qëllim që t'i ndihmojë ta kalojë gjithë rrjedhën e procedurës,
- detyrimisht të përfshihen profesionistët dhe specialistët në marrjen në pyetje të fëmijës-viktimë me pengesa në zhvillim,
- përdorimi i mjeteve të posaçme teknike për komunikim me video dhe audio xhirim,
- dëgjimi i fëmijës në ambient natyror, në veçanti kur është nën moshën 14 vjeçare, gjithnjë kur është e mundur ose ka nevoja për të,
- gjykatësi duhet të veprojë me fëmijën-viktimë dhe fëmijën-dëshmitar në mënyrë korrekte dhe me shfaqje të respektit,
- me fëmijën të bisedohet në ambient adekuat, në të cilin fëmija ndjehet i rehatshëm dhe i sigurt, si dhe të bisedoni në gjuhën që e kupton fëmija,
- me fëmijën-viktimë dhe fëmijën-dëshmitarë duhet të veprohet drejt, pa dallim se kush është ai, ku jeton, çka i punojnë prindërit, cilën gjuhë e flet, cilës fe i takon, çka mendon ose deklaron, a është mashkull ose femër, i pasur ose i varfër,
- disa fëmijë kanë nevojë për ndihmë dhe mbrojtje të posaçme, për shkak të mënyrës sesi janë dëmtuar. Sidomos kjo vlen për rastet e abuzimit seksual me fëmijët-viktima. Po ashtu duhet të merret parasysh se fëmijët meshkuj dhe femra mund të kenë nevoja të ndryshme,
- gjykatësi duhet ta informojë fëmijën-viktimë dhe fëmijën-dëshmitarë sesi mund të merr lloje të ndryshme të këshillave ose ndihmës, si për shembull ndihmë juridike falas dhe këshillim,
- kur fëmija është dëshmitar, deklarata (dëshmia) e tij/saj duhet të konsiderohet e vërtetë, përveç nëse vërtetohet se është jo e vërtetë, me kusht që fëmija t'i kuptojë pyetjet dhe të jep përgjigje pa mos i ndihmuar,
- fëmija nuk duhet të vuajë ose të ekspozohet në rrezik për shkak se merr pjesë në procedurë,
- kur nuk është e mundur të bëhet ajo që e kërkon fëmija, atëherë është me rëndësi të shpjegohet arsyeja, që fëmija t'i kuptojë shkaqet e vendimit tuaj,



- sigurori dhe insistoni gjykimi të përfundojë në afat sa më të shkurtër, përveç nëse prolongimi është në interes më të mirë të fëmijës,
- mundësoni kushte, që fëmija të mos e ketë patjetër të përballet me të akuzuarin,
- mbani llogari, që askush që mund ta rrezikojë fëmijën, të mos vijë në kontakt me atë,
- fëmijët viktimë kanë të drejtë të informohen se kanë të drejtë për mbrojtje. Duhet t'i informoni se cilat janë ato raste dhe si mund ta realizojnë atë të drejtë. Vendimi për dëmshpërblim sipas mundësisë duhet të merret gjatë gjykimit, mirëpo fëmija duhet të mbrohet dhe mbahet llogari për nevojat dhe qëndrimet e tij,
- gjithnjë supozoni se fëmijët-viktima dhe dëshmitarë nuk janë të njëjtë dhe kanë nevoja të ndryshme,
- përvetësoni njohuri që të dalloni, kur fëmija është në rrezik ose ka përjetuar dëmtim përmes identifikimit të shenjave ose shkeljes përmes vërejtjes së mënyrës sesi fëmija sillet, që mund të bëjë me dije se fëmija ka qenë i dëmtuar ose është i rrezikuar.
- insistoni të trajnoheni, sesi t'i mbronni dhe përmbushni nevojat e fëmijëve-viktima dhe dëshmitarë.

## 6. PËRGATITJA DHE KARAKTERISTIKAT E SEANCËS KRYESORE

Seanca kryesore zgjat pa ndërprerë, që nënkupton se varësisht nga ndërlikueshmëria e lëndës, numrit të të akuzuarve, numrit të veprave penale, numrit të dëshmive dhe rrethanave tjera nevojitet të planifikohet sa kohë duhet të zgjasë seanca kryesore, një, dy tre ose më shumë ditë, andaj në atë drejtim palët dhe pjesëmarrësit tjerë, të cilët do të prezantojnë në seancën kryesore do të njoftohen dhe do të thirren të marrin pjesë në ditët e caktuara për vazhdim të seancës.

Nëse seanca kryesore e prolonguar zhvillohet para këshillit të njëjtë, atëherë ajo vazhdon, por e njëjta do të fillojë përsëri nëse është ndryshuar përbërja e këshillit, gjykatësi ose nëse prolongimi ka zgjatur më shumë se 90 ditë.

## 7. UDHËZIMET PËR PËRGATITJE TË DREJTIMIT TË SUKSESSHËM TË SEANCËS KRYESORE DHE PËRGATITJES SË FËMIJËS-VIKTIMË TË MERR PJESË NË PROCEDURËN PENALE

Salla e gjyqit mund të paraqesë vend dhe ambient frikësues për cilindo person të gjykuar, ndërsa te fëmijët shkakton ndjenjë edhe më të madhe të frikës dhe tjetërsimit

Për këta arsye gjykatësi e ka për detyrë që në procedurën gjyqësore të veprojë me respekt të plotë me fëmijën-viktimë, në pajtim me moshën e tij dhe nevojat e posaçme, si dhe në pajtim me pjekurinë dhe të kuptuarit e tij.

Gjykatësi e ka për detyrë t'i ndërmerret të gjitha mjetet e mundshme, që në masë sa më të madhe të sigurojë ambient adekuat për fëmijën-viktimë pa kurrfarë frikësimi. Kjo nënkupton

se salla gjyqësore mund të jetë e karakterit më pak formal, si për nga rregullimi i saj, po ashtu edhe për nga aspekti i drejtimit të procedurës me numër të zvogëluar të personave prezent, me veshje të përditshme, për dallim nga uniformës zyrtare dhe të detyrueshme për në gjyq.

Gjykatësi e ka për detyrë paraprakisht t'i planifikojë seancat gjyqësore dhe t'i adaptojë në ritmin, që mund ta ndjekin fëmijët, gjegjësisht në aftësinë e tyre për përqendrim të vëmendjes.

Gjykatësi e ka për detyrë të sigurojë pauza të rregullta, seancat të mos zgjasin shumë gjatë, që t'i mundësohet fëmijës t'i ndjek ngjarjet gjatë të gjitha fazave të procedurës

Më pas, me qëllim që fëmijët të marrin pjesëmarrje të plotë në procedurën gjyqësore në pajtim me kapacitetin e tyre kognitiv, si dhe me qëllim që të garantohet qëndrueshmëria e tyre emocionale, të gjitha çrregullimet eventuale, ndërprerjet dhe çrregullimet gjatë seancave, gjykatësi e ka për detyrë t'i vë në minimum.

Fëmijët kanë të drejtë të shprehen në lidhje me të gjitha pyetjet, që kanë të bëjnë me ta, përfshirë edhe procedurat gjyqësore. Prandaj gjykatësi e ka për detyrë dhe patjetër duhet të krijojë masa, me të cilat fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë do t'u ndihmohet të marrin pjesëmarrje të plotë në procedurën gjyqësore, në mënyrë serioze, në përputhje me interesin e tyre më të mirë dhe duke i pasur parasysh kapacitetet e tyre zhvillimore.

Gjykatësi duhet të përgatitet me qëllim që qëndrimeve dhe opinioneve të fëmijëve t'iu jepet rëndësi dhe vëmendje të duhur në pajtim me moshën e tyre, aftësitë, pjekurinë intelektuale dhe kapacitetet zhvillimore. Niveli i zhvillimit, arsyeja e tyre dhe zhvillimet nuk mund të maten vetëm përmes moshës biologjike, për shkak se aftësitë për kuptim, pjekuri dhe shkathtësi të fëmijët zhvillohen me shpejtësi të ndryshme. Për këtë arsye qëndrimet dhe mendimet e fëmijëve duhet të vlerësohen në nivel individual, nga rasti në rast, me qëllim që të përcaktohet pesha dhe rëndësia që duhet dhënë deklaratës dhe dëshmisë së tij, duke u bazuar në këta faktorë.

## 8. PROCESI I GJYKIMIT

Procesi i gjykimit, i cili është i përshtatur fëmijës-viktimë mund të ketë efekt pozitiv ose negativ për fëmijës, me çka do t'i mundësojë ta shmangin padrejtësinë e shkeljes së të drejtave të tij/saj. Për ta arritur këtë, fëmijës duhet t'i ofrohet mbështetje e plotë, ndërsa nevojat dhe të drejtat e tij duhet të plotësohen gjatë të gjitha fazave të procesit të përmbushjes së drejtësisë edhe nga ata që marrin pjesë në të.

### Hapat për veprim para gjykimit

1. Periudha e gjatë e pritjes mund të jetë stresuese për fëmijët viktimë ose dëshmitarë, në veçanti për ata të moshës më të re, ose ata që kanë përjetuar dhunë nga autorët e veprave penale. Kjo periudhë është në veçanti e rëndësishme, kur autori i krimit është anëtar i familjes, për shkak se fëmija është i ekspozuar në rrezik më të madh nga presioni për ta ndryshuar dëshminë.
2. Me qëllim që gjykatësi të sigurohet se fëmijët viktimë ose dëshmitarë janë të mbrojtur, me qëllim që të mos shihen nga autori i supozuar i krimit, **nevojitet të sigurohet** hapësirë e posaçme/hapësirë për pritje të fëmijës-viktimë në gjykatë. Këta hapësira të posaçme duhet të përshtaten për fëmijë dhe të pajisen, me



qëllim që fëmijët të ndjejnë siguri fizike dhe psikike, qysh para fillimit të gjykimit, si dhe të përgatiten për zhvillim të bisedës. **Për këtë arsye, gjykatësi duhet të kërkojë nga kryetari i gjyqit, që administratori i gjyqit t'i mundësojë qasje në hapësirë të posaçme, ndërsa policia gjyqësore duhet të ndërmerr veprime për sigurinë e fëmijës.**

3. Gjykatësit, të cilët merren me lëndët penale duhet të trajnohen për dallim dhe parandalim të frikësimit, kërcënimeve dhe dëmtim të fëmijëve-viktima dhe dëshmitarë.
4. Nëse gjykatësi vlerëson se fëmijët-viktima dhe dëshmitarë mund të jenë subjekt i frikësimit, kërcënimit ose shkeljes, atëherë me ndihmën e kryetarit të gjyqit dhe administratorit duhet të sigurojë kushte adekuate për të mundësuar sigurinë e fëmijës.
5. Gjykatësi duhet ta planifikojë procesin gjyqësor, që të jetë përvojë sa më pak e frikshme për prezantim dhe dhënie të dëshmisë në gjykatë, që fëmija të njoftohet paraprakisht, ta vizitojë sallën e gjyqit një ditë para zhvillimit të gjyqit, t'i shpjegojë se çka mund të pres nga procesi gjyqësor dhe mënyra e zhvillimit të procedurës.

## 9. SEANCA KRYESORE, MËNYRA DHE SPECIFIKIMET PËR DREJTIM TË SEANCËS KRYESORE

Në pajtim me nenin 145 të Ligjit për drejtësi për fëmijë, fëmija-viktimë e veprës penale i ka këta të drejta:

- me të mund të veprohet me respekt ndaj dinjitetit të tij/saj,
- mund të mbrohet nga çfarëdo qoftë diskriminimi,
- informohet për të drejtat e tij në gjuhë të kuptueshme dhe adekuate për moshën e tij dhe duhet të respektohet e drejta e privatësisë,
- të informohen prindi/prindërit, gjegjësisht tutori/tutorët për të gjitha çështjet në lidhje me veprën penale dhe në lidhje me të dyshuarin, të akuzuarin dhe të gjykuarin,
- fëmija, gjegjësisht prindi/prindërit, tutori/tutorët të marrin pjesë në procedurën penale si person të dëmtuar me përfshirje të tyre në përndjekjen penale ose në realizimin e kërkesës juridiko-pronësore për dëm,
- mbrojtje të posaçme të sigurisë së tij dhe sigurisë së familjes së tij, kujdesi dhe vëmendja e organeve dhe subjekteve, të cilat marrin pjesë në procedurën penale,
- e drejta e mbrojtjes së posaçme nga viktimizimi sekondar ose riviktimizimi dhe
- e drejta e ndihmës psikologjike dhe ndihmës tjetër profesionale dhe mbështetjes nga organet, institucionet dhe organizatat për ndihmë të fëmijëve për vepra penale.

## 10. TË DREJTAT E POSAÇME TË PROCESIT TË MBROJTJES

Fëmija-viktimë ka të drejtë për masa të posaçme të mbrojtjes gjatë dhënies së deklaratës dhe marrjes dhe zhvillimit të intervistës (bisedës) në të gjitha fazat e procedurës.

Gjykata duhet të përcaktojë masë të posaçme të procesit të mbrojtjes edhe atë në këta raste:

- kur fëmija viktimitë ka nevojë për kujdes dhe mbrojtje të posaçme ose
- kur fëmija është viktimitë e trafikimit me njerëz, dhunës dhe abuzimit seksual, si dhe i veprave penale kundër njerëzisë dhe të drejtës ndërkombëtare ose veprave tjera të rëndë të kryera ndaj fëmijëve, për të cilët me ligj është përcaktuar dënim me burg mbi katër vite.

Në këtë rast ndaras ose së bashku me ndonjë masë tjetër gjykata përcakton masë të posaçme të mbrojtjes, të regjistrohet deklarata e fëmijës me video dhe audio xhirim, i cili do të përdoret si dëshmi në procedurën e mëtejme. Në raste të jashtëzakonshme, nëse paraqiten më shumë rrethana të reja, gjykata mund përsëri ta merr në pyetje fëmijën viktimitë, më së shumti edhe njëherë gjatë përdorimit të mjeteve teknike për komunikim.

Si masa të posaçme të procesit të mbrojtjes gjatë dhënies së deklaratës, gjykata mund të përcaktojë:

- përdorim të ekraneve për mbrojtje të viktimitës dhe dëshmitarit nga shikimi i të akuzuarit,
- mbulim të identitetit ose pamjes,
- dhënie deklaratë për videokonferencës
- heqje të togave dhe kapelave,
- përjashtim të publikut,
- video dhe audio xhirim të deklaratës, e cila përdoret si dëshmi,
- video dhe audio xhirim të marrjes në pyetje, e cila përdoret si dëshmi,
- marrja e deklaratës përmes ndërmjetësuesit ose personit profesionist,
- përdorimi i teknikave të posaçme për komunikim dhe
- mbrojtja e privatësisë së fëmijës dhe familjes së tij.

Gjyqi e ka për detyrë që gjatë procesit gjyqësor me fëmijët-viktima dhe dëshmitarë të veprojë me kujdes dhe me ndjeshmëri, duke mbajtur llogari për gjendjen e tyre personale dhe nevojat imediate, moshën, gjininë, pengesën, nivelin e pjekurisë dhe respektimin e plotë të integritetit të tyre fizik, mendor dhe moral. Po ashtu, gjyqi, gjegjësisht gjykatësi e ka për detyrë t'iu mundësojë fëmijëve dëshmitarë dhe viktima t'i shprehin qëndrimet dhe shqetësimet e tyre në lidhje me përfshirjen e tyre në procesin juridik, t'iu jep mundësi të marrin pjesë në vendimet e rëndësishme për ta dhe të kushtojë vëmendje të duhur ndaj qëndrimeve dhe shqetësimeve të fëmijës, ndërsa nëse ato nuk mund të përshtaten, atëherë duhet t'ia shpjegojë fëmijës shkaqet për të.



## 11. FJALIMET HYRËSE

Seanca kryesore fillon me fjalimet hyrëse. Në fillim flet paditësi, e pastaj e merr fjalën mbrojtësi dhe i pandehuri. I pandehuri ka të drejtë të mos ketë fjalim hyrës. Në fjalimet hyrëse palët mund të potencojnë se cilat fakte përfundimtare e kanë ndërmend t'i dëshmojnë, t'i ekspozojnë dëshmitë, të cilat i japin dhe t'i përcaktojnë çështjet juridike, në të cilat do të diskutojnë. Në fjalime nuk guxon të jepen fakte në se në të kaluarën ka qenë i gjykuar i pandehuri. Në fakt përmes fjalimeve hyrëse, të dy palët i ua shpalosin pjesëmarrësve në sallën e gjyqit teorinë e tyre lidhur me rastin dhe e publikojnë materialin dëshmues, i cili do të prezantohet në kuadër të procedurës së dhënies së dëshmive.

## 12. PËRJASHTIME NË LIDHJE ME NXJERRJEN E DREJTPËRDREJTË TË DËSHMIVE

Në pajtim me parimin e procedurës së akuzës, dëshmitë e seancës kryesore paraqiten **në mënyrë të drejtpërdrejtë**. Prandaj, nëse dëshmia e ndonjë fakti mbështetet në vërejtjen e ndonjë personi, atëherë ai person merret personalisht në pyetje në seancën kryesore në cilësinë e dëshmitarit. Deklaratat e dhëna të dëshmitarëve në procedurën hetimore dhe deklaratat, të cilat janë të grumbulluara në kuadër të veprimeve të mbrojtjes gjatë procedurës hetimore mund të përdoren vetëm gjatë marrjes në pyetje nga pala tjetër, gjatë hedhjes poshtë të pretendimeve të dhëna, për shkak të besueshmërisë së dëshmive të dhëna në seancën kryesore.

Nëse në seancën kryesore duhet të merret në pyetje **dëshmitari i mbrojtur**, marrja e tij në pyetje nuk mund të ndryshohet me lexim të proces verbalit nga deklarata e dhënë paraprakisht. Në këtë rast dëshmitari i mbrojtur do të merret në pyetje në pajtim me nenin 299 të LPP-së me pseudonim ose në pajtim me nenin 230 të LPP-së me ndihmën e pajisjeve teknike për përcjellje të imazhit dhe zërit, sipas mënyrës sesi ka vendosur gjykatësi, gjegjësisht këshilli për vlerësim të aktit të padisë, bazuar në propozim të dorëzuar paraprakisht me shkrim nga prokurori publik (neni 228 paragrafi 2 i LPP-së).

Sipas rregullit të nxjerrjes së drejtpërdrejtë të dëshmive janë paraparë disa përjashtime:

- me vendim të gjyqit, si dëshmi mund të nxirren procesverbalet e dhënies së deklaratave të seancës hetimore përmes leximit ose ripordhimit,
- me vendim të gjyqit, si dëshmi mund të nxirren deklaratat e dëshmitarëve të dhëna para prokurorit publik, nëse pas fillimit të seancës kryesore shpalosen të dhëna në bazë të të cilave mund të vihet në përfundim se dëshmitari ka qenë i ekspozuar në dhunë, kërcënim, ose i është dhënë premtim për të holla ose përfitim tjetër, që të mos dëshmojë ose që të dëshmojë rrejshëm gjatë seancës kryesore.

## 13. TË DREJTAT E POSAÇME TË KATEGORIVE VULNERABILE TË VIKTIMAVE

Viktimat kanë të drejtë për masa të posaçme të procesit të mbrojtjes gjatë dhënies së deklaratave dhe marrjes në pyetje në të gjitha fazat e procedurës, edhe atë nëse gjatë dhënies së deklaratës janë nën moshën 18 vjeçare, nëse me dhënien e deklaratës ose përgjigjes në pyetjen e caktuar do ta ekspozonin veten ose ndonjë person të afërm në rrezik serioz ndaj

jetës, shëndetit ose integritetit fizik (viktima të rrezikuara) dhe për shkak të moshës, natyrës së veprës penale dhe pasojave të veprës penale, invaliditetit fizik dhe psikik ose gjendjes tjetër të rëndësishme shëndetësore, të kaluarës shoqërore dhe kulturore, rrethanave familjare, bindjeve religjioze dhe përkatësisë etnike të viktimës, sjelljes së të akuzuarit, anëtarëve të familjes dhe miqve të të akuzuarit, do të kishin pasoja të dëmshme ndaj shëndetit ndaj psikik dhe fizik viktimës ose ndikim negativ ndaj cilësisë së deklaratës së dhënë (për viktima në veçanti të ndjeshme).

Prandaj me qëllim të mbrojtës së plotë të fëmijës-viktimë në kuadër të procesit gjyqësor, gjyqi duhet të përcaktojë masë të posaçme të ndarë ose së bashku me masë tjetër të mbrojtjes, video dhe audio xhirimi i deklaratës dhe bisedës me fëmijën të përdoret si dëshmi në procedurë. Në raste të jashtëzakonshme, për shkak të rrethanave të reja në lidhje me ngjarjen (lëndën) gjyqi mund të urdhërojë përsëri të merret në pyetje fëmija viktimë, por së paku njëherë përmes përdorimit të mjeteve teknike për komunikim.

## 14. PËRJASHTIMI I PUBLIKUT

Nga fillimi i procesit gjyqësor e deri të përfundimi i seancës kryesore këshilli mund që në çdo kohë brenda detyrës zyrtare ose me propozim të palëve ose të të dëmtuarit ta përjashtojë publikun nga një pjesë e seancës kryesore ose nga gjithë seanca kryesore, nëse një gjë e tillë është e nevojshme, për ruajtjen e sekretit shtetëror, ushtarak, zyrtar ose sekretit të rëndësishëm afarist, ruajtje të rendit publik, mbrojtje të jetës private të të akuzuarit, dëshmitarit ose të të dëmtuarit, mbrojtje të sigurisë së dëshmitarit, viktimës ose mbrojtje të interesave të fëmijës.

Gjyqi e përjashton publikun nga pjesa e procedurës, në të cilën riprodhohet shënimi i deklaratës dhe nga marrja në pyetje të fëmijës-viktimë, ose zbatohet masë tjetër e posaçme e procesit të mbrojtje gjatë marrjes së deklaratës ose marrjes në pyetje, ose ofrohen veprime të procesit, me të cilat mund të shkaktohet dëm ndaj personalitetit dhe zhvillimit të tij.

## 15. PËRDORIMI I DEKLARATAVE TË INCIZUARA DHE TË SHËNUARA SI DËSHMI

Nëse është e mundshme dhe ekzistojnë pajisje të posaçme TI (Teknologji Informatike), fëmijëve-viktima duhet t'u mundësohet të dëshmojnë, pa mos u paraqitur në gjykatë, me ndihmën e deklaratave të incizuara dhe të shënuara paraprakisht. Kjo nënkupton se fëmija nuk e ka patjetër të pres para se të paraqitet para gjyqit, iu shmanget problemeve në lidhje me humbjen e kujtesës dhe zvogëlohet kohëzgjatja e vetë procesit gjyqësor.

## 16. SIGURIMI I TË DREJTAVE TË POSAÇME TË KATEGORIVE VULNERABILE TË VIKTIMAVE

Gjyqi e ka për detyrë dhe duhet të përcaktojë masa të posaçme të procesit të mbrojtjes:

- kur fëmija-viktimë ka nevojë për kujdes dhe mbrojtje të posaçme ose
- kur fëmija-viktimë e trafikimit me njerëz, dhunës ose abuzimit seksual.



Gjyqi, gjegjesisht gjykatësi, i cili vepron **e ka për detyrë** të përcaktojë masë të veçantë ose së bashku me masë tjetër të mbrojtjes, video dhe audio xhirim të deklaratës dhe bisedës me fëmijën, që do të përdoret si dëshmi në procedurë gjyqësore.

Gjyqi, gjegjesisht gjykatësi **mund vetëm në raste të veçanta**, për shkak të rrethanave të reja të rastit, të urdhërojë që hetimi të përsëritet me fëmijën viktimë, por më së shumti edhe një herë edhe atë përmes shfrytëzimit të mjeteve teknike për komunikim.

Gjyqi, gjegjesisht gjykatësi, i cili e drejton lëndën e **ka për detyrë**, t'u sigurojë të drejta të posaçme viktimave të veprave penale, kundër seksuale dhe moralit seksual, humanizmit dhe të drejtës ndërkombëtare, andaj ta merr në pyetje viktimë me ndihmën e mjeteve audio vizuale, me çka nuk do të cenohet dinjiteti dhe respekti i personalitetit.

Gjyqi e **ka për detyrë** në këtë rast ta mësojë viktimën, më së voni para marrjes së parë në pyetje, për çka harton shënim me shkrim ose proces verbal.

Gjyqi e **ka për detyrë**, që gjithnjë kur të vërtetohet se, duke pasur parasysh moshën, gjendjen shëndetësore, natyrën ose pasojat e veprës penale, gjegjesisht rrethanat e rastit me viktimë të mitura në veçanti vulnerable ndaj trafikimit me njerëz, pastaj dhunën ose abuzimin seksual, si dhe faktin që marrja në pyetje në hapësirat e gjyqit, do të kishte pasoja të dëmshme ndaj shëndetit të tyre fizik dhe psikik, atëherë përmes përdorimit të mjeteve teknike për transmetim të fotografisë pa zë, marrjen në pyetje mund ta bëjë në hapësirën, në të cilën gjendet i dëmtuari dhe dëshmitari, pa prezencë të palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë, ashtu që palët, mbrojtësi dhe personat, të cilët kanë të drejtë t'i parashtrajnë pyetje, atë e bëjnë me ndërmjetësim të organit, i cili e drejton procedurë, psikologut, pedagogut, punëtorit social ose personit tjetër profesionist.

## 17. DËSHMIA E FËMIJËS-VIKTIMË PARA GJYQIT

### Masat e posaçme të procesit të mbrojtjes gjatë dhënies së dëshmisë

Gjykatësi **mund** të përcaktojë **përdorimin e ekraneve për mbrojtje** të fëmijës-viktimë dhe fëmijës dëshmitar nga shikimi i të akuzuarit,

Gjatë dhënies së deklaratës së fëmijës viktimë ose fëmijës dëshmitar gjykatësi **mund** të përcaktojë **fshehjen e identitetit ose pamjes** së fëmijës viktimë ose fëmijës dëshmitar, ashtu që me ndihmën e pajisjeve teknike për transmetim të fotografisë dhe tonit, të turbullohet imazhi dhe zëri i fëmijës viktimë. Për të marrë në pyetje një lloj të këtillë të dëshmitarit, fëmija-viktimë dërgohet në hapësirë të posaçme dhe të rregulluar, e cila është fizikisht e ndarë nga hapësira, në të cilën gjendet gjykatësi dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë.

Gjykatësi **mund** të përcaktojë, që fëmija viktimë ose fëmija dëshmitar, ta jep dëshminë e tij **përmes video konferencës**.

Gjykatësi **mund**, që derisa fëmija viktimë ose fëmija dëshmitar jep deklaratën, **ta heq togën dhe kapelën zyrtare**, duke u thirrur në të drejtat e posaçme të fëmijës, në pajtim me dispozitat e nenit 147 të LDF-së.

Gjykatësi **mund** dhe e ka për detyrë, që gjatë dhënies së dëshmisë nga fëmija viktimë ose fëmija dëshmitar ta **nxjerr publikun nga salla e gjyqit**, gjegjesisht hapësira, në të cilën fëmija merret në pyetje.

Gjykatësi **mund** dhe e ka për detyrë të përdor **TI (Teknologji Informatike) pajisje për shkak të sigurimit të video dhe audio xhirimit** të deklaratës, e cila do të përdoret si dëshmi.

Gjykatësi **mund** dhe e ka për detyrë të përdor **TI (IT) pajisje për shkak të sigurimit të video dhe audio xhirimit** të marrjes në pyetje, e cila do të përdoret si dëshmi.

Gjykatësi **mund** deklaratën e fëmijës viktimë ose fëmijës dëshmitar **ta merr përmes ndërmjetësisimit të personit profesionist**, i cili e informon me kohë për ta përgatitur për përmbajtjen e bisedës dhe mënyrën e marrjes në pyetje të fëmijës-viktimë.

Gjykatësi **mund** gjatë dhënies së deklaratës së fëmijës-viktimë dhe fëmijës dëshmitar **të përdor mjete të posaçme teknike për komunikim**.

Gjykatësi e **ka për detyrë** të sigurojë **mbrojtje të privatësisë së fëmijës dhe familjes së tij**.

Gjykatësi e **ka për detyrë ta përjashtojë publikun** nga pjesa e procedurës, në të cilën riprodhohet regjistrimi i deklaratës dhe marrjes në pyetje të fëmijës-viktimë, ose kur zbatohet masa tjetër e posaçme e procesit të mbrojtjes gjatë marrjes së deklaratës ose marrjes në pyetje, ose përmes realizimit të veprimeve të posaçme, me të cilat mund t'i shkaktohet dëm personalitetit të fëmijës-viktimë dhe zhvillimit të tij.

Gjykatësi e **ka për detyrë**, që gjatë marrjes së deklaratës dhe marrjes në pyetje të fëmijës-viktimë dhe fëmijës dëshmitar **të përkujdeset dhe mbajë llogari të posaçme për vetitë dhe karakteristikat e fëmijës, me qëllim që t'i mbrojë interesat e tij dhe të mundësojë zhvillim të drejtë të tij**.

## 18. MARRJA NË PYETJE E FËMIJËS-VIKTIMË ME NDIHMËN E PERSONAVE TJERË

Gjykatësi e **ka për detyrë** të vlerësojë, nëse është e nevojshme që për shkak të ndihmë së viktimave vulnerabile, të emërojë person të autorizuar gjatë marrjes në pyetje.

Marrja në pyetje e viktimave vulnerabile mund të bëhet me ndihmën e psikologut, punëtorit social ose personit tjetër profesionist.

Gjykatësi e **ka për detyrë** t'ua bëjë me dije palëve, se pyetet e viktimave-vulnerabile mund të parashtrohen vetëm përmes gjykatësit të lëndës dhe se ato e kanë për detyrë të sillen me vëmendje të posaçme ndaj kategorive vulnerabile, me qëllim që t'i shmangin pasojat e dëmshme të procedurës penale, ndaj personalitetit të tyre dhe shëndetit fizik dhe psikik.

## 19. KUR FËMIJA NUK MUND TË JETË DËSHMITAR

Duke u bazuar në moshën dhe zhvillimin psikik të fëmijës, gjykatësi e **ka për detyrë** të përcaktojë, nëse ai është ose nuk është i aftë ta kuptojë domethënien e së drejtës së vetë, për çka edhe nuk e ka patjetër të dëshmojë, përpos nëse vetë i pandehur e kërkon atë. Gjendjen e këtillë të fëmijës e përcakton gjykatësi përmes prindërve ose tutorëve të tij, ose me ndihmën e psikologut, punëtorit social dhe personave tjetër profesionistë.



## 20. MARRJA E DREJTPËRDREJTË NË PYETJE DHE MARRJA NË PYETJE NË MËNYRË TË KRYQËZUAR

Gjatë shpalosjes së dëshmime në seancën kryesore, gjatë procedurës së provave parashihen tre mënyra të marrjes në pyetje:

- **marrja e drejtpërdrejtë në pyetje**, të cilën e bën pala, e cila e ka propozuar atë dëshmitar, forenzik (ekspert) ose këshilltar teknik,
- **marrja në pyetje në mënyrë të kryqëzuar**, që bëhet nga pala e kundërt dhe
- **marrja në pyetje në mënyrë plotësuese**, të cilën përsëri e bën pala, e cila e ka ftuar atë dëshmitar, forenzik ose këshilltar teknik.

Gjykatësi e **ka për detyrë ta realizojë marrjen në pyetje** në mënyrë të ndjeshme dhe të posaçme, me qëllim që ta zvogëlojë frikësimin potencial.

Gjykatësi e **ka për detyrë** që gjatë gjykimit të sigurojë mbrojtje të plotë të fëmijës-viktimë dhe fëmijëve dëshmitare nga çfarëdo qoftë frikësimi.

**Marrja në pyetje bëhet në formë të bisedës së lirë me fëmijën viktimë, përkundër marrjes individuale në pyetje, gjegjësisht marrjes në pyetje të natyrës akuzuese.**

Gjykatësi e **ka për detyrë**, që gjatë zbatimit të marrjes në pyetje në mënyrë të kryqëzuar, për së afërmi ta kontrollojë dhe mbikëqyre procedurën, që maksimalisht të pengohen dëmtimet edhe abuzimet të mundshme të fëmijëve. Përveç kësaj, nuk guxon të harrohet edhe fakti se aftësi e fëmijës për përqendrim të vëmendjes është shumë më e vogël nga ajo e të rriturve, andaj gjithnjë kur ka nevojë, gjykatësi duhet të mundësojë pauza adekuate gjatë marrjes në pyetje, ose ta kufizojë numrin e pyetjeve, të cilat mund t'i parashtrihen fëmijës, me çka do të ruhet vëmendja e tij dhe do të sigurohet dëshmi cilësorë.

Gjykatësi e **ka për detyrë ta sigurojë dhe garantojë të drejtën e fëmijës-viktimë, se nëse nuk bëhet fjalë për rrethana të jashtëzakonshme gjatë procesit gjyqësor, atëherë fëmija viktimë vetëm njëherë do të merret në pyetje.**

Gjykatësi e **ka për detyrë** t'i mundësojë fëmijës-viktimë të drejtën, që kur palët ta marrin në pyetje, në rastet kur palëve në procedurën gjyqësore iu jepet mundësi që drejtpërsëdrejti t'i marrin në pyetje fëmijët, ta bëjnë atë në mënyrë thjeshtë, duke përdorë gjuhë të rëndomtë dhe dukë e pasur parasysh shkallën e kuptimit dhe vulnerabilitetit të fëmijës, gjegjësisht të mos e pengojnë aftësinë e tij për të dhënë përgjigje të sakta dhe precize.

Gjykatësi mund të sigurojë dhe lejojë prezencë të personave tjerë për shkak të dhënies ndihmë të fëmijës, gjatë marrje së tij në pyetje, nëse konsideron se fëmija-viktimë gabimisht e ka kuptuar pyetjen e parashtruar ose nuk e ka kuptuar atë plotësisht.

Gjykatësi e **ka për detyrë**, kur të lejojë marrje në pyetje në mënyrë të kryqëzuar, ta ndjek me kujdes dhe kontrollojë mënyrën dhe llojin e pyetjeve të parashtruara, gjegjësisht mënyrën sesi parashtrihen pyetjet.

Gjykatësi e **ka për detyrë** të pengojë taktika të ndryshme, të cilat i përdorin avokatët e mbrojtjes, si për shembull parashtrimi i pyetjeve jorelevante, të cilat kanë për qëllim ta frikësojnë ose shqetësojnë fëmijën-viktimë ose fëmijën dëshmitar; parashtrimi i shpejtë i pyetjeve ose

përsëritja e tyre, me çka synohet të hutohet fëmija-viktimë dhe të prolongohet përgjigja; parashtrimi i pyetjeve me përdorim të gjuhës, e cila nuk iu përputhet shkallës së zhvillimit të fëmijës-viktimë ose fëmijës dëshmitar; ose konkretisht në raste të abuzimit seksual, imponimi i konkluzionit, se akti është kryer me pëlqim të fëmijës-viktimë; ose parashtrimi i pyetjeve në lidhje me jetën dhe përvojat seksuale të fëmijës në të kaluarën.

Gjykatësi e **ka për detyrë** që t'i pengojë dhe refuzojë si të palejueshme taktikat e këtilla të marrjes në pyetje, të cilat mund të kalojnë në frikësim dhe maltretim të fëmijës-viktimë, për shkak se mund të kenë ndikim negativ dhe të dëmshëm ndaj fëmijës-viktimë, gjë që mund të jetë shkas për dhënie të deklaratave jo të sakta.

## 21. NDALIMI PËR T'U BALLAFAQUAR ME TË PANDEHURIN

Fëmija-viktimë dhe fëmija dëshmitar i trafikimit me njerëz, dhunës dhe abuzimit seksual, viktimë dhe dëshmitar i veprimeve tjera që me ligj janë të parapara dhe veprave penale ndaj njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare, si dhe veprime tjera që me ligj parashihen si vepra penale, për shkak të natyrës së tyre, pasojave ose rrethanave tjera që e bëjnë fëmijën në veçanti të ndjeshëm dhe i shkaktojnë gjendje të rëndë shpirtërore, **nuk lejohet të** ballafaqohet me të dyshuarin, respektivisht me të pandehurin.

## 22. DËGJIMI – BISEDË ME FËMIJËN-VIKTIMË

**Përgatitja paraprake për bisedë me fëmijën – viktimë në lidhje me dhënien e dëshmisë**

Gjykatësi është **i detyruar** që për zhvillim të bisedës (intervistës) së suksesshme me fëmijën-viktimë paraprakisht të përgatitet dhe të planifikojë mënyrën se si do të zhvillojë bisedën, me qëllim që t'i shmanget ndonjë shkeljeje eventuale të të drejtave të fëmijës-viktimë.

Gjykatësi **mund**, ta planifikojë mënyrën e zhvillimit të bisedës në bashkëpunim me ekspertë të angazhuar për kujdesin dhe ndihmën e fëmijëve, ose të kërkojë ndihmë nga psikologu, punonjësi social ose ndonjë person tjetër profesional, me qëllim që bisedën dhe marrjen në pyetje të fëmijës-viktimë ose fëmijës dëshmitar ta bëjë në mënyrë që do të mbrojë të drejtat e fëmijëve, me çka mënyrë nuk do të shkaktojë ndonjë shkelje ose dëmtim shtesë të personalitetit të tyre, respektivisht zhvillimit të tyre.

## 23. NJOFTIMI DHE VENDOSJA E RAPORTEVE PËRKATËSE PËR ZHVILLIMIN E BISEDËS

Gjykatësi **duhet** që nga fillimi i bisedës, të prezantohet në mënyrë të kuptueshme për fëmijën-viktimë dhe ta përgatisë fëmijën-viktimë për bisedë, duke i shpjeguar qëllimin e bisedës, për atë se cilët persona do të jenë prezentë gjatë bisedës, sa kohë do të zgjasë i tërë procesi, dhe në fund do t'i shpjegojë fëmijës-viktimë se ç'do të ndodh pasi të mbarojë biseda.

Gjykatësi është **i detyruar** që fëmijës-viktimë t'i shpjegojë mënyrën e incizimit, respektivisht mënyrën se si do të përgatitet (mbahet) procesverbali për bisedën, si dhe do t'i jep të dhëna për atë se në ç'mënyrë do të përdoren informacionet e dala nga biseda.



Gjykatësi **duhet** ta informojë dhe ta bindë fëmijën, nëse nuk e di përgjigjen e ndonjë pyetjeje, ose nuk e kupton mirë atë, ta njoftojë gjykatësin për këtë mosnjohje dhe të merr shpjegim përkatës, respektivisht shpjegim shtesë për të sqaruar rrethanat e ngjarjes.

Fëmija-viktimë **ka të drejtë** ta njoftojë gjykatësin me qëllim që të bëhet korigjimi, nëse vlerëson se gjykatësi që zhvillon bisedën, e ka kuptuar gabimisht ndonjë përgjigje të dhënë, ose nëse gjykatësi nuk e ka kuptuar drejtë përgjigjen e dhënë.

Gjykatësi është **i detyruar** gjatë tërë kohës së bisedës të orvatet të krijojë atmosferë të relaksuar, të përdorë mënyra dhe metoda për relaksim të fëmijës gjatë bisedës, si dhe të tentojë të gjejë mënyra për vendosjen e mirëbesimit të ndërsjellë ndërmjet fëmijës-viktimë dhe gjykatësit.

Gjykatësi është **i detyruar** që gjatë bisedës të tregojë kujdes të veçantë ndaj fëmijës, me durim të ndërtojë raporte të mirëbesimit, të dijë që ndonjëherë është e nevojshme që fëmijës i duhet më tepër kohë, që të mund të relaksohet dhe të ndjehet i rehatshëm dhe i përgatitur për bisedë me gjykatësin, veçanërisht, kur fëmija duhet të kujtohet për ndonjë ngjarje të caktuar traumatike, e cila përfshin çështje dhe ndenja intime.

## 24. SIGURIMI I INFORMACIONEVE

Gjykatësi **duhet** të praktikojë mënyrë të bisedës me të cilën sa më tepër që është e mundur t'i jep mundësi fëmijës që ai vetë pandërprerë të shpjegojë dhe të inkurajohet që të tregojë rrëfimin e vetë, në mënyrë të vetë dhe me fjalë të veta.

Gjykatësi **duhet** të dijë se sigurimi i detajeve rreth ngjarjes, informacioneve shtesë ose vazhdimi i suksesshëm i rrëfimit, është e nevojshme që pandërprerë ta inkurajojë fëmijën me frazat e llojit “ç’ndodhi pastaj”

Gjykatësi **mund**, kur të paraqitet nevoja për parashtrimin e pyetjeve shtesë, respektivisht pyetjeve për qartësim ose informacione shtesë, të parashtrijë pyetje me karakter të hapur.

Gjykatësi është **i detyruar** që asnjëherë të mos përdorë pyetje orientuese dhe sugjestive, të cilat e orientojnë fëmijën që të jep përgjigje të caktuar, dhe është i detyruar të pengojë çdo palë, që merr pjesë në bisedë të parashtrijë pyetje të tilla.

Gjykatësi gjatë bisedës me fëmijën-viktimë **duhet** t’iu shmanget përsëritjeve të pyetjeve të njëjta, për shkak se fëmija-viktimë mund të mendojë se përgjigja e tij paraprake ka qenë e papranueshme ose “e gabuar”.

## 25. PËRFUNDIMI I BISEDËS ME FËMIJËN

Gjykatësi është **i detyruar** të ketë kujdes për mënyrën se si do ta përfundojë bisedën me fëmijën-viktimë, dhe për këtë të gjejë mënyrën më të përshtatshme.

Gjykatësi është **i detyruar** para përfundimit të bisedës të pyesë fëmijën se a ka diçka tjetër për të plotësuar ose thënë, ose mund të ketë ndonjë pyetje që dëshiron ta parashtrijë.

Gjykatësi është **i detyruar** pas përfundimit të bisedës t’i shpjegojë edhe njëherë fëmijës se, në ç’ mënyrë do të përdoren informacionet dhe të dhënat e dala nga biseda, me qëllim që t’i ndihmohet fëmijës të formojë pritje adekuate se ç’ mund të ndodh në të ardhmen.

Gjykatësit i **rekomandohet ose i sugjerohet** që në fund të bisedës është **e nevojshme** t'i falënderohet fëmijës-viktimë, dhe të njëjtin ta njoftojë me të gjitha shërbimet dhe mundësitë për mbështetje personale, të cilat i ka në dispozicion.

## 26. VEPRIMET E GJYKATËS

Duke pasur parasysh rolin dhe pozitën e gjyqit në trajtimin e lëndëve penale në pajtim me LPP-në, veçanërisht është e rëndësishme që për vepra të caktuara penale të dhunës, gjatë procedurës paraprake patjetër duhet të përgatiten ekspertiza përkatëse për gjendjen psikofizike të fëmijës-viktimë të dhunës, në mënyrë që të përcaktohen shkaqet dhe pasojat dhe të përpilohet raporti neuro-psikiatrik edhe për autorin e krimit edhe për fëmijën-viktimë.

Gjykata është **e detyruar** që gjatë procedurës të kërkojë të përpilohet raport profesional nga Qendra për punë sociale, ku do të përmbliidhen të gjitha faktet relevante lidhur me strukturën e familjes, personalitetin e autorit të krimit (veprës), viktimës, shkaqet për sjelljen devijante të autorit të krimit, kohëzgjatja e sjelljes së këtyllë, gjendja materiale dhe financiare në familje dhe të dhëna të tjera relevante të cilat janë të patjetërsueshme për procedurën e mëtejme.

## 27. ROLI I GJYKATËS GJATË SEANCËS KRYESORE

Prokuroria ka rol kryesor në dëshmimin (argumentimin) e fajit, mbrojtja ka rol aktiv në kontestimin e tezës së prokurorisë, ndërsa gjykata është arbitër pasiv me një rol udhëheqës, kontrollues dhe garantues.

Gjykata vendos për provat, për fajet dhe sanksionet, si dhe për kërkesën e dëmshpërblimit të fëmijës-viktimë.

## 28. FJALËT PËRFUNDIMTARE

Pas mbarimit të procedurës së provave, gjykata do t'i thërras: paditësin, të dëmtuarin, mbrojtësin dhe prokurorin për të thënë (dhënë) fjalën përfundimtare.

Fjalët e tyre të fundit i thonë pas mbarimit të seancës dëshmuese. Nëse i pandehuri ka më tepër mbrojtës, çdonjëri nga ato mund ta thotë fjalën e fundit, mirëpo ata nuk mund të përsëriten, ndërsa gjykatësi, respektivisht kryetari i këshillit gjyqësor mund ta kufizojë kohëzgjatjen e fjalës së tyre përfundimtare.

## 29. MBARIMI I SEANCËS KRYESORE

Pas thënies së fjalës së fundit, kryetari i këshillit, respektivisht gjykatësi do të njoftojë për mbarimin e seancës kryesore. Në procesverbal do shënohet se në sa ora ka mbaruar seanca kryesore, ndërsa këshilli do të tërhiqet për t'u këshilluar dhe votuar për marrje të vendimit.

## 30. MARRJA, HARTIMI DHE SHPALLJA E VENDIMEVE

Pasi gjyqi ta lëshojë aktgjykimin, kryetari i këshillit gjyqësor e shpall menjëherë atë. Nëse gjykata nuk ka mundësi ta shpall aktgjykimin në të njëjtën ditë pasi të mbarojë seanca kryesore, ai mund ta prolongojë shpalljen e aktgjykimit jo më shumë se tre ditë, mirëpo do ta përcaktojë kohën dhe vendin e shpalljes së aktgjykimit.



Nëse publiku është i përjashtuar nga seanca kryesore, shqiptimi i aktgjykimit lexohet çdoherë në seancë publike. Këshilli do të vendos nëse dhe sa do ta përjashtojë publikun gjatë shpalljes së shkaqeve të aktgjykimit. Të gjithë të pranishmit leximin e shqiptimit të aktgjykimit e dëgjojnë duke qëndruar në këmbë.

## 31. DËMSPËRBLIMI

Dëmshpërblimi është hap i rëndësishëm i viktimave për shkak të pranimit të dëmit që i janë shkaktuar.

Dëmshpërblimi mund të jetë formë e kompensimit financiar për humbje materiale, ose dëm të pësuar për shkak të veprës penale, shërbimeve mjekësore dhe psikologjike, ose pranimit të vuajtjes së përjetuar.

Kjo mund të jetë edhe një porosi simbolike për fëmijët-viktimë që kanë arritur ndonjë nivel të drejtësisë.

## 32. PROCEDURA PËR DËMSPËRBLIM

Në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë ndahen mjete për dëmshpërblim të fëmijës viktimë ose të dëmtuar nga akti, që me ligj është i paraparë si vepër penale të dhunës dhe akteve të tjera të dhunës individuale apo grupore.

Ministri i Drejtësisë, pasi që paraprakisht merr mendimin e Këshillit Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve, nxjerr program vjetor me të cilin i planifikon burimet dhe mënyrën e shpenzimit të mjeteve. Çështjet administrativo-teknike për pagesën e mjeteve i kryen Ministria e Drejtësisë.

Fëmija për të cilin me vendim gjyqësor të plotfuqishëm vërtetohet se është viktimë, respektivisht i dëmtuar nga ndonjë veprim, i cili me ligj parashihet si vepër penale ose kundërvajtje me elemente të dhunës, të cilit i njihet kërkesa pronëso-ro-juridike, mund të parashetrojë kërkesë për dëmshpërblim deri te gjykata përkatëse, kur për shkak të pengesave faktike dhe juridike kërkesa pronëso-ro-juridike nuk mund të realizohet nga prona e autorit të veprës penale ose aktit tjetër të dhunës dhe kur nga plotfuqia e vendimit për kërkesë pronëso-ro-juridike kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj.

Kërkesën, përveç fëmijës, mund ta parashetrojnë edhe prindërit e fëmijës, respektivisht tutorët.

Gjykata do të nxjerr vendim për dëmshpërblim në shumën e kërkesës së aprovuar pronëso-ro-juridike, pa rritje në bazë të interesit ose shpenzimeve tjera shtesë rreth realizimit të kërkesës.

Nëse gjykata e refuzon kërkesën, fëmija-viktimë ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Apelit në afat prej tetë ditëve nga marrja e vendimit për refuzim. Vendimi i Gjykatës së Apelit është përfundimtar.

Vendimin përfundimtar për pagesën e dëmshpërblimit gjykata ia dorëzon Ministrisë së Drejtësisë, e cila e realizon pagesën.

Për pagesën e realizuar Ministria e Drejtësisë e njofton gjykatën, e cila e ka nxjerr vendimin më së voni një muaj nga pagesa e realizuar.

Nëse dëmshpërblimi është paguar nga mjetet e përcaktuara me dispozitat e ligjit për drejtësi për fëmijë, gjykata e dorëzon vendimin për dëmshpërblim te Avokati i Shtetit për ngritjen e procedurës për realizim të pagesës së detyrueshme të dëmshpërblimit nga pasuria e autorit të veprës.

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë, e cila realizohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për përmbarrim.

## PROCEDURA GJYQËSORE CIVILE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE-VIKTIMË NGA DHUNA, ABUZIMI DHE NEGLIZHENCA

Me Ligjin për familje parashihen masa për mbrojtje të fëmijëve nga dhuna, abuzimi dhe neglizhenca dhe rregulla për procedurë të veçantë gjyqësore në kuadër kur ato mund të realizohen.

Në raport me çështjet e procesit të cilat nuk janë të përfshira me rregullat e theksuara, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë kontestimore.

### 1. ZBULIMI I FËMIJËVE-VIKTIMË NGA DHUNA, ABUZIMI DHE NEGLIZHENCA DHE INICIMI I PROCEDURËS

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për procedurë kontestimore në mënyrë të pavarur ose njëkohësisht mund të ngritën: konteste për mbrojtje nga dhuna familjare, konteste për privim të pjesshëm ose të plotë nga të drejtat prindërore dhe konteste për mbrojtje të të drejtave të fëmijës, të njëjtat mund të ngritën nga subjekte legjitime aktive.

Procedura në kontestet për mbrojtje të të drejtave të fëmijës, respektivisht mbrojtja nga dhuna, mund të zhvillohet edhe si procedurë e lidhjes (adhesive), me procedurën për konteste martesore dhe për vërtetësinë e atësisë ose me procedura tjera gjyqësore civile në kontestet familjare.

Vetë gjykata në kontestet familjare është e autorizuar, pa marrë parasysh kërkesën e palës, të përcaktojë një ose më tepër masa për mbrojtje të fëmijës nga dhuna në familje, si dhe të vendos për privim të pjesshëm ose të plotë të të drejtës prindërore.

Njohuritë e para për ekzistimin e dyshimeve të dhunës, abuzimit dhe neglizhencës ndaj fëmijës, gjykatësi sipas rregullit i merr me pranimin e padisë, ose nga të dhënat deri te të cilat ka ardhur lidhur me ndonjë procedurë tjetër gjyqësore.

Gjykata, njohuri tjera të caktuara mund t'i merr edhe kur fëmija, nga ndonjë person i tij i afërt ose institucion, kërkojnë nga gjykata për të caktuar ndonjë përfaqësues të përkohshëm në përputhje me dispozitat e LPK-së.



Gjykata mund të arrijë në njohuri se, fëmija është viktimë e dhunës, abuzimit dhe neglizhencës:

- drejtpërdrejtë nga vëzhgimi personal i ndryshimeve të cilat vërehen te fëmija kur ai merret në pyetje si palë ose dëshmitar (lëndime të dukshme trupore, ose sjellja e fëmijës është e pazakontë për moshën që e ka), marrja në pyetje të palëve dhe dëshmitarëve tjerë, mbi bazën e deklaratave të fëmijës, i cili nuk është palë ose dëshmitar në procedurë, marrja në pyetje e kujdestarit ose përfaqësuesit të përkohshëm, nga faktet të cilat gjykatësi i ka mësuar nga ndonjë procedurë tjetër gjyqësore.
- në mënyrë indirekte me marrjen, sipas detyrës zyrtare, e raportit nga institucionet edukativo-arsimore, nga qendrat për çështje sociale, nga institucionet shëndetësore dhe nga organet për ndjekje penale, nëse në veprimet ka elemente të veprës penale ose kundërvajtjes, respektivisht vetëm iniciativë për paraqitjen e raportit nga ana e institucioneve të theksuara.

## 2. STANDARDET PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS

Gjykata është e detyruar në pajtim me LPK-në, por edhe në pajtim me dokumentet juridike ndërkombëtare të sigurojë që të zhvillohet procedurë gjyqësore civile, edhe atë:

- të njihet rreziku i fëmijës nga dhuna, abuzimi dhe neglizhenca, dhe të përshtaten rregullat e procedurës që të respektohen nevojat e tij të veçanta, duke përfshirë edhe nevojat e tij të veçanta si dëshmitar;
- të njoftohen fëmijët me të drejtat e tyre dhe rolin, me kohëzgjatjen dhe rrjedhën e procedurës në shqyrtimin e rastit të tyre;
- të jepet mundësi që në procedurën në të cilën janë të rrezikuara interesat e tyre personale, të prezantohen dhe shqyrtohen qëndrimet, nevojat dhe preokupimi i fëmijëve në përputhje me rregullat e të drejtave procedurale nacionale;
- të sigurohet shërbim adekuat për mbështetje të fëmijëve gjatë procedurës gjyqësore;
- të sigurohet mbrojtje në mënyrë adekuate nga aspekti i privatësisë dhe identitetit të fëmijës, dhe të merren masa në përputhje me ligjin në mënyrë të shmangies së përhapjes së informacionit që mund të shpie në identifikimin e tyre;
- në disa raste të veçanta të sigurohet siguria e fëmijëve, si dhe siguria e familjeve të tyre dhe dëshmitarëve të cilët dëshmojnë në interesin e tyre nga kanosja dhe hakmarrja eventuale;
- të shmanget shtyrja e panevojshme e shqyrtimit të lëndëve, si dhe zbatimit të vendimeve ose vendimit për dëmshpërblim të fëmijës.

## 3. PARIMET E PROCEDURËS

Në procedurat gjyqësore civile mbrojtja e fëmijës-viktimë nga dhuna, abuzimi dhe neglizhenca nga ana e prindërve ose nga ana e personave që formalisht ose faktikisht kanë marrë përgjegjësi dhe kujdesen për fëmijët, realizohet me procedurë të veçantë edhe atë, me procedurë për të drejtat e fëmijëve, si dhe nëpërmjet institutit të privimit të së drejtës prindërore dhe

mbrojtja nga dhuna në familje.

Procedura gjyqësore civile që ka për qëllim nxjerrjen e vendimit për mbrojtjen e fëmijës nga dhuna, abuzimi dhe neglizhenca ngritët (iniciohet) me ankesë.

Kjo procedurë kontestimore karakterizohet me:

- urgjencë,
- përjashtimin e publikut;
- konfidencialitetin e të dhënave të dokumenteve gjyqësore;
- parimet e jashtëzakonshme hetuese;
- zyrtarizmin, dhe
- dispozicionin e kufizuar të palëve.

Gjykata ka autorizime të mëdha në kontestet e marrëdhënieve familjare, në të cilat fëmijës i ofrohet mbrojtje adekuate nga dhuna, abuzimi dhe neglizhenca. Në ato procedura kundrejt procedurës kontestimore klasike, parimi i zyrtarizmit ka një primatë mbi parimin e dispozicionit të palëve. Andaj, rregullat e përgjithshme të procedurës kontestimore kontradiktore janë të bazuara mbi parimin e dispozicionit të cilat e detyrojnë gjykatën që të veprojë vetëm në kuadër të kërkesës së ankimit.

Parimi hetues zbatohet vetëm kur gjykata do të konstatojë se palët përpjekën të kenë në disponim kërkesën e cila është në kundërshtim me rregullat e detyrueshme, traditat dhe moralin shoqëror.

Kundrejt kësaj, në kontestet familjare, gjykata është e autorizuar edhe pa parashtrimin e kërkesës nga pala, nëse me zbatimin e parimit hetues konstaton se ndaj fëmijës është ushtruar dhunë, është abuzuar dhe neglizhuar, atëherë sipas detyrës zyrtare mund të përcaktojë një ose më shumë masa të mbrojtjes. Gjithashtu, në varësi të rrethanave, gjykata mundet, edhe pa parashtrimin e kërkesës nga pala, të vendosë mbi privimin e pjeshëm ose të plotë të së drejtës prindërore, ndërsa, nëse përcaktohet t'ia merr të drejtën prindërore, mund të nxjerr vendim për ndarjen e fëmijës nga familja duke e vendosur atë nën mbrojtje të organit të kujdestarisë.

Por, në kontestet familjare në të cilat vendoset për kryerjen e të drejtës prindërore, gjykata mund të vendosë që pjesërisht ose plotësisht të revokojë të drejtat prindërore dhe të nxjerr vendim për përcaktimin e një ose më shumë masave të mbrojtjes nga dhuna, edhe pse pala që ka ngritur kontestin nuk ka parashtruar kërkesë ankimi. Të gjitha këto procedura janë me karakter urgjent.

## 4. PROVAT

Nëse kemi të bëjmë me njohuri të drejtpërdrejta ose indirekte, gjykata deri te faktet e rëndësishme arrin me prezantimin e provave në seancën kryesore, ku gjykata ka në dispozicion këto prova: kontrollimin, dokumentacionin, ekspertizën, marrjen në pyetje të dëshmitareve dhe palës, raportin profesional dhe mendimin nga institucioni për ndërmjetësim në marrëdhëniet familjare.



Fakte të rëndësishme të cilat gjykata duhet t'i konstatojë për të nxjerrë vendim për përcaktimin e masave përkatëse të mbrojtjes, ndër të tjera, janë edhe këto:

- veprimet e kryerjes,
- lloji, rëndësia dhe përsëritja,
- pasojat që fëmija i pëson dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e tij psikofizik,
- statusi psikologjik i fëmijës, prindërve dhe anëtarëve të familjes, nëse ndonjë anëtar i familjes ushtron dhunë,
- kushtet ekonomike dhe sociale në të cilat jeton fëmija,
- nevojat e fëmijës në planin edukativo-arsimor, respektivisht a mundet prindi tjetër ose anëtari i familjes t'i përmbushë ato nevoja,
- mendimi i fëmijës nëse është në interesin e tij më të mirë.

## 5. POZITA E FËMIJËS NË PROCEDURËN GJYQËSORE CIVILE

Fëmija në procedurën gjyqësore civile mund të paraqitet:

- si palë,
- si dëshmitar, dhe
- si person për të drejtat e të cilit vendoset, ndërsa nuk ka status të palës.

## 6. FËMIJA SI PALË

Kur një fëmijë paraqitet si palë në procedurë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, dhe në kontestet për kryerje, respektivisht revokimin e të drejtës prindërore, **detyra e parë dhe themelore e gjykatës është të konstatojë nëse fëmija është i aftë të formojë (konceptojë) opinionin e tij.**

Nëse fëmija është i aftë të formojë opinion, gjykata vlerëson duke marrë parasysh:

- moshën e tij,
- zhvillimin e tij psikofizik,
- aftësitë zhvilluese, etj.

Për konstatimin e këtyre aftësive, gjykata është e detyruar të merr mendim nga Qendra për punë sociale, edhe sipas mundësisë, nga psikologu i shkollës ku fëmija mëson nëse fëmija është i moshës shkollore, respektivisht nga institucioni këshillëdhënës familjar ose nga ndonjë institucion tjetër i specializuar për ndërmjetësim në marrëdhëniet familjare.

Vlerësimi i gjykatës për aftësinë e fëmijës për të shprehur mendimin e vet mund të kundërshohet vetëm me ankesë të aktgjykimit.

## 7. PËRFAQËSIMI I FËMIJËS SI PALË NË PROCEDURË

Nëse fëmija është i legjitimuar që të jetë palë në procedurë, ka të drejtë të përfaqësohet nga prindërit e tij, si përfaqësues ligjorë.

Në rast të kolizionit të interesave të fëmijës dhe interesave të prindërve të tij, fëmija ka të drejtë që të kërkojë nga organi i kujdestarisë, respektivisht nga gjykata që të emërojë kujdestar kolizioni ose përfaqësues të përkohshëm.

Fëmija këtë të drejtë mund ta realizojë vet, nëpërmjet një personi tjetër ose institucioni, nëse ka mbushur 10 vjet, dhe nëse është i aftë për të gjykuar. Në të gjitha rastet tjera, përfaqësuesi i përkohshëm mund të emërohet nga gjykata sipas detyrës zyrtare, nëse vlerëson se fëmija nuk është i përfaqësuar siç duhet.

Nëse interesat e fëmijës dhe përfaqësuesit të tij ligjor janë në kundërshtim, gjykata do të caktojë një përfaqësues të përkohshëm dhe për këtë do ta njoftojë organin e kujdestarisë.

Nëse gjykata nuk e cakton përfaqësuesin e përkohshëm, është i detyruar që për nevojat e emërimit të përfaqësuesit të veçantë të fëmijës ta njoftojë organin e kujdestarisë i cili do emërojë kujdestar sipas detyrës zyrtare.

Detyra e personit të caktuar në procedurën gjyqësore për ta përfaqësuar fëmijën pa marrë parasysh se a është i caktuar nga gjykata ose nga organi i kujdestarisë është që të kujdeset që fëmija me kohë t'i merr të gjitha informacionet lidhur me procedurën e ngritur, **t'i shpjegojë rreth pasojave të veprimeve të cilat i ndërmerr dhe gjykatën ta njoftojë me mendimin nëse fëmija drejtpërdrejtë nuk ka shprehur mendimin e vet para gjykatës.**

Gjykata, gjithashtu, **është e detyruar që fëmijës t'i sigurojë pjesëmarrje aktive në procedurë, ku me ligj në mënyrë eksplicite thuhet se mendimi i fëmijës përcaktohet në bashkëpunim me psikologun, respektivisht me organin e kujdestarisë, institucionin këshillëdhënës familjar, ose ndonjë institucion tjetër i specializuar për ndërmjetësim në marrëdhëniet familjare.**

## 8. FËMIJA SI DËSHMITAR

Fëmija, si dëshmitar, mund të paraqitet edhe në procedurat gjyqësore civile në të cilat vendoset ose nuk vendoset për të drejtat e tij.

Pozita e fëmijës në atë rast është e njëjtë si e personave të rritur të cilët paraqiten si dëshmitar.

Megjithatë, në aspekt të teknikës të zhvillimit të bisedës me fëmijën në procedurën gjyqësore civile është i nevojshëm aplikimi i rregullave të mbrojtjes së të drejtës penalo-juridike të fëmijës:

- fëmija është subjekt, e jo objekt i të drejtave, andaj gjykata është e detyruar t'i mundësojë fëmijës të prononcohet për shkak se vendoset për të drejtat e tij ( e drejta për jetën, shëndetin, zhvillimin e duhur, arsimin, etj);
- gjykata duhet të jetë e kujdesshme se bëhet fjalë për një kategori personash të ndjeshëm për shkak të moshës së tyre, gjinisë, përvojës në jetë, gjendjes shëndetësore, dhe faktik se rrjedhin nga familje ku ushtrohet dhunë, abuzim dhe



neglizhencë;

- përgatitja psikologjike e fëmijës gjatë prezantimit të provave nga ekspertët është një kusht i patjetërsueshëm për prezantimin cilësor të provave, me qëllim që statusi psikofizik i fëmijës, nëse ekziston vlerësimi i rrezikut, mos të jetë i cenuar. Me këtë, njëkohësisht, parandalohet abuzimi institucional i fëmijës, respektivisht fëmija mos të merret në pyetje disa herë;
- fëmijës duhet t'i mundësohet të ndjehet i lirë me vetëdije ose pavetëdije nga faji i imponuar se është shkak për sjelljen e prindërve ose për sjelljen e ndonjë anëtarit tjetër në familje dhe se me deklaratën e tij do të vështirësojë statusin e tyre në procedurë;
- zhvillimi i bisedës me fëmijën bëhet me ndihmën e psikologut, pedagogut ose të ndonjë personi tjetër profesional, respektivisht shërbimit profesional për ndërmjetësim në marrëdhëniet familjare.

Gjithashtu, është e patjetërsueshme të pranohen si standarde juridike dispozitat e legjislaturës penale:

- zhvillimi i bisedës me fëmijën nëpërmjet video-linjës dhe në hapësirë e cila është e dedikuar për këtë çështje, me pëlqimin e psikologut të fëmijës ose personit tjetër profesional.
- përdorimi i pasqyrave të njëanshme, nëse zhvillohet biseda në hapësirë të organeve shtetërore të cilat kanë mundësi teknike.
- ndalimi i ballafaqimit me personin kundër të cilit është ngritur procedurë, nëse fëmija është në gjendje të veçantë shpirtërore, për shkak të llojit, rëndësisë dhe kohëzgjatjes së dhunës, abuzimit dhe neglizhencës në një periudhë më të gjatë.

## 9. PROCEDURA NË TË CILËN VENDOSËT MBI TË DREJTAT E FËMIJËS PA STATUS TË PALËS

Fëmija nuk ka status të palës në konteste, në të gjitha ato situata, kur procedura kundër kryerësit e ka ngritur ndonjë tjetër (prindi tjetër, organi i kujdestarisë ose prokurori publik)

Fëmija, gjithashtu, nuk ka status të palës as në kontestet gjyqësore, nga marrëdhëniet familjare, në të cilat vendoset mbi të drejtat e anëtarëve të rritur të familjes, madje as në ato konteste ku njëkohësisht vendoset edhe për të drejtat e veta (për shembull, kontest martesore).

## 10. SHPREHJA E MENDIMIT TË FËMIJËS

Ligji mbi familjen e obligon gjykatën dhe organet shtetërore që në të gjitha procedurat në të cilat vendoset për të drejtat e fëmijës, mendimit të tij t'i përkushtohet një vëmendje e veçantë.

Fëmija e ka të drejtën për të shprehur mendimin e vet në ato procedura pa marrë parasysh moshën e tij.

Fëmija më i vjetër se 10 vjet ka të drejtë mendimin e vet ta shpreh në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Gjykata, mendimin e fëmijës, e siguron në bashkëpunim me psikologun, respektivisht me organin e kujdestarisë, institucionin këshillëdhënës familjar ose institucion tjetër për ndërmjetësim në marrëdhëniet familjare dhe me pjesëmarrjen e personit të cilin vet fëmija do ta përzgjedhë.

Është detyrë e gjykatës që fëmija i cili nuk i ka mbushur 10 vjet t'i mundësojë që në mënyrë adekuate të shpreh mendimin e vet dhe atij mendimi t'i përkushtojë vëmendje të veçantë në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij. Gjykata, për vlefshmërinë e mendimit, duhet të sigurojë vlerësim dhe mendim nga organi i kujdestarisë.

Mendimi i fëmijës jepet, sipas rregullit, në prani të personit të rritur të cilin fëmija e ka zgjedhur në mënyrë të pavarur dhe në të cilin ka besim dhe nuk është e patjetërsueshme të jetë anëtar i familjes.

Fëmija mund që opinionin e vet ta shpreh edhe në prani të profesorit ose çdo personi tjetër të rritur.

Gjykata është e detyruar të konstatojë se a thua fëmija duke marrë parasysh karakteristikat e tij psikofizike është i aftë të formojë opinion personal dhe të njëjtin ta shpreh në mënyrë të lirë dhe të tregojë nëse është në interes të tij më të mirë.

Nëse plotësohen të gjitha këto kushte, gjykata është e detyruar që fëmijën ta njoftojë me të gjitha informacionet dhe t'i shpjegojë për pasojat e mundshme dhe veprimet të cilat ato i ndërmarrin.

Kur një fëmijë me aftësi të kufizuara e realizon të drejtën e tij me shprehje të drejtpërdrejtë të mendimit në procedurën gjyqësore civile dhe administrative, në pajtim me dispozitat e ligjit, në atë rast mund të përdoren shërbimet e interpretimit për personat shurdhmemecë. Ligjet procedurale, në ndërkohë, nuk njohin lloj tjetër të ndihmës ose mjete tjera teknike.

## 11. KUR FËMIJA NUK KA TË DREJTË TË SHPREH MENDIMIN E VET

Fëmija në pajtim me dispozitat e LPK-së, është i privuar nga e drejta që të shpreh mendimin e vet, çdoherë kur gjykata do të vlerësojë se, mendimi i fëmijës është në kundërshtim me interesat e tij. Por, nuk është paraparë mjet juridik me të cilin mund të arrihet kontroll mbi një vendim të këtillë gjatë procedurës para gjykatës së shkallës së parë.

Vendimi i gjykatës së shkallës së parë ku fëmijës i privohet e drejta për të shprehur mendimin e vet mund të kundërshtohet vetëm me ankesë kundër aktgjyimit të shkallës së parë me të cilin është vendosur për çështjen kryesore, andaj ai aktgjykim duhet të shpjegohet (justifikohet).

## 12. INTERESI MË I MIRË I FËMIJËS

Gjykata është e detyruar që me nxjerrjen e vendimit për fëmijën, të njëjtit t'i sigurojë mbrojtje dhe kujdes që janë më se të nevojshme për zhvillimin e tij, duke marrë parasysh të drejtat dhe detyrimet e prindërve të tij, kujdestarit ligjor ose personave tjerë të cilët janë përgjegjës juridik për fëmijën.



Gjykata interesin më të mirë të fëmijës do ta përcaktojë duke marrë parasysh këto elemente:

- karakteristikat e fëmijës (mosha, gjinia, prejardhja, aftësitë e kufizuara, çrregullimet në sjellje, si dhe rrethanat tjera),
- siguria e fëmijës – rrezikun nga lëndimet ose dëmtimet,
- dëshirat dhe ndjenjat e fëmijës duke marrë parasysh moshën dhe pjekurinë e tij,
- nevojat fizike, emocionale, shëndetësore, edukative të fëmijës lidhur me vendbanimin, ushqimin, veshjen,
- aftësitë e prindërit për përmbushjen e nevojave të caktuara të fëmijës,
- resurset të cilat mund të përdoren për të siguruar kushte nxitëse për zhvillim dhe rritje të fëmijës,
- ndikimi i pritur për ndryshime eventuale të rrethanave të fëmijës,
- është e nevojshme të kalojë kohë për adoptim në mjedis të ri ose për mënjanimin e pasojave nga dhuna, respektivisht nga abuzimi dhe neglizhenca.

### 13. PROCEDURA E ANKIMIT

Fëmija është i kufizuar të ankohet vetëm nëse në procedurë ka qenë palë.

Nëse fëmija ka kapacitet gjyqësor, atëherë mund të parashtrijë ankesë, ndërsa nëse nuk ka, atë mund ta bëjë përmes përfaqësuesit ligjor.

# PARAQITJA SKEMATIKE E DËMSHPËRBLIMIT TË FËMIJËS-VIKTIMË

## AKTGJYKIMI

### KËRKESA

e parashtruar deri te gjykata për dëmshpërblim neni 152 parag.1 i LDF-së

1. konstatimi se është fëmijë-viktimë,
2. i dëmtuar me veprime, që me ligj parashihen si vepra penale,
3. fëmijës i është e njohur kërkesa e së drejtës pronësore. neni 152 parag. 1 i LDF-së

### VENDIMI

për dëmshpërblim neni 152 parag. 3 i LDF-së

- shuma e shqiptimit të dënimit pronësoro-juridike,
- pa rritje të interesit dhe shpenzimeve tjera shtesë rreth realizimit të së njëjtës

Parashtrues neni 152 parag.1 i LDF-së:

- fëmija-viktimë,
- prindi i tij,
- kujdestari i tij

Gjykata e dorëzon vendimin përfundimtar për pagesë të dëmshpërblimit te Ministria e Drejtësisë neni 152 parag. 4 i LDF-së

### KËRKESA E REFUZUAR NENI

152 parag.3 i LDF-së

### ANKESË

deri te Gjykata e Apelit në afat prej 8 ditëve


Pagesa e dëmshpërblimit të fëmijës-viktimë nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë

Nëse dëmshpërblimi është i paguar nga mjetet e nenit 151 parag.1 të LDF-së, gjykata e dorëzon vendimin te Avokati i Shtetit neni 152 parag.6 i LDF-së

Jo më vonë se një muaj nga pagesa e realizuar e njofton gjykatën se kush e ka nxjerr vendimin

Ngritja e procedurës për realizim të detyrueshëm nga pasuria e autorit të veprës neni 152 parag. 6 i LDF-së

# VEPRIMI I GJYKATËS ME FËMIJËN VIKTIMË







# SHTOJCA 1 – STANDARDE RELEVANTE NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE PËR MBROJTJE TË FËMIJËVE-VIKTIMË

## A. STANDARDE NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

### 1. Deklarata e OKB-së për të Drejtat e Njeriut - 1948

Deklarata i definojnë të gjitha të drejtat themelore të cilat i kanë të gjitha qeniet njerëzore, pa asnjë diskriminim. E njëjta, kishte një ndikim të madh dhe paraqet bazë për miratimin e shumë instrumenteve, standardeve dhe udhëzimeve tjera në sferën e të drejtave të njeriut.

### 2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut - 1950

Identifikon të drejtat dhe liritë e patjetërsueshme që i gëzon çdo person dhe i detyron shtetet nënshkruese t'i garantojnë dhe mbrojnë këto të drejta, pa asnjë diskriminim. Me të njëjtën, janë miratuar edhe 14 protokolle me të cilat ndryshohen disa nga nenet origjinale ose shtohen disa të drejta shtesë dhe masa sigurie. Për shkeljen e të drejtave të cilat janë të garantuara me Konventë, kompetent është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndërsa çdo individ (duke përfshirë edhe fëmijën), para të njëjtës mund të paraqesin padi kundër shtetit përkatës nënshkrues, duke përmendur llojin e shkeljes së të drejtës e cila është e garantuar me Konventë.

### **3. Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Trajtimit Mizer, Çnjerëzor dhe Poshtëruar - 1984 (së bashku me Protokollin Fakultativ të vitit 2002)**

Konventa kundër torturës parashikon ndalimin e torturës, pa marrë parasysh kushtet dhe i detyron shtetet nënshkruese të ndërmarrin masa për të parandaluar çfarëdo torture apo ndonjë trajtim tjetër mizer, çnjerëzor ose poshtëruar.

Konventa kërkon nga shtetet që t'i hetojnë dhe ndjekin penalisht të gjitha rastet e pretenduara të torturës dhe të ofrojnë trajnim për parandalimin e torturës për të gjithë anëtarët e organeve të zbatimit të ligjit dhe ushtrinë. Parashikon krijimin e një Komiteti për luftë kundër torturës, i cili bën monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të Konventës dhe kërkon nga shtetet raportim të rregullt lidhur me zbatimin e saj. Me Protokollin Fakultativ është parashikuar krijimi i mekanizmave preventivë nacional për parandalimin e torturës, të ngarkuar edhe për vizitën e vendeve ku personat mbahen në paraburgim, si dhe për pranimin e të gjitha ankesave lidhur me rastet e pretenduara të torturës dhe hetimi adekuat i të njëjtëve. I njëjti, parasheh edhe ekzistimin e Nënkomitetit për parandalimin e torturës, i cili ka të drejtë të kryejë vizita në të gjitha vendet ku ka të paraburgosur ose persona të burgosur në vendet nënshkruese.

### **4. Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruar - 1987**

Në bazë të nenit 3 të KEDNJ-së, Konventa më tej forcon mbrojtjen e njerëzve nga tortura eventuale, trajtimeve çnjerëzore dhe poshtëruar ose të ndëshkimit dhe e themelon Komitetin Evropian kundër Torturës (KET) i cili ka autorizim të vizitojë vendet ku ka të paraburgosur ose të burgosur dhe të paraqesë raporte te shtetet nënshkruese për rezultatet dhe konkluzionet e tyre.

### **5. Konventa për të Drejtat e Fëmijës - 1989**

KDF-ja është konventë e pranuar gjerësisht, e ratifikuar nga të gjitha vendet e botës, përveç dy vendeve. Ajo ofron një spektër të gjerë të të drejtave të fëmijëve dhe i detyron shtetet nënshkruese që i mbrojnë të njëjtat. Shtetet janë të detyruara rregullisht të dorëzojnë raporte lidhur me zbatimin e këtyre të drejtave deri te Komisioni për të drejtat e fëmijës, i cili, mandej, përpilon rekomandime lidhur me gjendjen faktike rreth këtyre të drejtave në atë vend. Komisioni për të drejtat e fëmijëve ka hartuar 17 “Komente të Përgjithshme” shtesë të cilat përmbajnë interpretime më të detajuara për disa të drejta të fëmijëve të përfshira në Konventë. Nga ato, “Komenti i Përgjithshëm” numër 10 (2007) ka të bëjë me të drejtat në drejtësinë e të miturve.

### **6. Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës lidhur me drejtësinë sipas masave të fëmijëve 2010**

Janë vendosur rekomandime për trajtim dhe masa të cilat duhet të aplikohen për mbrojtje të të drejtave të gjithë fëmijëve që vijnë në kontakt me sistemet e drejtësisë në cilësinë e kryerësit, viktimës, dëshmitarit ose personave të tretë në procedurë ( për shembull, në raste të kujdestarisë).

Ato përmbajnë parime të përgjithshme dhe rekomandime specifike për çdo fazë të veçantë të procesit gjyqësor.



## **5. DREJTËSIA PENALE**

### **1. Rregullat Minimale të OKB-së mbi Standardet e Trajtimi të Personave të Burgosur - 1955**

Pakoja e rregullave që i përcaktojnë parimet e definuara nëpërmjet të cilave sigurohet që, personat e privuar nga liria të trajtohen në mënyrë humane duke e respektuar dinjitetin e tyre.

### **2. Kodeksi i sjelljes së zyrtarëve të cilët e zbatojnë ligjin -1979**

Rregulla me të cilat personat zyrtar të organeve zbatojnë ligjin dhe i plotësojnë detyrimet e tyre në punë në një mënyrë humane dhe i respektojnë të drejtat e njeriut të cilët vijnë në një kontakt të drejtpërdrejtë me to.

### **3. Rregulla Minimale të OKB-së mbi Standardet e Zbatimit të të Drejtave të Miturve (Rregullat e Pekinit -1985)**

Grupi i parimeve që lidhen me zbatimin e drejtësisë së të miturve, duke përfshi edhe çështjet, siç janë gjykatat për të mitur, moshë e përgjegjësisë penale, ndjekja penale e të miturve, politikat ndëshkuese dhe standardet për të mitur në rast se janë të burgosur.

### **4. Rekomandimet e OKB-së për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve (Udhëzimet e Riadit 1990)**

I definon standardet për parandalimin e delikuencës së të miturve duke përfshirë edhe mbrojtjen e fëmijëve të cilët konsiderohen si rrezik nga delikuenca e të miturve si dhe masat që duhet të zbatohen për eliminimin e këtyre rreziqeve. Udhëzimet e avancojnë rolin që duhet ta kenë sektorët e ndryshëm shoqëror, si për shembull, familja, bashkësia, mediumet dhe sistemi arsimor, në raport me parandalimin e delikuencës në mesin e të rinjve që janë në rrezik.

### **5. Rregullat e OKB-së për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria (Rregullat e Havanës-1990)**

Set i parimeve që vlejné për të gjithë të miturit e privuar nga liria, në cilindo institucion, me të cilat sigurohet zhvillimi dhe mirëqenia e tyre. Këto rregulla përcaktojnë standardet për kushtet materiale në rast të privimit nga liria, për mbrojtjen e të miturve derisa ata janë në paraburgim ose vuajnë dënimin me burg, si dhe programet arsimore, profesionale dhe të punës.

### **6. Rregullat Standarde Minimale të OKB-së për Masa Jashtë Institucionale (Rregullat e Tokios-1990)**

Grup rregullash me të cilat rregullohet zbatimi i dënimeve jashtë institucionale, masat e sigurisë dhe garancitë të cilat duhet të ekzistojnë për personat të cilëve do t'iu shqiptohet një masë e tillë.

### **7. Udhëzime për trajtimin e fëmijëve në kuadër të sistemit penal - 1997**

Udhëzime se si duhet të zbatohen parimet e Konventës për të drejtat e fëmijës dhe standardet tjera ndërkombëtare që kanë të bëjnë me zbatimin e drejtësisë për të mitur. (të përmendura më lartë).

## 8. Parimet bazë të OKB-së për përdorimin e programeve për drejtësinë restorative në sferën penale - 2002

Këto parime kanë të bëjnë me përdorimin e parimeve të programeve për drejtësinë restorative, për atë kur të njëjtat duhet të përdoren në kuadër të sistemit penal, si ato funksionojnë dhe kush duhet të jetë i përfshirë.

## 9. Rregulla të OKB-së për trajtimin e të burgosurve femra dhe masat jashtë institucionale për kryerësit femra (Rregullat e Bangkokut-2010)

I përmbushin dhe i tejkalojnë rregullat minimale Standarde për trajtimin e të burgosurve me qëllim për të siguruar përmbushjen adekuatë të të drejtave të femrave dhe përmbushjen e nevojave të tyre.

## B. VIKTIMAT DHE DËSHMITARËT

### 1. Deklarata e parimeve bazë të drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimi i fuqisë dhe autoritet zyrtar - 1998

Propozon dhe promovon masa konkrete të cilat duhet të ndërmerren me qëllim të garantimit të të drejtave të viktimave dhe të përmirësohet qasja e tyre deri te drejtësia, ndihma sociale, dëmshpërblimi dhe kompensimi.

### 2. Udhëzime të OKB-së për drejtësi në situata në të cilat kemi të bëjmë me fëmijët-viktimë dhe dëshmitar të krimit - 2005

Udhëzimet për trajtim të fëmijëve-viktimë dhe dëshmitarëve të krimit, të drejtat e tyre dhe masat të duhet ndërmarrë për të siguruar përmbushjen e të drejtave të tilla dhe mbrojtjen e fëmijëve nga çdo vuajtje gjatë procesit gjyqësor.

Gjithashtu, nga instrumentet ndërkombëtare të rëndësishme për fëmijët-viktimë të veprave penale janë:

- Mbrojtja e dëshmitarëve dhe viktimave udhëzimet EKO SOS – Rezoluta 2004/27- Udhëzime për çështje të drejtësisë të cilat përfshijnë fëmijët-viktimë dhe dëshmitarët e veprave penale .
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec (2006) 8 Komiteti i Ministrave nga vendet anëtare për ndihmë të viktimave të krimit.
- Protokoll i Fakultativ i Konventës për të drejtat e fëmijëve në lidhje me përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura.
- Protokoll i Fakultativ i Konventës për të drejtat e fëmijëve në lidhje shpërndarjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve.
- Protokoll për parandalimin, çrrenjosjen dhe dënimin e tregtisë me njerëz, posaçërisht tregtisë me femra dhe fëmijë, me çka plotësohet Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar.
- Konventa për mbrojtjen e fëmijëve nga eksploatimi seksual dhe abuzimit seksual.
- Udhëzime të Këshillit të Evropës për drejtësi miqësore për fëmijët- 2010.



Për fat të keq, deri më sot nuk është miratuar asnjë instrument ndërkombëtar me një detyrim-juridik që është në fuqi i cili ka të bëjë apostafat me të drejtat e fëmijëve-viktimë dhe dëshmitarëve.

Në vitin 1989 u miratua Konventa për të drejtat e fëmijës. . Neni 3 parasheh që gjatë ndërmarrjes të çfarëdo veprimesh që kanë të bëjnë me fëmijët duhet pasur shqetësim primar për interesat e fëmijëve. Është e patjetërsueshme të sigurohen kushte dhe kapacitete në sferën e sigurisë, shëndetit, duhet pasur numër të mjaftueshëm të personelit, si dhe mbikëqyrje kompetente. Neni 39 parasheh marrjen e masave për avancimin e rehabilitimit psikofizik dhe reintegrim social të fëmijëve-viktimë nga neglizhenca, abuzimi, tortura, trajtimi çnjerëzor dhe poshtërimi.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga viti 1950, në nenin 6 sugjerohet që jo detyrimisht të publikohen aktgjykimet kur në proceset gjyqësore janë të përfshirë fëmijët. Konventa Evropiane për realizimin e të drejtave të fëmijëve nga viti 1996 i siguron të drejtat: këshillimit, mundësia e shprehjes së pikëpamjeve personale dhe njohja me pasojat e mundshme nga ato shprehje, si dhe pasojat e mundshme nga çfarëdo vendimi (neni 3). Neni 5 parasheh të drejtën e asistencës nga ana e personit adekuat me përzgjedhjen e fëmijës i cili do t'i ndihmonte të shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e veta.

Disa nga parimet në të cilat bazohet Karta Sociale Evropiane e Rishikuar e vitit 1996 ka të bëjë me detyrimin nga mbrojtja e rreziqeve fizike dhe morale në të cilat janë të ekspozuar fëmijët, si dhe të drejtat e mbrojtjes sociale, juridike dhe ekonomike.

Në vitin 2012, BE-ja miratoi Direktivën për vendosjen e minimum standardeve për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave nga veprat penale. Direktiva i përmban zgjidhjet nga instrumentet e analizuara ndërkombëtare paraprake, por vendos edhe risi.

Për shembull, në nenin 23 dhe 24 thuhet se: të gjitha bisedat e zhvilluara duhet t'i bëjë një person, ndalohen pyetje të cilat kanë të bëjnë me jetën private të fëmijës, incizimet audio-vizuale mund të përdoren në cilëndo bisedë, si dhe në raste kur nuk mund të konstatohet se a është pala fëmijë, nëse ekzistojnë baza për të besuar se është fëmijë, atëherë pala të konsiderohet si fëmijë.



## **PJESA E DYTË**

# **LISTA E HAPAVE PËR VEPRIM TË POLICISË DHE PROKURORIT PUBLIK ME FËMIJËN-VIKTIMË**





# LISTA OPERATIVE E HAPAVE PËR VEPRIM ME FËMIJËT VIKTIMA

## PYETJE

PO

JO

VËREJTJE

1

### PARAQITJA E NGJARJES

Ngjarja juridiko-penale ka ndodhur më data/muaji/viti në ora \_\_\_\_\_, (rruga, numri, vendi, komuna).

Kush e ka paraqitur ngjarjen juridiko-penale?

- familja
- prindi
  - babai
  - nëna
  - vëllai / motra
  - gjyshja / gjyshi
  - farefis tjetër \_\_\_\_\_ (thekso)
- tutori
- fëmija viktimë
- fqinjët
- dëshmitari / dëshmitari okular
- thirrje telefonike
  - anonime
  - e legjitimuar (cili person)
- e zbuluar personalisht nga zyrtari policor
- institucioni
  - tregojeni institucionin
- persona të tjerë juridikë
  - tregoni kush (cili)
- burime të tjera (theksoni burimin) \_\_\_\_\_.

2

## EVIDENTIMI DHE INFORMIMI PËR VEPËR JURIDIKO-PENALE, NË TË CILËN KA FËMIJË VIKTIMË TË VEPRËS PENALE

Informimi për fëmijën viktimë është shënuar në evidencat zyrtare të MPB-së:

- në librin për ngjarjet e ditës
- është hartuar shënim zyrtar
- është hartuar proces verbal për pranimit të kallëzimit penal
- është hartuar proces verbal për paraqitje të ngjarjes
- është evidentuar intervenimi
- është evidentuar ankesa
- është kontrolluar regjistri i analitikës – regjistrimi i padisë penale dhe veprës penale në regjistrin e analitikës.

Gjatë raportimit të ngjarjes dhe pranimit të paraqitjes, gjegjësisht informimit për fëmijën viktimë, zyrtari kujdestar policor menjëherë e informon:

- inspektorin për fëmijë
- prokurorin publik përkatës
- udhëheqësin e ndërrimit
- zyrtarin policor për pranimit
- qendrën kompetente për punë sociale

3

## VEPRIMI PAS PARAQITJES SË NGJARJES

Dalja në vendin e ngjarjes pas paraqitjes së ngjarjes:

- pa prolongim menjëherë është bërë dalja në vendin e ngjarjes
- është konstatuar nevoja se duhet të dilet në vendin e ngjarjes në afat prej \_\_\_\_
- nuk është dalë në vendin e ngjarjes
- zyrtari kujdestar policor, udhëheqësi i ndërrimit ose zyrtari për pranimit e informon prokurorin publik për nevojën e daljes në vendin e ngjarjes
- zyrtari kujdestar policor, udhëheqësi i ndërrimit ose zyrtari për pranimit e informon Qendrën për Punë Sociale (QPS)

- së bashku me prokurorin publik është dalë në vendin e ngjarjes
- së bashku me QPS-në është bërë dalja në vendin e ngjarjes
- Prokurori publik nuk ka dalë në vendin e ngjarjes
- QPS-ja nuk ka dalë në vendin e ngjarjes

Pas raportimit të ngjarjes dhe pas pranimit të paraqitjes, gjegjësisht informimit të prokurorit publik dhe QPS-së për fëmijën viktimë:

- Prokurori publik menjëherë ka arritur në stacionin policor / vendin e paraqitjes së ngjarjes
- Prokurori publik ka dhënë udhëzim për procesimin e lëndës në mungesë të tij
- Përfaqësues i QPS-së menjëherë ka arritur në stacionin policor / vendin e paraqitjes së ngjarjes
- Përfaqësues i QPS-së ka dhënë udhëzim për procesimin të lëndës në mungesë të tij

## 4

#### PROFESIONALIZMI GJATË VEPRIMIT

- posedojnë dituri dhe përvoja të posaçme gjatë punës me fëmijën viktimë
- profesionistë tjerë që kanë qenë në punë

## 5

#### PËRDORIMI I GJUHËS AMTARE NË KUADËR TË PROCEDURËS

Në procedurën policore fëmijës viktimë:

- i sigurohet e drejta për të biseduar në gjuhën amtare përmes sigurimit të përkthyesit
- nuk i është mundësuar e drejta për të biseduar në gjuhën amtare për shkak:
  - të pamundësisë për të gjetur përkthyes
  - për arsye të tjera \_\_\_\_\_ (shkruaj cila)

## 6

#### VEPRIMI EMERGJENT

Është përgatitur raport policor:

- menjëherë
- në afat prej 12-orësh që nga intervenimi
- nuk është përgatitur raport policor

Përgatitja e kallëzimit penal:

- në afat sa më të shkurtër prej \_\_\_\_\_ është përgatitur kallëzimi penal
- për shkak të ndërlikueshmërisë së lëndës kallëzimi penal është përgatitur në afat prej \_\_\_\_\_ (shkruajeni afatin

## 7

## PROCESI I MBROJTJES SË FËMIJËS VIKTIMË TË VEPRËS PENALE

Nevojitet proces i posaçëm i mbrojtjes:

- Konstatohet nevoja e një procesi të veçantë të mbrojtjes
- Nuk konstatohet nevoja për proces të veçantë të mbrojtjes
- Nuk ka nevojë për proces të veçantë të mbrojtjes
- Fëmijës viktimë i është mësuar e drejta për mbrojtje të veçantë
- Fëmijës viktimë nuk i është mësuar e drejta për mbrojtje të veçantë
- Fëmijës viktimë në këtë rast nuk ka nevojë t'i mësohet e drejta e procesit të veçantë të mbrojtjes
- Menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej 12-orësh, deri të gjykata kompetente dorëzohet propozim për shqiptim të masës së përkohshme të mbrojtjes

Në rast të lëndëve të dhunës familjare, janë ndërmarrë masa të posaçme:

- janë ndërmarrë masa për mbrojtje të viktimave të dhunës familjare
- nuk janë ndërmarrë masa për mbrojtje të viktimave të dhunës familjare
- është informuar viktimja për të drejtën e dorëzimit të propozimit deri të gjykata për Masë të përkohshme për mbrojtje nga dhuna familjare
- nuk është informuar viktimja për të drejtën e dorëzimit të propozimit deri të gjykata për Masë të përkohshme për mbrojtje nga dhuna familjare

## 8

## VENDI I NGJARJES DHE SIGURIMI I DËSHMIVE

Në vendin e ngjarjes është:

- gjetur autori i veprës penale
- nuk është gjetur autori i veprës penale
- janë gjetur persona të lënduar
- nuk janë gjetur persona të lënduar

Sigurimi i informatave:

- janë siguruar informacione të nevojshme dhe të domosdoshme për ngjarjen
- janë siguruar informacione të nevojshme dhe të domosdoshme për autorin e veprës
- janë siguruar informacione të nevojshme dhe të domosdoshme për viktimën
- janë siguruar informacione të nevojshme dhe të domosdoshme për dëshmitarët

Janë marrë deklaratat nga:

- viktimat
- autorin e veprës
- dëshmitarët
- persona të tjerë, tregoni se cilët janë ata \_\_\_\_\_?

Sigurimi i materialit dëshmuar:

- sigurimi i vendit të ngjarjes
- sigurimi i materialit dëshmuar
- është kryer hetimi
- marrja e materialit dëshmuar
- konsultimi me prokurorin publik
- marrja e përkohshme e gjësendeve
- të dhënat, materialet e nevojshme dhe dëshmitë relevante grumbullohen në koordinim me QPS-në

Marrja e gjësendeve, me të cilat është kryer vepra penale:

- përkohësisht i merret arma e autorit të veprës
- inicohet procedurë për marrje të lejes për armë

Personi, i cili dyshohet së është autor i veprës është:

- arrestuar (privuar nga liria)
- nuk është arrestuar (nuk është privuar nga liria)
- është ndaluar në stacion policor
- është në arrati

9

## VLERËSIMI I RREZIKUT/GJENDJES SË FËMIJËS VIKTIMË TË VEPRËS PENALE

Për fëmijën viktimë të veprës penale:

- Policia menjëherë koordinohet me QPS-në dhe e informon në lidhje me ngjarjen, që të mund të sigurojë mbrojtje të domosdoshme për fëmijën viktimë
- Vlerësimi i rrezikut dhe plani për shpëtim është përgatitur para intervenimit për shpëtim të fëmijës viktimë
- Vlerësimi është bërë së bashku me Qendrën për Punë Sociale
- Sigurohet mbrojtje adekuate shëndetësore
- Nuk ka nevojë për mbrojtje të veçantë shëndetësore
- Është kontrolluar nga nëpunësi shëndetësor dhe enti shëndetësor
- Fëmija është dërguar deri te spitali ose te qendra më e afërt mjekësore
- Është bërë kontrollimi i gjendjes fizike dhe psikike të fëmijës
- Është ofruar trajtim tjetër mjekësor për fëmijën viktimë (tregoni nga kush)
- Është siguruar dokumentacioni adekuat mjekësor

10

## RREGULLAT E PROCESIMIT

Përgatitja e dokumentacionit me shkrim dhe evidentimi:

- është përgatitur shënim zyrtar
- është përgatitur proces-verbal
- konstatimet mjekësore dhe dokumentet tjera, që kanë të bëjnë me ngjarjen, janë dërguar në prokurori
- është evidentuar marrja në pyetje dhe deklaratat e viktimës

- është bërë video-xhirim me informim paraprak dhe me pajtim të viktimës
- bisedën me fëmijën e zhvillon zyrtari policor, i cili ka ndjekur trajnim adekuat për punë në rastet që kanë të bëjnë me viktimizimin e fëmijës

Rregullat e procesimit:

- fëmija viktimë është i ndarë nga autori i veprës
- fëmija viktimë është i ndarë nga autori i veprës, i cili është gjithashtu fëmijë,
- shfrytëzohet transporti i veçantë
- shfrytëzohen hapësira të posaçme për pritje
- shfrytëzohen hapësirat e posaçme në të cilat zhvillohet biseda zyrtare
- respektohet e drejta e privatësisë së fëmijës

11

## RREGULLAT PËR ZHVILLIM TË BISEDËS ME FËMIJËN VIKTIMË

Para se të fillohet biseda, fëmijës viktimë i mësohen:

- Të drejtat për mbrojtje të veçantë në proces
- E drejta për përdorimin e gjuhës amtare
- E drejta për mbrojtës sipas detyrës zyrtare
- E drejta për ndihmë juridike nga avokati para dhënies së deklaratës, gjegjësisht e drejta për dorëzim të deklaratës ose dorëzimi i kërkesës juridiko-pronësore,
- E drejta për kompensim të dëmit material dhe jomaterial në pajtim me programin e nenin 151 të Ligjit për të drejtat e fëmijëve (LDP), nën kushte dhe mënyra të përcaktuara me nenin 152 të LDP-së – nëse kompensimi i dëmit nuk mund të sigurohet nga personi i dënuar
- Për të drejtën e dorëzimit të propozimit deri te gjykata për shqiptim të Masës së përkohshme për mbrojtje nga dhuna familjare
- shërbimet shëndetësore, psikologjike, sociale, që janë në dispozicion, si dhe mënyrat e qasjes në ato shërbime

Si është zhvilluar biseda?

- në hapësirë të specializuar / të posaçme, të përshtatshme për punë me fëmijë,

- në banesë, ku banon fëmija,
- në vendin e ngjarjes,
- në vend tjetër \_\_\_\_\_ (theksoni ku)

Hapësira për punë me fëmijë viktime:

- ka izolim të zërit,
- është e pajisur me mjete të posaçme vizuale-auditive, me pajisje teknike për komunikim, me kamerë / për incizim të bisedës (e tërë dhoma – sjellja e fëmijës dhe reagimet), mikrofon / për xhirim të zërit, audio dhe video-pajisjet (VHC shirita, DVD),
- garanton siguri fizike dhe mendore të fëmijës viktimë,
- është e ilustruar me ngjyra,
- është e pajisur me materiale dhe pajisje të dobishme për mbledhjen e informacioneve nga fëmija viktimë (lapsa me ngjyra, letra, kukulla, etj.)

Kur është zhvilluar biseda?

- menjëherë pas ngjarjes,
- \_\_\_\_\_ orë pas ngjarjes,
- pas disa ditësh
- pas disa javësh

Biseda me fëmijën viktimë është zhvilluar?

- në prani të prokurorit publik përkatës,
- në prani të personit profesionist të QPS-së,
- në prani të prindërit,
- në prani të avokatit

Sa herë është zhvilluar biseda?

- një herë, në detaje dhe me përpikëri, pas përgatitjes së mirë paraprake,
- dy herë, për shkak se \_\_\_\_\_
- disa herë (theksoni sa herë) \_\_\_\_\_

Biseda me prindërit:

- biseda është zhvilluar me një prind (tutor),
  - nënën,
  - babanë

- biseda është zhvilluar me të dy prindërit,
- biseda e përbashkët me fëmijën dhe prindin.
- biseda e veçantë me prindin

Pas përfundimit të procedurës në polici, përgatitja e kallëzimit penal është bërë:

- në afat sa më të shkurtër prej \_\_\_\_\_ dhe është hartuar kallëzimi penal
- për shkak të ndërlikueshmërisë së lëndës kallëzimi penal përgatitet në afat prej \_\_\_\_\_ (shënojeni afatin)
- sigurohen dëshmi materiale së bashku me kallëzimin
- bëhet konsultim me Prokurorinë Themelore Publike (PTHP)
- është dorëzuar kallëzim penal për evidentim dhe përpunim deri te Reparti për Analizë Kriminalistike dhe Kundërzbulim
- është dorëzuar kallëzim penal deri te PTHP

## 12

## KOORDINIMI DHE BASHKËPUNIMI PËR REALIZIMIN E NGJARJES

Zyrtarët policorë – inspektori për fëmijë dhe dukuri sociopatologjike:

- kanë bashkëpunuar me të gjitha institucionet kompetente
- nuk kanë bashkëpunuar me të gjitha institucionet kompetente \_\_\_\_\_ tregoni me cilat
- kanë marrë pjesë në ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve të institucioneve përkatëse në funksion të interesit më të mirë të fëmijës, pavarësisht nëse fëmija është në rrezik, nëse është viktimë ose autor i veprës penale ose i kundërvajtjes
- nuk kanë marrë pjesë në marrjen e masave dhe aktiviteteve të institucioneve kompetente në funksion të interesit më të mirë të fëmijës
- Tregoni shkaqet pse nuk kanë marrë pjesë \_\_\_\_\_
- наведете ги причините зошто не учествувале \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

Zyrtari policor përgjegjës: \_\_\_\_\_

Kryeshefi i SPB-së: \_\_\_\_\_



# LISTA OPERATIVE E HAPAVE PËR VEPRIM ME FËMIJËT-VIKTIMA

PYETJE

PO

JO

VËREJTJE

1

## PARAQITJA E NGJARJES

Kush e ka paraqitur ngjarjen juridiko-penale?

- folicia/kallëzim penal
- familja
- prindi
  - babai
  - nëna
  - vëllai / motra
  - gjyshja / gjyshi
  - farefis tjetër \_\_\_\_\_ (thekso)
- tutori
- fëmija viktimë
- fqinjët
- dëshmitari / dëshmitari okular
- thirrje telefonike
  - anonime
  - e legjitimuar (cili person)
- e zbuluar personalisht nga zyrtari policor
- institucioni
  - tregojeni institucionin
- persona të tjerë juridikë
  - tregoni kush (cili)
- burime të tjera (theksoni burimin) \_\_\_\_\_.

2

## EVIDENTIMI DHE INFORMIMI PËR VEPËR JURIDIKO-PENALE, NË TË CILËN KA FËMIJË VIKTIMË TË VEPRËS PENALE

Informimi për fëmijën viktimë është shënuar në evidencat zyrtare të prokurorisë publike:

- në regjistrin për padi penale (PP) kur autori i veprës penale është qytetar i rritur,
- në regjistrin për padi penale për fëmijë (PPF), kur autori i veprës penale është qytetar i mitur.

Pas paraqitjes së ngjarjes dhe pranimit të kallëzimit prokurori publik menjëherë e informon:

- qendrën kompetente për punë sociale.

3

## VEPRIMI PAS PARAQITJES SË NGJARJES

Dalja në vendin e ngjarjes pas paraqitjes së ngjarjes:

- prokurori publik së bashku me policinë del në vendin e ngjarjes
- në vendin e ngjarjes ftohet edhe QPS-ja
- prokurori publik konstaton se nuk ka nevojë të dilet në vendin e ngjarjes
- QPS-ja nuk del në vendin e ngjarjes.

Pas pranimit të kallëzimit, prokurori publik dhe QOPS-ja:

- prokurori publik menjëherë ka arritur në stacionin policor / vendin e paraqitjes së ngjarjes
- prokurori publik ka dhënë udhëzim për procesimin e lëndës në mungesë të tij
- përfaqësues i qps-së menjëherë ka arritur në stacionin policor / vendin e paraqitjes së ngjarjes
- përfaqësues i QPS-së ka dhënë udhëzim për procesimin të lëndës në mungesë të tij.

4

## PËRDORIMI I GJUHËS AMTARE NË KUADËR TË PROCEDURËS

Në procedurën policore fëmijës viktimë:

- i sigurohet e drejta për të biseduar në gjuhën amtare përmes sigurimit të përkthyesit
- nuk i është mundësuar e drejta për të biseduar në gjuhën amtare për shkak:
  - të pamundësisë për të gjetur përkthyes
  - për arsye të tjera \_\_\_\_\_ (shkruaj cilat)

## 5

**VEPRIMI EMERGJENT**

Është përgatitur padia:

- menjëherë,
- në afat prej \_\_\_\_\_ ditësh nga pranimi i kallëzimit
- nuk është përgatitur padia

## 6

**NEVOJA E PROCESIT TË MBROJTJES SË FËMIJËS VIKTIMË TË VEPRËS PENALE**

Nevojitet proces i posaçëm i mbrojtjes:

- konstatohet nevoja e një procesi të veçantë të mbrojtjes
- nuk konstatohet nevoja për proces të veçantë të mbrojtjes
- Nuk ka nevojë për proces të veçantë të mbrojtjes
- Fëmijës viktimë i mësohet e drejta për mbrojtje të veçantë
- Fëmijës viktimë nuk i mësohet e drejta për mbrojtje të veçantë
- Fëmijës viktimë në këtë rast nuk i mësohet e drejta e procesit të veçantë të mbrojtjes
- Menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej 12-orësh, deri te gjykata kompetente dorëzohet propozim për shqiptim të masës së përkohshme të mbrojtjes.

Në rast të lëndëve të dhunës familjare:

- ndërmerren masa për mbrojtje të viktimave të dhunës familjare
- nuk ndërmerren masa për mbrojtje të viktimave të dhunës familjare
- informohet viktimja për të drejtën e dorëzimit të propozimit deri të gjykata për masë të përkohshme për mbrojtje nga dhuna familjare

- nuk informohet viktimi për të drejtën e dorëzimit të propozimit deri të gjykata për masë të përkohshme për mbrojtje nga dhuna familjare.

## 7

## SIGURIMI I DËSHMIVE

Sigurimi i informatave:

- sigurohen informacione të nevojshme dhe të domosdoshme për ngjarjen
- sigurohen informacione të nevojshme dhe të domosdoshme për autorin e veprës penale
- sigurohen informacione të nevojshme dhe të domosdoshme për viktimën
- sigurohen informacione të nevojshme dhe të domosdoshme për dëshmitarët.

Merren deklarata nga:

- viktimi
- autori i veprës
- dëshmitarët
- persona të tjerë, tregoni se cilët janë ata \_\_\_\_\_?

Sigurimi i materialit dëshmues:

- sigurimi i vendit të ngjarjes
- sigurimi i materialit dëshmues
- kryhet hetimi
- marrja e materialit dëshmues
- marrja e përkohshme e gjësendeve
- të dhënat, materialet e nevojshme dhe dëshmitë relevante grumbullohen në koordinim me QPS-në.

Marrja e gjësendeve, me të cilat është kryer vepra penale:

- përkohësisht i merret arma e autorit të veprës
- iniciohet procedurë për marrje të lejes për armë.

Personi, i cili dyshohet së është autor i veprës penale:

- arrestuar (privuar nga liria)
- nuk është arrestuar (nuk është privuar nga liria)

- është ndaluar në stacion policor
- është në arrati

## 8

## VLERËSIMI I RREZIKUT/GJENDJES SË FËMIJËS VIKTIMË TË VEPRËS PENALE

Për fëmijën viktimë të veprës penale:

- Prokurori menjëherë koordinohet me QPS-në dhe e informon në lidhje me ngjarjen, që të mund të sigurojë mbrojtje të domosdoshme për fëmijën viktimë
- Vlerësimi i rrezikut dhe plani për shpëtim është përgatitur para intervenimit për shpëtim të fëmijës viktimë
- Vlerësimi është bërë së bashku me Qendrën për Punë Sociale
- Sigurohet mbrojtje adekuate shëndetësore
- Nuk ka nevojë për mbrojtje të veçantë shëndetësore
- Është kontrolluar nga nëpunësi shëndetësor dhe enti shëndetësor
- Fëmija është dërguar deri te spitali ose te qendra më e afërt mjekësore
- Është bërë kontrollimi i gjendjes fizike dhe psikike të fëmijës
- Është ofruar trajtim tjetër mjekësor për fëmijën viktimë (tregoni nga kush)
- Është siguruar dokumentacioni adekuat mjekësor

## 9

## RREGULLAT E PROCESIMIT

Përgatitja e dokumentacionit me shkrim dhe evidentimi:

- është përgatitur proces-verbal
- konstatimet mjekësore dhe dokumentet tjera, që kanë të bëjnë me ngjarjen, janë dërguar në prokurori
- është evidentuar marrja në pyetje dhe deklaratat e viktimës
- është bërë video-xhirim me informim paraprak dhe me pajtim të viktimës
- bisedën me fëmijën e zhvillon prokurori publik, i cili ka ndjekur trajnim adekuat për punë në rastet që kanë të bëjnë me viktimizimin e fëmijës.

Rregullat e procesimit:

- fëmija viktimë është i ndarë nga autori i veprës
- fëmija viktimë është i ndarë nga autori i veprës, i cili është gjithashtu fëmijë,
- shfrytëzohet transporti i veçantë
- shfrytëzohen hapësira të posaçme për pritje
- shfrytëzohen hapësirat e posaçme në të cilat zhvillohet biseda zyrtare
- respektohet e drejta e privatësisë së fëmijës

10

## RREGULLAT PËR ZHVILLIM TË BISEDËS ME FËMIJËN VIKTIMË

Para se të fillohet biseda, fëmijës viktimë i mësohen:

- të drejtat për mbrojtje të veçantë në proces
- e drejta për përdorimin e gjuhës amtare
- e drejta për mbrojtës sipas detyrës zyrtare
- e drejta për ndihmë juridike nga avokati para dhënies së deklaratës, gjegjësisht e drejta për dorëzim të deklaratës ose dorëzimi i kërkesës juridiko-pronësore,
- e drejta për kompensim të dëmit material dhe jomaterial në pajtim me programin e nenin 151 të Ligjit për të drejtat e fëmijëve (LDP), nën kushte dhe mënyra të përcaktuara me nenin 152 të LDP-së, nëse kompensimi i dëmit nuk mund të sigurohet nga personi i dënuar
- e drejta e dorëzimit të propozimit deri te gjykata për shqiptim të masës së përkohshme për mbrojtje nga dhuna familjare
- shërbimet shëndetësore, psikologjike, sociale, që janë në dispozicion, si dhe mënyrat e qasjes në ato shërbime

Si është zhvilluar biseda?

- në hapësirë të specializuar / të posaçme, të përshtatshme për punë me fëmijë,
- në banesë, ku banon fëmija,
- në vendin e ngjarjes,
- në vend tjetër \_\_\_\_\_ (theksoni ku)

Kur është zhvilluar biseda?

- menjëherë pas ngjarjes,
- \_\_\_\_ orë pas ngjarjes,
- pas disa ditësh
- pas disa javësh

Biseda me fëmijën viktimë është zhvilluar?

- në prani të personit profesionist të QPS-së,
- në prani të prindërit,
- në prani të avokatit
- pa prani të avokatit

Sa herë është zhvilluar biseda?

- një herë, në detaje dhe me përpikëri, pas përgatitjes së mirë paraprake,
- dy herë, për shkak se \_\_\_\_\_
- disa herë (theksoni sa herë) \_\_\_\_\_

Biseda me prindërit?

- biseda është zhvilluar me një prind (tutor)
- biseda është zhvilluar me të dy prindërit,
- biseda e përbashkët me fëmijën dhe prindin.
- biseda e veçantë me prindin

Pas përfundimit të bisedës me fëmijën-viktimë, atij:

- i mësohet procedura për marrëveshje me të pandehurin
- nuk i mësohet se ka mundësi që prokurori publik të merret vesh me të pandehurin
- i mësohet mundësia e procedurës së ndërmjetësimit
- nuk i mësohet mundësia e procedurës së ndërmjetësimit

11

## KOORDINIMI DHE BASHKËPUNIMI PËR REALIZIMIN E NGJARJES

Prokuroria publike:

- bashkëpunuar me të gjitha institucionet kompetente
- merr pjesë në ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve të institucioneve përkatëse në funksion të interesit më të mirë të fëmijës, pavarësisht nëse fëmija është në rrezik, nëse është viktimë ose autor i veprës penale ose i kundërvajtjes

Data: \_\_\_\_\_

Prokurori publik: \_\_\_\_\_



